



KËSHILLI
I QARKUT
KORÇË



Universiteti "Fan S. Noli"

Aktet e Seminarit Shkencor

organizuar në kuadër të 80-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë



Korçë, 2024



**AKTET E SEMINARIT SHKENCOR
“80-VJETORI I ÇLIRIMIT: SHQIPTARËT DHE
KOALICIONI ANTIFASHIST”**

*(Përmbledhje materialesh përgatitur
nga Universiteti “Fan S. Noli”,
me mbështetjen e Këshillit të Qarkut të Korçës)*

KORÇË, 8 NËNTOR 2024

BORDI SHKENCOR

Prof. dr. Lorenc Ekonomi, Rektor, Universiteti “Fan S. Noli”

Dr. Erjon Nexhipi, Kryetar, Këshilli i Qarkut Korçë

Dr. Aida Mosko, Zv. Rektor për shkencën dhe projektet, Universiteti
“Fan S. Noli”

Prof. as. dr. Jonela Spaho, Dekan, Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë

Dr. Orjon Ago, Zv. Dekan, Fakulteti i Edukimit dhe i Filologjisë

Prof. as. dr. Edlira Menkshi, Përgjegjëse e departamentit Histori-Gjeografi

Prof. as. dr. Teki Kurti, Arkivi Qëndror i FA në Ministrinë e Mbrojtjes

Prof. as. dr. Alba Kreka

Ph.D. Metin Venxha

Dr. Ermira Jashiku

BORDI ORGANIZATOR

Ph. D. Metin Venxha

Elona Mano

Eftiona Bylykbashi

Enela Bode

Redaktor gjuhësor: Msc. Lonora Hysolli

Përgatiti për botim: Msc. Eftiona Bylykbashi

TABELA E PËRMBAJTJES

FJALË PËRSHËNDETËSE Prof. dr. Lorenc EKONOMI- Rektor i Universitetit “Fan S. Noli”.....	4
FJALË PËRSHËNDETËSE Dr. Erjon NEXHIPI- Kryetar i Këshillit të Qarkut të Korçës.....	6
FJALË PËRSHËNDETËSE Ph. D. Metin VENXHA- Organizator i Seminarit Shkencor.....	7
SISTEMI NDËRKOMBËTAR DHE LUFTA E DYTË BOTËRORE NË SHQIPËRI Ph. D. Jordan JORGJI.....	9
IDEJA E KRIJIMIT TË FRONTIT ANTIFASHIST NË SHQIPËRI: NGA KONFERENCA E PEZËS NË MBLEDHJEN E MUKJES, NJË SHANS I HUMBUR PËR BASHKIMIN KOMBËTAR KUNDËR PUSHTUESVE Ph. D. Metin VENXHA.....	20
KRAHINA E VAKËFEVE GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE Dr. Orjon AGO.....	37
KUJTESA KOLEKTIVE HISTORIKE NË 80-VJETORIN E ÇLIRIMIT TË VENDIT: RAST STUDIMI RAJONI I KORÇËS Prof. as. dr. Alba KREKA.....	51
ANAMNEZA E DREJTUESIT POLITIK TË PKSH GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE Nuredin NAZARKO.....	64
TË PANJOHURAT E NGJARJEVE TË DATAVE 8-9 SHTATOR 1943 NË KORÇË Ruela AGO.....	86
DHORA LEKA- MUZIKA E REZISTENCËS DHE ROLI I GRUAS NË LUFTËN PËR ÇLIRIM Jorida TOLLKUÇI.....	95
LETËRSIA GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE Prof. as. dr. Jonela SPAHO.....	108
KOHA DHE KUJTESA NË LETËRSINË E DRITËRO AGOLLIT “KOMISARI MEMO MBI NGREHINAT E LUFTËS SË DYTË BOTËRORE” Prof. as. dr. Eris RUSI.....	124

FJALË PËRSHËNDETËSE

Prof. dr. Lorenc EKONOMI- Rektor i Universitetit “Fan S. Noli”

Të nderuar përfaqësues të Këshillit të Qarkut!

Të nderuar pedagogë të Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë!

Të nderuar studentë!

Të nderuar pjesëmarrës!

Muaji nëntor është muaji i ngjarjeve të mëdha historike të popullit tonë. Në nëntor të vitit 1443 Skënderbeu u kthye në Krujë. Në muajin nëntor të vitit 1912, patriotët shqiptarë me në krye Ismail bej Qemalin shpallën në Vlorë, Shqipërinë një vend të pavarur. Këtë vit, populli shqiptar feston 80-vjetorin e çlirimit nga pushtimi nazifashist. Më 29 nëntor 1944 u çlirua Shqipëria nga pushtimi nazifashist, pas një lufte nacionalçlirimtare që zgjati 4 vjet e gjysmë.

Ky çlirim erdhi si rezultat i një lufte, ku populli shqiptar u bashkua dhe luftoi pa dallim krahine dhe ideje. Lufta nisi me zemër dhe dëshirë për liri, e frymëzuar nga luftërat e Skënderbeut dhe të rilindasve. Ideali i kohës, ishte ideali i lirisë. Populli shqiptar u bë pjesë e koalicionit antifashist së bashku me shumicën e popujve të botës së përparuar të kohës. Në këtë luftë, shqiptarët bënë sakrifica të shumta, akte heroizmi, dhe disa mijëra dhanë jetën.

Kur në Europë filloi rezistenca antifashiste, shumë të rinj lanë universitetet dhe u kthyen në vendin e tyre. Këtë gjë e bënë edhe studentët shqiptarë që studionin në Itali, Francë, Austri e gjetkë. Ata u kthyen në Shqipëri dhe u rreshtuan të parët në rezistencë. Këtë gjë e bënë edhe liceistët e Korçës, nxënësit e shkollave, mësuesit e tyre. Dihet kontributi i tyre, aktet e heroizmit dhe dhjetra dëshmorë.

Brezat e sotëm, jo vetëm që duhet të jenë krenarë për këtë vepër, por duhet të marrin shembull dashurinë për lirinë, sakrificat për vendin dhe patriotizmin e atyre që luftuan për Shqipërinë. Historianët kanë shkruar shumë dhe do të vazhdojnë të shkruajnë, sepse sa më shumë i largohemi vitit të çlirimit, aq më shumë rritet nevoja e kujtesës së kësaj ngjarjeje. Kësisoj duhet ta vlerësojmë dhe të jemi krenarë për këtë vepër të popullit tonë. Duke e trajtuar me objektivitet këtë luftë, më tepër rritet vlera dhe arritjet e saj.

Për të reguar vlerat e luftës së popullit shqiptar po ju sjell disa shembuj:

Në Beograd, ndodhet një ndërtesë, ndoshta më e larta në kohën e Luftës së Dytë

Botërore, që mban emrin “Pallati Albania”. Aty janë akoma shenjat e shnarpeleve ruse, të përdorura gjatë çlirimit të Beogradit nga Ushtria e Kuqe. Shqipëria nuk ka shenja të armëve të ushtrive aleate, sepse u çlirua vetë, pa ndërhyrjen e ndonjë ushtrie tjetër.

Në Poloni ndodhet kampi i përqendrimit të Aushvic-Birkenau. Në këtë kamp u vranë rreth 2 milionë njerëz, midis tyre 1.2 milionë hebrenj. Vetëm për dy popuj, hyrja në muze është e lirë, për hebrenjtë dhe shqiptarët. Në Shqipëri, nuk u dorëzua asnjë hebre. Shumë hebrenj erdhën në Shqipëri nga vendet e tjera dhe u mbrojtën nga autoritetet dhe populli shqiptar. Pra shqiptarët, jo vetëm që luftuan për lirinë e tyre, por garantuan jetën e miqve që përndiqeshin nga nazizmi.

Kur në Pragë, në vitin 1942 rezistenca çeke ekzekutoi arkitektin e Holokaustit, beniaminin e Hitlerit, oficerin e lartë nazist Reinhard Heindrih, fshati i Lidicës u rrafshua i gjithi. Një pjesë e banorëve u pushkatuan, pjesa tjetër u dërgua në kampet e përqendrimit. Fat të ngjashëm me Lidicën, pati fshati i Borovës në vendin tonë. Ne të gjithë e dimë se çfarë ndodhi atje dhe pse.

Në dokumentet arkivore gjenden të qarta kontributet e forcave çlirimtare shqiptare kundër pushtuesve. Interesante janë detajet nga dy operacionet e mëdha ushtarake të ushtrisë gjermane: operacioni i dimrit dhe ai i qershorit. Aty vihen re sakrificat dhe forca e luftës partizane, dinjiteti, heroizmi dhe forca e luftës sonë çlirimtare.

Pas viteve 90 u njohëm me shumë botime të dokumenteve të ushtrive pushtuese italiane dhe gjermane, por edhe me libra të kujtimeve të oficerëve të këtyre ushtrive. Këto dokumente dhe kujtime treguan se edhe kundërshtarët tanë e pranonin luftën e popullit shqiptar. Këto dokumente treguan edhe njëherë karakterin e shqiptarit dhe përf forcuan faktet mbi Luftën Nacionalçlirimtare.

Falënderoj Këshillin e Qarkut dhe kryetarin e tij z. Erjon Nexhipi si nismëtarin e këtij aktiviteti shkencor. Gjithashtu, falënderoj departamentin e Histori-Gjeografisë, si mbështetësin kryesor të saj, si dhe të gjithë kumtuesit dinjitozë në këtë Seminar Shkencor .

Ju faleminderit!

FJALË PËRSHËNDETËSE

Dr. Erjon NEXHIPI- Kryetar i Këshillit të Qarkut të Korçës

I nderuar rektor!

Të nderuar dekanë, profesorë, studiues dhe të ftuar!

Me rastin e 80-vjetorit të çlirimit, botimi i materialeve të kësaj konference shkencore përfaqëson një mundësi të vyer për të reflektuar dhe për të thelluar kuptimin tonë mbi një periudhë kaq të rëndësishme të historisë sonë kombëtare. Studimi i Luftës së Dytë Botërore dhe i rolit të shqiptarëve në Koalicionin Antifashist është thelbësor, jo vetëm për të kuptuar të kaluarën tonë, por edhe për të nxjerrë mësim të vlefshme për të ardhmen.

Në një kohë kur bota po përballlet me sfida të reja dhe konflikte të ndryshme, njohja dhe analiza e historisë na ndihmojnë të kuptojmë rëndësinë e solidaritetit, unitetit dhe qëndrimit në anën e drejtë të historisë. Kjo është veçanërisht e rëndësishme sot, kur paqja dhe stabiliteti global janë të kërcënuara dhe ku vlerat për të cilat luftuan paraardhësit tanë duhet të mbrohen dhe promovohen.

Puna shkencore e prezantuar në këto materiale kontribuon në ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë sonë historike, si dhe në edukimin e brezave të rinj me vlerat e lirisë, demokracisë dhe drejtësisë. Këto vlera na ndihmojnë të përballojmë sfidat aktuale dhe të ndërtojmë një shoqëri më të drejtë dhe më paqësore.

Dëshiroj të shpreh mirënjohjen ndaj Universitetit "Fan S. Noli" për organizimin e kësaj konference, si dhe ndaj studiuesve dhe profesorëve që kontribuan me punimet e tyre shkencore. Përmes përpjekjeve të tilla historia jonë studiohet, ruhet dhe shërben si një udhërrëfyes i çmuar për të kuptuar të tashmen dhe për të investuar në të ardhmen.

Shpresoj që ky botim të shërbejë si bazë për studime të mëtejshme dhe për të ndihmuar në përballimin e sfidave të sotme.

Faleminderit!

FJALË PËRSHËNDETËSE

Ph. D. Metin VENXHA- Organizator i Seminarit Shkencor

I nderuar Z. Rektor i Universitetit “Fan S. Noli”, prof. dr. Lorenc Ekonomi!

Të nderuar përfaqësues të Këshillit të Qarkut të Korçës!

E nderuar dekane e Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë, prof. as. dr. Jonela Spaho!

Të nderuar pjesëmarrës! Të dashur studentë!

Ju falënderoj që keni ardhur në Universitetin “Fan S. Noli” për të përkujtuar 80-vjetorin e Çlirimit, si një moment i veçantë dhe shumë i rëndësishëm në historinë e Shqipërisë së shekullit XX.

Ky Seminar Shkencor është realizim konkret i idesë që dha një vit më parë, Z. Erjon Nexhipi në cilësinë e Kryetarit të Qarkut të Korçës, si dhe dëshirës së pedagogëve të departamentit të Historisë dhe të Gjeografisë, të Fakultetit të Edukimit dhe të Filologjisë në universitetin tonë.

Seminari Shkencor “80-vjetori i Çlirimit, shqiptarët dhe koalicioni antifashist”, i organizuar nga Universiteti i Korçës në bashkëpunim me Këshillin e Qarkut Korçë, ka karakter shkencor dhe jubilar njëkohësisht, për nga vlerat që sjell dhe për momentin në të cilin mbahet, pikërisht në vigjilje të 80-vjetorit të Çlirimit, që shënon një moment krenarie për kombin shqiptar duke u rreshtuar në bllokun e vendeve antifashiste.

Megjithëse kanë kaluar 8 dekada nga përfundimi i luftës, debatet për këtë ngjarje vazhdojnë edhe sot, jo vetëm në rrethet e historianëve, studiuesve dhe analistëve, por edhe në opinionin e gjerë. Kjo është mëse e kuptueshme. Shoqëria ka qenë gjithmonë e interesuar për të njohur dinamikat e luftës shkatërrimtare që përfshiu Shqipërinë, rezistencën, krijimin e Frontit, qasjen ndaj pushtuesve, gabimet e luftës dhe mesazhet që na vijnë nga kjo ngjarje.

Lufta e Dytë Botërore, ngjarja më tragjike e gjysmës së parë të shek. XX, përfshiu me të gjithë brutalitetin e saj shqiptarët dhe Shqipërinë. Madje, Shqipëria pati fatin e hidhur të përballej e para me agresivitetin fashist italian në Ballkan. Edhe pse marrëdhëniet Itali-Shqipëri ishin ndërtoar mbi baza traktatash e marrëveshesh të rregullta, agresioni nuk u shmang, por u shfaq i egër dhe i pamëshirshëm, ashtu siç është çdo agresion ndaj një kombi të lirë.

Aktet e Seminarit Shkencor organizuar në kuadër të 80-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë

Në këtë seminar, mbi bazën e dokumenteve arkivore, kumtuesit do të sjellin çështje të natyrës historiografike si: legjitimiteti i shtetit shqiptar pas pushtimit italian, krijimi i Frontit Nacionalçlirimtar, tensionet e brendshme politike, memoria historike, letërsia e luftës, këngët partizane etj.

Në mbyllje, dua të them se, nga largësia e 80 viteve të përfundimit të Luftës II Botërore, në lidhje me qëndrimin e shqiptarëve, të aleancave të brendshme dhe të jashtme, kushtet janë pjekur e janë bërë më të vlefshme, gjykimet janë bërë më objektive dhe më të balancuara.

Faleminderit!

SISTEMI NDËRKOMBËTAR DHE LUFTA E DYTË BOTËRORE NË SHQIPËRI

PhD. Jordan JORGJI

Departamenti i Shkencave Sociale

Universiteti "Fan S. Noli"

Abstrakt

Lufta e Dytë Botërore përbën një kapitull të rëndësishëm të historisë së Shqipërisë sepse vendi ruajti pavarësinë dhe sovranitetin e tij kombëtar. Janë të shumta botimet rreth kësaj periudhe, kryesisht ato shqiptare, por nuk mungojnë edhe botimet e huaja për vendet e Ballkanit. Për të plotësuar në mënyrë sa më modeste literaturën në fjalë, qëllimi i këtij studimi bibliografik është të analizojë Luftën e Dytë Botërore dhe Shqipërinë në prizmin e sistemit ndërkombëtar dhe të zhvillimeve që precipitojnë prej tij.

Kjo realizohet në përputhje me teorinë e Marrëdhënieve Ndërkombëtare, konkretisht realizmit politik. Sipas kësaj teorie, sistemi ndërkombëtar anarkik krijon kurthe për shtetet-kombe në fushën e sigurisë e për rrjedhojë nuk përjashtohet që vendimet politikisht racionale që ato marrin mund të përfundojnë në konflikte të armatosura. E tillë ishte edhe Lufta e Dytë Botërore në kontekstin e Shqipërisë.

Fjalë-çelës: *Lufta e Dytë Botërore, Sistemi Ndërkombëtar, Shqipëria, Realizmi politik.*

Hyrje

Lufta e Dytë Botërore përbën periudhën më të rëndësishme të historisë moderne të Shqipërisë, së bashku me Shpalljen e Pavarësisë më 1912 dhe pluralizmin politik në fillimin e viteve 1990. Lufta në fjalë e renditi vendin në krah të fuqive fitimtare dhe për rrjedhojë Shqipëria nuk vuri në rrezik sovranitetin territorial dhe kombëtar të saj në rendin e ri botëror që po lindte. Me Luftën Antifashiste Nacional-Çlirimtare (LANÇ) shqiptarët përçafuan vlerat e drejta të historisë, ndonëse lufta u mitizua ndjeshëm në një tablo të thjeshtëzuar bardhezi gjatë dhjetëvjeçarëve të mëvonshëm të sistemit socialist-totalitar dhe atij pluralist. Megjithatë, qëllimi i këtij punimi nuk është qartësimi i tablosë në fjalë, duke qenë se për këtë ekzistojnë studime të shumta, por të analizojë Luftën e Dytë Botërore të shqiptartëve në prizmin e Sistemit Ndërkombëtar (SN) dhe të

politikës globale, pra të asaj çka ndodhi e më gjerë, qoftë në rajon, por edhe në botë. Ky hap ndërmerret për të forcuar kontekstin ndërkombëtar të analizës (të paktën të dimensionit politik), për arsyen se jo çdo gjë mund të shpjegohet nga faktorët dhe zhvillimet e brendshme të një shteti apo të një shoqërie. Gjithashtu, analiza politike e Marrëdhënieve Ndërkombëtare (MN) kontribuon në pasurimin e interpretimit të luftës, duke e bërë më të plotë mozaikun se çfarë ndodhi rreth tetëdhjetë vite më parë.

Punimi lidhet me fushën akademike të MN dhe fokusohet në teorinë e realizmit politik. Teoria në fjalë është përzgjedhur për arsyen e avantazhit që ajo ka ndaj teorive të tjera përsa i përket studimit të Luftës së Dytë Botërore. Shpërthimi i saj dhe degradimi në luftë totale dëshmoi dobësinë e teorisë liberale dhe të rrymave të tjera të Idealizmit. Më konkretisht, organizata e Lidhjes së Kombeve dështoi të ndalë protagonizmin e shteteve-kombe në konfliktin global. Kjo e largon luftën në fjalë, jo vetëm prej Idealizmit, por edhe nga rryma teorike e Shoqërisë Ndërkombëtare dhe Konstruktivizmi, të cilat theksojnë aftësinë e shteteve dhe të subjekteve njerëzore për të krijuar hapësira paqeje dhe bashkëpunimi përtej interesit të ngushtë kombëtar. Ekspansionizmi territorial dhe përballja e armatosur i hedh poshtë këto teori, të paktën përsa i përket Luftës së Dytë Botërore.

Interpretimi pragmatist i luftës dhe i SN ilustron me ngjarje historike, të cilat i referohen zhvillimeve globale dhe atyre kombëtare, duke ndjekur rrugën deduktive se ato që ndodhën në Shqipëri u ndikuan nga natyra e SN dhe nga zhvillimet e përgjithshme gjeopolitike.

Metodologjikisht, studimi është bibliografik dhe ndërthur literaturën historike me teorinë dhe praktikën e MN. Ai kontribuon në pasurimin e literaturës ekzistuese mbi Luftën e Dytë Botërore si dhe në kuptimin sa më të mirë të kontekstit ndërkombëtar të ngjarjeve.

Në pjesën e parë të punimit shpjegohen aspektet kryesore të teorisë së realizmit politik, për të vazhduar në pjesën e dytë me ekzaminimin e Luftës së Dytë Botërore brenda këtij spektri teorik. Pjesa e tretë e konkretizon analizën e përgjithshme drejt tipareve që Lufta e Dytë Botërore merr në kontekstin e Shqipërisë.

1. Këndvështrimi sipas teorisë së realizmit politik

Siç u nënvizua më sipër, realizmi politik është më i përshtatshëm se teoritë e tjera për të shpjeguar Luftën e Dytë Botërore, falë avantazheve interpretuese që ai ka si familje teorike e MN. Themë familje teorike, sepse ekzistojnë disa variante të realizmit politik, të cilat janë zhvilluar së bashku me evoluimin e sistemit të shteteve-kombe. Variantet kryesore janë realizmi klasik dhe

neorealizmi.

Realizmi klasik thekson rolin parësor që kanë shtetet-kombe në shpërndarjen e fuqisë në SN dhe për rrjedhojë në formësimin e ekuilibrit të forcës. Por, duke qenë se fuqia nuk është e njëtrajtshme dhe absolute shtetet fitojnë pak, mesatarisht ose më shumë forcë. Me fjalë të tjera, shpërndarja e forcës është e pabarabartë në një botë ku shtete të fuqishme si Shtetet e Bashkuara të Amerikës bashkekzistojnë me shtete me fuqi mesatare si Italia, apo edhe shtete të dobëta si Jemeni.

Pabarazia në shpërndarjen e forcës dhe egoizmi reciprok që shtetet kanë ndaj njëri-tjetrit çon në lindjen e dilemave në lidhje me perceptimin se fuqizimi i palës tjetër dëmton ose jo palën time. Këto dilema i përkasin në mënyrë të veçantë sektorit të sigurisë, prandaj dhe ato janë të njohura si “dilemat e sigurisë”. Kështu, rritja e pasigurisë që shtetet kanë ndaj qëllimeve të njëri-tjetrit në fushën e armatimit i çon ato në garë dhe për pasojë në zgjidhjen e problemeve nëpërmjet konfliktit. Është ironike se si dilemat e sigurisë zgjidhen brenda sektorit të sigurisë nëpërmjet një instrumenti që minon sigurinë.¹

Neorealizmi nga ana tjetër vë në dukje rëndësinë përcaktuese që sinjalet e SN kanë në radhë të parë për Fuqitë e Mëdha (FM) dhe në mënyrë dytësore për shtetet e tjera të globit. SN i shteteve është anarkik sipas realizmit politik, që do të thotë se mbi shtetet e pavarura dhe juridikisht sovrane nuk ekziston asnjë autoritet më i lartë mbishtetëror i cili të jetë në gjendje të kontrollojë sjelljen e shteteve-kombe dhe t'i penalizojë ato në rast se devijojnë nga normat e përbashkëta. Kjo situatë e përhershme lëshon sinjale pasigurie tek shtetet-kombe, që nga ana e tyre u përgjigjen me ekuilibrin e forcës, ndërsa FM përpiqen të ruajnë ose të ndryshojnë rendin ndërkombëtar të shpërndarjes së fuqisë relative.

E thënë me fjalë të tjera, neorealizmi i jep rëndësi parësore përshtatjes së FM, e më pas të shteteve të tjera kombe me sinjalet e SN anarkik. Sistemet me disa pole shtetesh të fuqishme, të njohura si sisteme multipolare janë të ndryshme nga sistemet me dy FM (sistemet bipolare) dhe këto të dyja të ndryshme nga sistemet unipolare me një superfuqi, qoftë kjo e fundit me prirje hegjemonike ose jo. Sipas studiuesve të MN dhe kryesisht përfaqësuesve të familjes së realizmit politik, sistemet bipolare janë më të sigurta në menaxhimin e konflikteve se sa dy sistemet e tjera, ndërsa sistemi multipolar është më i pasigurti. Kjo ndodh, ngaqë dy superfuqi e kanë më të lehtë të menaxhojnë së bashku konfliktet globale brenda sferave të tyre të interesit, ndërkohë që

¹ Georg Sørensen, Jørgen Møller, Robert Jackson, *Introduction to International Relations: Theories and Approaches* (Oxford University Press, 2022), kap. 2.3.

koordinimi në fjalë është vështirë të ndodhë mes disa FM, duke lindur pasiguri më të mëdha dhe dilema më të shumta sigurie. Sistemet unilaterale ndodhen diku në mes për vetë faktin se një superfuqi e vetme e ka relativisht të lehtë të menaxhojë konfliktet, por që nga ana tjetër mund të përballet me përjekjet për ndalimin apo kundërbaLANÇimin e prirjeve hegjemoniste nga ana e fuqive të ndryshme rajonale të cilat mund të formojnë aleanca mes tyre. Le të shohim më qartë se çfarë ndodhi në Luftën e Dytë Botërore.

2. Lufta e Dytë Botërore sipas realizmit politik

Lufta e Dytë Botërore zgjati 2175 ditë dhe u zhvillua në vitet 1939-1945 brenda një rendi multilateral ndërkombëtar, pra një sistemi me disa superfuqi si pole kryesore të SN.² Ndër to ishin katër FM evropiane (Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, Franca dhe Italia), një FM në rajonin euroaziatik (Bashkimi Sovjetik), dy fuqi jo-europiane (Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe Japonia) si dhe disa fuqi më të vogla rajonale (Austria, Belgjika, Jugosllavia, Rumania, Australia).

Sipas disa studiuesve, SN është i paqëndrueshëm kur ai ka më shumë se dy pole. Atëherë mundësia e polarizimit dhe e precipitimit në konflikt të armatosur është më e madhe. Nga të gjitha sistemet, ai multipolar është më i paqëndrueshmi dhe më i prirur për të shkaktuar konflikte, në dallim nga sistemi unilateral dhe akoma më tepër nga sistemi bipolar si në periudhën e Luftës së Ftohtë.

Teoritë e familjes së realizmit politik e llogarisin seriozisht efektin që SN ka tek shtetet-kombe nëpërmjet sinjaleve të tij dinamike, duke diktuar politikën e jashtme të shteteve dhe në një farë mënyre duke farkëtuar identitetin e tyre në arenën rajonale dhe globale. SN lëshon sinjale sistemike sipas pozitës që FM zënë në politikën globale, apo e thënë ndryshe në raport me shpërndarjen relative të fuqisë.

Mendimtarë si Thukidhidhi, Makiaveli dhe më vonë Morgenthau dhe Schelling, e gjejnë realizmin jo vetëm tek politika e fuqisë, por edhe tek mendjemprehtësia e udhëheqësve për të kuptuar racionalisht sinjalet ndërkombëtare dhe ato rajonale. Sipas Ofer Israeli, i mbështetur tek idetë e Jeffry Legro dhe Andrew Moravcsik mbi teorinë e luftës, racionalizmi në vendimmarrje precipiton në irracionalizëm dhe luftë, të cilat liderët nuk do t'i kishin dëshiruar fillimisht.³ Irracionalizmi dhe lufta janë produkte të kurthit që ngre vetvetiu struktura anarkike e SN për shkak të informacionit të cunguar, keqkuptimeve dhe mbi të

² Ofer Israeli, *International Relations Theory of War* (Santa Barbara, California: Praeger, 2019), 78.

³ Ibid., 82-83.

gjitha të dilemave në fushën e sigurisë dhe armatimit. Nëse shtetet do të komunikonin më shpesh me njëri-tjetrin dhe do të bashkëpunonin në sektorë strategjikë atëherë dilemat e sigurisë do të zbuteshin sipas përfaqësuesve të Idealizmit.⁴ Kjo i jep përgjigje pyetjes se pse lufta nuk ndodh gjithmonë ndonëse SM mbetet anarkik.⁵

Shpërndarja multipolare e fuqisë relative mes shtatë superfuqive: SHBA, Rusisë (më vonë Bashkimi Sovjetik), Gjermanisë, Britanisë së Madhe, Francës, Japonisë dhe Italisë, gjatë periudhës 1910-1945 erdhi pas një sistemi bipolar mes Britanisë së Madhe dhe Gjermanisë (1871-1909) dhe i parapriu një sistemi bipolar SHBA-Bashkim Sovjetik (1945-1990). Kujtojmë se sistemi tjetër multipolar kishte ekzistuar në vitet 1849-1870.

Sistemi i dytë multipolar gjatë periudhës kur u zhvillua Lufta e Dytë Botërore (1910-1945) ishte më i dhunshmi në historinë e njerëzimit për shkak të dy luftërave botërore, duke lënë pas 26.638.834 vdekje, mes tyre edhe disa lufta më të vogla.⁶ Kujtojmë se sistemi i parë multipolar gjatë periudhës së Luftës së Krimesë (1849-1870) pati 539.594 vdekje.⁷ SN i Krimesë i zuri vendin një hapësire ku lufta mungonte prej 300 vitesh në Evropë.⁸

Lipset të theksohet gjithashtu se në sistemin e dytë multipolar të viteve 1910-1945 përfshihen pole nga kontinente të tjera përtej hapësirës Euro-Aziatike, në të cilën ndodhën konfliktet më të shumta. Pra, është sistemi i parë ndërkombëtar ku u përfaqësuan të gjitha kontinentet e botës.

Lufta e Parë Botërore shtroi rrugën për konfliktin e dytë botëror, ndonëse u vu re aplikimi jetëshkurtër i filozofisë liberale në politikën globale, e cila frymëzoi politikanë në ndërmarrjen e ideve politike. Kështu, u krijua institucioni ndërkombëtar i Lidhjes së Kombeve, u shpall Deklarata me 14 pika e presidentit amerikan W. Wilson dhe u nënshkrua Pakti Kellog-Briand mbi mosulmimin e kolonive të njëra-tjetrës.⁹ Por, të gjitha këto dështuan për shkak të dilemave të sigurisë që mbart sistemi anarkik ndërkombëtar, kryesisht pas riarmatosjes së Gjermanisë, e cila nuk po lejohej të hynte në arenën e FM. Lënia në qoshe e Gjermanisë dhe më pas e kundërta, pra politika e zbutur ndaj veprimeve të saj për gëlltitjen e territoreve me popullsi gjermane, shiheshin nga FM të kohës në prizmin e ekuilibrit të forcës sesa si sinjale ku të gjitha fuqitë mund të

⁴ Raymond Aron, *Peace and War* (Doubleday, Britain: Routledge, 2003), 589.

⁵ Patrick J. McDonald, *The Invisible Hand of Peace* (New York: Cambridge University Press, 2009), 47.

⁶ Israeli, *International Relations*, 77-78.

⁷ Ibid., 76.

⁸ Ibid., 87.

⁹ Ibid., 91-92.

bashkoheshin ndaj tendencave hegjemoniste të Gjermanisë.

Megjithatë, edhe kjo e fundit kishte ndërmarrë lëvizje racionale në arenën evropiane, si aleanca me fuqi të tjera për asgjësimin e sovranitetit dhe të pavarësisë së vendeve më të vogla.¹⁰ Në vitin 1939 bashkëpunoi me Poloninë dhe me Hungarinë për coptimin e Çekosllovakisë, dhe më vonë me Rusinë për të goditur Poloninë.¹¹

Po në prizmin e ekuilibrit të forcës dhe me qëllim parandalimin e një sulmi nga fuqitë e tjera rivale, si Mbretëria e Bashkuar dhe SHBA, Gjermania lidhi pakt me Japoninë e largët dhe me Italinë fashiste, dhe më pas më 1941 kreu sulmin e befasishëm ndaj aleatit afatshkurtër të saj, Bashkimit Sovjetik. Paralelisht, Japonia goditi bazën amerikane në Pearl Harbor.¹² Lufta e Dytë Botërore ishte tashmë një realitet dhe SHBA kishin vendosur të dilnin përfundimisht nga izolacionizmi hegjemonist i Hemisferës Perëndimore.

Nëse do t'i referohemi rrymës së realizmit politik, Gjermania ndoqi vijën e asaj që John Mersheimer e quan *realizëm ofensiv*, ku superfuqitë, nga vetë natyra e tyre, kanë prirje hegjemoniste. Gjermania u mund në maj të vitit 1945, ndërsa hedhja e bombave atomike në Hiroshimë dhe në Nagasaki po atë vit vulosi fatin e fuqive humbëse të boshtit. Një sistem i ri po lindte në arenën ndërkombëtare, ai bipolar i Luftës së Ftohtë mes SHBA-së dhe Bashkimit Sovjetik. Gjithashtu, armatimi bërthamor po shkruante një realitet të ri, i cili e bëri akoma më të qëndrueshëm rendin e ri bipolar.¹³

Është kjo perspektivë në makronivel e cila shpjegon pak a shumë arenën e luftës kombëtare. Fuqitë e vogla rajonale që cilat kishin ruajtur statusin e neutralitetit gjatë dy luftimeve botërore, sipas parashikimeve të Konventës së Hagës (1907), konkretisht Belgjika, Holanda dhe Norvegjia, u bënë objektivat e parë të pushtimit gjerman. A u ndikua edhe Shqipëria në të njëjtën mënyrë?

3. Lufta e Dytë Botërore e Shqipërisë në prizmin e SN

Shqipëria nuk bëri përjashtim nga vende të tjera të vogla dhe u përpoq të ndiqte një politikë sa më racionale me anë të së cilës synonte të ekuilibronte kërkesat dhe dominancat e shteteve fqinjë në drejtim të sovranitetit kombëtar. Në këtë

¹⁰ Ibid., 93-94.

¹¹ Robin Havers, *The Second World War. Europe 1939-1943* (Oxford: Routledge, 2003), 21 & 29.

¹² Williamson Murray & Allan R. Millett, *A War to Be Won* (Cambridge: The Belknap Press of Harvard University Press), 169.

¹³ William Walker, "The troubled quest for international nuclear order," in *War, Peace and Hegemony in a Globalized World*, ed. Chandra Chari (London & New York: Routledge, 2008), 51-60 (51-52).

mënyrë, afrimi me Italinë, përveç qëllimeve të mbështetjes së ekonomisë së varfër shqiptare, kishte si objektiv paralel sigurinë e vendit nga një dominancë e mundshme e Jugosllavisë. Megjithatë, ekspansionizmi italian në Mesdhe (ajo që njihet si teoria e Mare Nostrum) dhe politika kolonialiste italiane në Afrikë çoi gradualisht në asgjësimin e pavarësisë dhe sovranitetit shqiptar në prillin e vitit 1939.¹⁴ Kujtojmë se katër vite më parë Italia kishte ndërhyrë në Abisini.¹⁵ Madje edhe lufta italo-greke filloi pikërisht në kuadrin e ekspansionizmit italian në rajon, si prirje e përgjithshme e Italisë për të ruajtur statusin e fuqisë së madhe në sistemin multilateral, ku pol kryesor ishte partneri ideologjik dhe gjeostrategjik i saj, Gjermania naziste.

Periudha kur shpërtheu Lufta e Dytë Botërore dhe në përgjithësi gjysma e parë e shekullit të 20-të, i gjeti FM në një status quo krejt të ndryshëm nga ai i sotmi. Ato kishin përfunduar procesin e kolonizimit në vende të ndryshme të botës nga të gjitha kontinentet. Gjermania hyri relativisht vonë në atë proces që për periudhën në fjalë bënte të mundur sigurimin e lëndëve të para dhe një status të privilegjuar për fuqitë kolonizuese. Ishte epoka kur MN ishin plotësisht të lidhura me konceptin e territoreve ndryshe nga çfarë ndodh në ditët e sotme në epokën e teknologjisë dhe të informacionit virtual. E parë nga kjo logjikë, agresioni kundër Shqipërisë përbënte vazhdimësi të ekspansionizmit të FM të Boshtit (Gjermani dhe Itali) ndërkohë që Japonia demostroi një prirje të ngjashme në Azinë e largët. Edhe në gjirin e Aleatëve, Franca dhe Mbretëria e Bashkuar ishin superfuqi të lidhura midis të tjerash me kolonitë.

Një element tjetër i rëndësishëm i luftës në Shqipëri, gjatë regjimit italian dhe më pas atij gjerman, ishte rezistenca kundër pushtuesit. Rezistenca dhe bashkëpunimi përbënin pjesë të renditjeve nacionale, si refleksion i zhvillimeve ndërkombëtare mes dy aleancave ushtarake: Aleatëve dhe Boshtit. Çeta e Pezës, Kajo Karafili, veprimi i Vasil Laçit u pasuan nga Lufta e organizuar Antifashiste Nacionalçlirimtare. Madje edhe vetë britanikët u përfshinë në operacione luftarake në Shqipëri, siç ishte rasti i kolonelit David Smiley.¹⁶ Veprimet e rezistencës u pasuan gjithashtu nga ndikimi që kishin rrymat e ndryshme si brenda ashtu dhe jashtë gjirit të Aleatëve. Në Greqi rezistenca u organizua nga dy kampe kryesore me tipare ushtarake, ideologjike dhe me lidhje

¹⁴ Christopher Catherwood, *The Balkans in World War Two* (Basingstoke & New York: Palgrave Macmillan, 2003), 18.

¹⁵ Winston Churchill, *The Grand Alliance* (New York: RosettaBooks, 1948), 115.

¹⁶ Richard J. Aldrich, *Witness to War* (Doubleday, Great Britain: Corgi Books, 2004), 577; Instituti i Historisë, *Historia e popullit shqiptar* vëllimi IV (Tiranë: Toena, 2008), 107-110.

të ngushta me njësitë e tjera simotra nga Ballkani: nga komunistët si pjesë e rëndësishme e forcave të EAM-it (Frontit Nacional-Çlirimtar) dhe nga nacionalistët e EDES-it (Bashkimi Nacional-Demokrat Grek). Kjo u vu re edhe në Shqipëri, me komunistët, si përbërës themelor i Frontit Nacional-Çlirimtar, si dhe me legalistët dhe me nacionalistët e Ballit Kombëtar, ndonëse këta të fundit patën bashkëpunuar me pushtuesin. Theksojmë, se ky vëzhgim ka si qëllim pasqyrimin e ndikimit të konjunkturave të përgjithshme, më shumë sesa të thjeshtëzojë apo të relativizojë rolin e forcave të ndryshme në rezistencën shqiptare. Në ditët e fundit të luftës këto kampe u futën në konflikt të armatosur me njëri-tjetrin për të kërkuar pushtetin e pasluftës duke synuar asgjësimin e kundërshtarit.

Kjo vinte si refleksion i dallimeve të mëdha ideologjike dhe gjeostrategjike brenda vetë Aleatëve, ku tri fuqi liberale kishin lidhur aleancë antifashiste me një fuqi komuniste, siç ishte Bashkimi Sovjetik. Pra, polariteti ndërmjet FM ndikohej nga polariteti ideologjik dhe gjeostrategjik mes tyre rreth shpërndarjes së fuqisë relative në SN, ku kjo renditje në lëvizje reflektohej më pas edhe tek shtetet më të vogla.

Paralelisht ndikuese ishin edhe sferat e influencës të dakordësuara nga dy drejtuesit e luftës, kryeministri britanik Çerçill dhe udhëheqësi sovjetik Stalin, në *Marrëveshjen e Përqindjeve* në tetor të vitit 1944.¹⁷ Rastësisht ose jo, ajo që pasoi Luftën e Dytë Botërore dhe shtroi rrugën për Luftën e Ftohtë ndoqi frymën e asaj marrëveshjeje.¹⁸ Në Shqipëri mbizotëroi krahu komunist i rezistencës ndërkohë që në Greqi Londra ndërhyu për dobësimin e komunistëve, paçka se këta të fundit zotëronin thuajse të plotë kontrollin mbi Greqinë dhe gëzonin përkrahjen e pjesës më të madhe të popullit grek.¹⁹

Edhe përsa i përket armatimit, fuqitë aletate përfshirë Britaninë ishin të prirura të pranonin pozitën e rëndësishme të komunistëve duke mos nxitur ç'inkurajimin e rezistencës, ndonëse ideologjikisht ishin më pranë forcave legaliste dhe atyre balliste.²⁰ Ndarja e hesapeve me komunistët nuk ndodhi as pas përfundimit të luftës, çka vërtetonte ndarjen e Ballkanit në sfera influence.

Gjatë rendit multilateral të polarizuar në Luftën e Parë dhe të Dytë Botërore, Shqipëria u kthye në arenë lufte nga ushtri të ndryshme: Austro-Hungaria dhe

¹⁷ Serge Berstein, Prierre Milza, *Ιστορία της Ευρώπης, τόμος 3* [Historia e Evropës, vëllimi 3], përkth. Michalis Kokolakis (Athinë: ΑΛΕΞΑΝΔΡΕΙΑ, 1997), 167.

¹⁸ Richard Clogg, *A Concise History of Greece* (Cambridge University Press, 2021), 147.

¹⁹ Winston Churchill, *Triumph and Tragedy* (New York: RosettaBooks, 1953), 349-350; Clogg, *A Concise History*, 307-308.

²⁰ Instituti i Historisë, *Historia*, 112; Paskal Milo, *Të vërtetat e fshehura. Incidenti i Kanalit të Korfuzit* (Tiranë: Toena, 2010), 27.

Franca në Luftën e Parë; Italia dhe Gjermania në Luftën e Dytë. Rreziqet e të qenit shtet i brishtë dhe i vogël, si dhe agresiviteti i rendit multilateral, e vendosën Shqipërinë jo vetëm në rivalitet agresiv brenda politikës së brendshme, por edhe në rreziqe serioze për humbjen e sovranitetit. Në Luftën e Parë Botërore Shqipëria rrezikoi të kthehej në protektorat të Italisë. Në Luftën e Dytë, edhe pse Shqipërisë iu dhanë territore nga ushtritë pushtuese, ajo mund të humbiste akoma më shumë, nëse do të ishte shpallur shtet-humbës, jo vetëm në lidhje me tërësisë territoriale, por edhe përsa i përket sovranitetit qeverisës.

Mbrojtja e atdheut dhe e vlerave humane që karakterizuan LANÇ të Shqipërisë, ashtu si edhe të popujve të tjerë, lidhet gjithashtu me faktin se SN anarkik nuk i favorizon prirjet hegjemoniste të superfuqive. Gjermania e tentoi hegjemoninë në nivel evropian dhe Italia në atë mesdhetar, ndërkohë që ekspansionizmi i të dyjave, së bashku me Japoninë në Azinë e largët, i shtyu FM të tjera të kundërbaLANÇonin hegjemoninë e synuar me anën e një konflikti të armatosur global.²¹

Shqipëria dhe vendet e tjera u bënë teatro luftrash dhe rezistencash në një kontekst më të ngushtë të Luftës së Dytë Botërore. Pikërisht në këtë kontekst, LANÇ pati një impakt jetësor në arenën diplomatike të rendit të ri që po lindte, sepse e renditi Shqipërinë krahas forcave fituese gjatë Konferencës së Paqes në Paris. Nga ana tjetër, vendi po futej në një sistem të egër, që gjithashtu përbënte riprodhim nacional të SN bipolar të pasluftës, i cili zgjati rreth gjysmë shekulli, deri në fundin e viteve '80.

Përfundime

Lufta e Dytë Botërore e Shqipërisë u trajtua përmes këtij punimi në një prizëm më të gjerë se sa ai nacional dhe në kontekstin normativ të MN. Analiza u bazua në SN, sipas këndvështrimit të teorisë së realizmit politik. Në përputhje me këndvështrimin në fjalë, anarkia e SN dhe shpërndarja e fuqisë relative drejt një, dy apo disa poleve të FM imponon tek shtetet e tjera më pak të mëdha dhe tek ato të vogla renditjet në aleanca të ndryshme si dhe tensione që vihen re brenda poleve.

SN është më i qëndrueshëm kur fuqia shpërndahet mes dy poleve dhe më i paqëndrueshëm kur ka disa FM, ndër të cilat me prirje hegjemoniste që i shtyjnë të tjerat të ndalojnë këto prirje. Kjo ndodhi në periudhën 1910-1945, kur u zhvilluan dy luftat botërore dhe përbënte sistemin më të paqëndrueshëm dhe

²¹ Ariel Ilan Roth, *Leadership in International Relations* (New York: Palgrave Macmillan, 2010), 33-34.

më të tensionuar në historinë moderne të MN.²²

Janë pikërisht struktura e SN dhe paqëndrueshmëria mes poleve ato që i futin shtetet në kurthin e dilemave të sigurisë dhe të irracionalizimit të politikave racionale, përfshirë edhe shtetet e fuqishme që vendosin në mënyrë racionale. Shtetet futen në kurthin e konfliktit, sepse ato në vetvete janë qenie egoiste dhe në një mjedis anarkik udhëhiqen nga pasiguri në lidhje me prirjet e të tjerëve. Kjo ndodhi me FM gjatë Luftës së Dytë dhe të Parë Botërore.

Ndikimi i SN nuk kishte si mos të prekte Shqipërinë, së bashku me vende të tjera të vogla. Pushtimi i saj në vitin 1939 dhe vijimësia e rezistencës nacionale u ndikua në mënyrë të rëndësishme nga zhvillimet e përgjithshme që i kalonin caqet e kufijve shqiptarë. Kjo nuk do të thotë kurrsesi se LANÇ ishte produkt ekskluziv i këtyre prirjeve dhe i FM, por se disa aspekte të vazhdimësisë së saj në spektrin e armatimit dhe të identifikimit ideologjik u ndikuan nga logjika e SN.

Madje edhe frytet e rezistencës në dëbimin e pushtuesve dhe çlirimin e vendit reflektonin humbjen e fuqive të Boshtit dhe fitoren e madhe të Aleatëve. Shqipëria u rendit ndër shtetet fituese dhe si e tillë mori pjesë në Konferencën e Paqes në Paris. Si rrjedhojë u anëtarësua në forumin më të rëndësishëm të pasluftës, në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, ndonëse disa vite më vonë. LANÇ e renditi Shqipërinë në anën e drejtë të historisë dhe përbën një nga kapitujt më të rëndësishëm të trashëgimisë së vendit.

Literatura

1. Aldrich, Richard J. *Witness to War*. Doubleday, Great Britain: Corgi Books, 2004.
2. Aaron, Raymond. *Peace and War* (Doubleday, Britain: Routledge, 2003).
3. Berstein, Serge & Prierre Milza. *Ιστορία της Ευρώπης, τόμος 3* [Historia e Evropës, vëllimi 3], përkth. Michalis Kokolakis (Athinë: ΑΛΕΞΑΝΔΡΕΙΑ, 1997).
4. Catherwood, Christopher. *The Balkans in World War Two*. Basingstoke & New York: Palgrave Macmilan, 2003.
5. Churchill, Winston. *The Grand Alliance*. New York: RosettaBooks, 1948.
6. Churchill, Winston. *Triumph and Tragedy*. New York: RosettaBooks, 1953.
7. Clogg, Richard. *A Concise History of Greece*. Cambridge University Press, 2021.
8. Havers, Robin. *The Second World War. Europe 1939-1943*. Oxford: Routledge, 2003.

²² Israeli, *International Relations*, 97.

Aktet e Seminarit Shkencor organizuar në kuadër të 80-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë

9. Instituti i Historisë, *Historia e popullit shqiptar, vëllimi IV*. Tiranë: Toena, 2008.
10. Israeli, Ofer. *International Relations Theory of War*. Santa Barbara, California: Praeger, 2019.
11. McDonald, Patrick J. *The Invisible Hand of Peace*. New York: Cambridge University Press, 2009.
12. Milo, Paskal. *Të vërtetat e fshehura. Incidenti i Kanalit të Korfuzit*. Tiranë: Toena, 2010.
13. Murray, Williamson & Allan R. Millett. *A War to Be Won*. Cambridge: The Belknap Press of Harvard University Press.
14. Roth, Ariel Ilan. *Leadership in International Relations*. New York: Palgrave Macmillan, 2010.
15. Sørensen, Georg; Jørgen Møller & Robert Jackson. *Introduction To International Relations: Theories and Approaches*. Oxford University Press, 2022.
16. Walker, William. "The troubled quest for international nuclear order." In *War, Peace and Hegemony in a Globalized World*, edited by Chandra Chari. London & New York: Routledge, 2008.

**IDEJA E KRIJIMIT TË FRONTIT ANTIFASHIST NË SHQIPËRI:
NGA KONFERENCA E PEZËS NË Mbledhjen e Mukjes,
NJË SHANS I HUMBUR PËR BASHKIMIN KOMBËTAR
KUNDËR PUSHTUESVE**

Ph. D. Metin VENXHA

*Departamenti i Historisë dhe i Gjeografisë
Universiteti “Fan S. Noli”*

Abstrakt

80- vjetori i fundit të Luftës së Dytë Botërore dhe qëndrimi dinjitoz i Shqipërisë, duke u rreshtuar në bllokun e vendeve antifashiste, na jep rastin t’i rikthehemi luftës, jo vetëm si detyrim moral ndaj gjeneratës që e përballoi, por për të bërë vlerësimet e duhura për të, në kushtet kur aksesit në dokumentacionin arkivor është bërë i mundur. Një çështje që ka ngjallur debat, jo vetëm midis studiuesve, por edhe publikut të gjerë, është ajo e organizimit të rezistencës së shqiptarëve në Luftën e Dytë Botërore. Në këtë studim jemi përpjekur të analizojmë ngjarjet politike dhe ushtarake që shkojnë nga Konferenca e Pezës deri te Mbledhja e Mukjes. Ky hark kohor është intensiv për gjithë përpjekjet e bëra për të krijuar një front të përbashkët rezistence, si dhe për lindjen e divergjencave ideologjike midis rrymave politike, që u formuan përgjatë kësaj periudhe. Konferenca e Pezës, e thirrur si një lëvizje nacionalçlirimtare me spektër të gjerë antifashist dhe gjithpërfshirëse, zhvishet gradualisht nga ky mision, deri në fundin e dhimbshëm të takimit të Mukjes, çka shënoi humbjen e një shansi historik për bashkim kombëtar kundër pushtuesve, që do të sillte një klimë më të paqme sociale dhe politike pas vitit 1944.

Fjalë kyçe: bashkim kombëtar, fashizëm, Fronti Nacionalçlirimtar, Konferenca e Mukjes, Lufta e Dytë Botërore, pushtues.

Hyrje

Pushtimi italian nuk erdhi si rrufe në qiell të hapur, pasi para pushtimit ushtarak, Italia tashmë e kishte “kopsitur” dhe “pushtuar” ekonomikisht dhe politikisht Shqipërinë, duke e bërë atë të zhytej në borxhe financiare dhe politike. Duhet

Aktet e Seminarit Shkencor organizuar në kuadër të 80-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë

pasur parasysh se Italia, që nga Konferenca e Ambasadorëve e vitit 1921¹, bëhet “kumbara” e Shqipërisë. Sipas Petro Pastorellit, Italisë i atribuohet “*protektorati, i kamufluar me fjalë të tjera, ndaj Shqipërisë*”.² Në fushën ekonomike avantazh ishte “italianizimi” i ekonomisë shqiptare. Qeveria fashiste përfitoi nga politika e “dyerve të hapura” e Zogut, për të ngritur një linjë ndërhyrjesh ekonomike dhe ushtarake, me perspektivën për të ushtruar përfundimisht ndikimin e vërtetë italian në Shqipëri.³ Shtyllat mbi të cilat bazohej ekspansioni financiar italian në Shqipëri përfaqësoheshin nga Banka Kombëtare e Shqipërisë, e cila u vendos në qendër të sistemit të ri monetar të inauguruar në vitin 1925 dhe nga SVEA, të cilës iu besua administrimi i fondeve të huasë të disbursuara nga Italia në të njëjtin vit për zhvillimin ekonomik të vendit. Konsorciumi italian përbëhej nga institucionet kryesore të kreditit të vendit: Credito Italiano, Banca Commerciale Italiana, Banca Nazionale di Credito, Banco di Roma dhe institucione të tjera më të vogla. Kjo marrëveshje parashikonte gjithashtu një kredi nga SVEA në vlerën 50 milionë franga ari, me kohëzgjatje 40 vjet dhe me një normë interesi 7,5%, e cila do të përdorej për ndërtimin e veprave publike më të rëndësishme dhe më gjerë.⁴

Gjithçka ndryshoi me pushtimin italian në pranverën e vitit 1939. Pushtimi italian i Shqipërisë (7 prill – 12 prill 1939) ishte një fushatë e shkurtër ushtarake e Mbretërisë së Italisë kundër Mbretërisë së Shqipërisë. Shqipëria u pushtua shumë shpejt. Sundimtari i saj, Mbreti Zog, u detyrua të largohej në mërgim dhe vendi u bë pjesë e Perandorisë Italiane si një protektorat në bashkim personal me kurorën italiane. Ky agresion fashist, në shkelje flagrante të së drejtës

¹ Në 9 nëntor 1921 fuqitë kryesore, më konkretisht Anglia, Franca, Italia dhe Japonia, njohën pavarësinë e Shqipërisë dhe qeverinë e saj. K. Dervishi, *Historia e Shtetit Shqiptar 1912-2005*, Shtëpia botuese 55, Tiranë 2006, f. 145

² P. Pastorelli, *Italia e Albania (1924-1927)*, Firenze 1967, f. 15.

³ Italia, duke e parë Shqipërinë si burim për fitime ekonomike, politike dhe strategjike bëri mjaft investime në të gjitha drejtimet. Qëllimi i i marrjes së ndihmave italiane nga Zogu ishte forcimi i ekonomisë shqiptare, që do të shërbente për forcimin e e stabilitetit dhe unitetit të brendshëm, e pse jo, edhe për t’u mohuar italianëve, me marifetet e veta, kontrollin politik që lakmonin të vendosnin në Shqipëri. Në këtë drejtim ai nuk qe krejt i pasuksesshëm. Bernard J. Fischer, *Shqipëria gjatë luftës 1939-1945*, Çabej, Tiranë 2000, f.32

⁴ Lorenzo Iaselli, *L’espansione economico-finanziaria italiana nei Balcani durante il fascismo*, Università’ degli studi di Napoli Federico II, f 67

kombëtare, nuk u dënua ashpër nga shtetet kryesore europiane.⁵

Më 6 prill 1939, një ditë para pushtimit të Shqipërisë, kryeministri britanik Chamberlain do të deklaronte në Dhomën e Komuneve se “*Qeveria e Madhërisë së Tij nuk ka interesa direkte në Shqipëri, por interesin e përgjithshëm të paqes në të gjithë botën*”.⁶ Me këtë logjikë edhe pas pushtimit të Shqipërisë dhe largimit të mbretit Zog nga vendi, Britania e Madhe nën presionin e Athinës, refuzoi ta njilhte këtë të fundit si përfaqësues të shtetit shqiptar.⁷ Për historianin Beqir Meta “*Qeveria britanike inkurajoi qëndrimin e Greqisë në pozitë të neutralitetit, përderisa dhe Italia do të mbetet neutrale. Një Itali neutrale dhe akoma më mirë paqësore, konsiderohej nga Forin Ofisi më e vlefshme se sa ballkanasit që të futeshin në luftë më detyrim. Në këto rrethana është e kuptueshme se kurrfarë inkurajimi nuk mund të pritej për rezistencën shqiptare.*”⁸ Kur Shqipëria e pavarur pushoi së ekzistuari, si rezultat i aneksimit ushtarak nga Italia fashiste, zëri zyrtar britanik i protestës ishte mjaft i dobët, krejt ndryshe nga ç’ë priste populli shqiptar. Siç shprehej më vonë në kujtimet e tij Anthony Eden, ministër i jashtëm britanik nga dhjetori i vitit 1935 deri në shkurtin e 1938, reagimi zyrtar britanik ndaj pushtimit italian përbënte “*pikën më të ulët të politikës së pajtimit (appeasement)*”⁹

1. Ideja dhe krijimi i Frontit Antifashist në Shqipëri

Pushtimi i shpejtë në 7 prill 1939, u shoqërua nga një situatë e brendshme politike aspak favorizuese për një rezistencë të organizuar, si pasojë e politikës së ndjekur nga Italia duke shfrytëzuar një pjesë të mirë të nacionalisëve shqiptarë që ishin përndjekur nga Zogu dhe kishin gjetur strehim në Itali, duke u dhënë

⁵ Një pasqyrim realist mbi mënyrën, objektivat, fazat e pushtimit të Shqipërisë nga Italia fashiste e jep historiografia italiane. Për më shumë, Basciani, Alberto., *L'impero nei Balcani, L'occupazione italiana dell'Albania (1939-1943)*, Viella, Roma 2022; Roselli, Alessandro., *Italia e Albania, Relazioni finanziarie nel ventennio fascista*, Bologna 1986; Jocomoni, Francesco., *La politica italiana in Albania*, Bologna 1965,

⁶ Petrov, Bisser., *Great Britain and the Resistance in Albania, April 1939-1941*, Etudes Balkaniques, no.1. Bulgaria: 2004, f. 54.

⁷ Meta, Beqir, *Qëndrimi i Britanisë së Madhe ndaj Shqipërisë në fillimet e Luftës së Dytë Botërore (1939-1941)*, në *Studime Historike, Nr1-2, Tiranë 2005, f. 148.*

⁸ Po aty.

⁹ Dibra, Pranvera., “*Appeasement*”, *politika britanike dhe pushtimi i Shqipërisë më 7 prill 1939*, në *Studime Historike, Nr 3-4, Tiranë 2004, f 205.*

funksione të rëndësishme qeverisëse në Shqipërinë e pas 1939-ës.¹⁰ Duhet shtuar këtu edhe situata ndërkombëtare aspak e favorshme në të cilën ndodhej Shqipëria në pranverën e vitit 1939, që shihej nga fuqitë europiane si një “kompensim” për të mbajtur nën kontroll ambicien e Musolinit. Këto e bënë gati të pamundur një qëndrim unitar mbi rezistencën. Mbështetur në sa më sipër, ndjeshmëria e klasës politike në bashkimin e shqiptarëve për luftë ishte e zbehtë në vitet e para të pushtimit,¹¹ por duke ndryshuar në vitin 1942, që ishte një vit kthese në organizimin e rezistencës shqiptare. Më 16 shtator 1942, u mbajt Konferenca e Pezës nën iniciativën e komunistëve, por e përkrahur edhe nga një grupim nacionalistësh.¹² Në gusht 1942, Komiterni kishte urdhëruar partitë komuniste të zëvendësonin frontet komuniste me fronte nacionalçlirimtare, për të thithur sa më shumë elemente brenda tyre si dhe të krijonin këshillat nacionalçlirimtarë. Kjo do të kishte ndikimin e vet edhe në Shqipëri, duke bërë që të përfshiheshin edhe elemente të tjerë që nuk kishin lidhje me idealet komuniste.¹³ Sipas procesverbalit të Konferencës së Pezës u hodh propozimi “për krijimin e një organizmi drejtues të bashkimit të shqiptarëve”¹⁴, e te gjitha forcave shqiptare atdhetare me bindje të ndryshme politike apo fetare, që do të tregonte se shqiptarët mund të ecnin të bashkuar në rrugën e përbashkët të

¹⁰ Sipas ish drejtorit të Arkivit Qëndror të Shtetit Gjet Ndoji “*Stafi politik i Musolinit kishte bashkëpunuar e mbështetur me kohë opozitën politike të qeverisë zogiste, e cila për shkak të kontradiktave antagoniste, përndiqej armiqtë prej Mbretit Zog që prej 15 vitesh (1925-1939). Duhet shënuar se kërret politikë të kësaj opozite ishin personalitete me një të shkuar historike të madhe, pjesmarrës në ngjarjet më të rëndësishme që sollën themelimin e kombit dhe të shtetit të ri shqiptar. Si në Kongresin e Manastirit, Kongresin e Elbansanit, Kuvendin e Pavarësisë në Vlorë, Kongresin e Lushnjës etj.*” Ndoji, Gjet., *Qeversija e Shqipërisë gjatë Luftës së Dytë Botërore (1939-1945)*, Fast Print, Tiranë 2023, f. 37

¹¹ Rezistencën antifashiste e nisën së pari intelektualët atdhetarë dhe studentët shqiptarë, ndërsa luftën e armatosur e filluan atdhetarët si A. Kupi, M. Ulqinaku, Gafur Jegeni, Myftar Jegeni, Nazif Mero etj., që i pritën pushtuesit italianë me armë në portet shqiptare dhe e vazhduan nacionalistët M. Peza, Ismail Agë Petrela, Shyqyri Peza, Muharrem Bajraktari, Gani Kryeziu, Hysni Lepenica, Mustafë Gjinishi, Mestan Ujaniku, etj., përpara se të dilte në skenë lëvizja nacionalçlirimtare.

¹²Dezhegiu, Muharrem., *Ideja dhe realizimi i Frontit antifashist në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore*, në Studime Historike, Nr. 1-2, Tiranë, f. 91.

¹³ Dervishi, Kastriot., *Historia e Shtetit Shqiptar 1912-2005*, Shtëpia botuese 55, Tiranë 2006, f. 465.

¹⁴ Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi 40, viti 1942. Dosja 1, fl 2. Procesverbali i Konferencës së Pezës, më 17 shtator 1942. *Diskutimi i Ramazan Jaranit në Konferencë.*

çlirimit kombëtar. Ndoc Çoba, ish-delegat i Kongresit të Lushnjës dhe anëtar i qeverisë që doli nga ky kongres, i pranuar nga të gjithë pjesëmarrësit për drejtimin e punimeve, ishte një figurë, simbol i vazhdimësisë së nacionalizmit shqiptar, në emër të të cilit kërkohesh bashkimi.¹⁵ U diskutua organizimi i forcave në një luftë të përbashkët kundër pushtuesit. Ky organizim mori më vonë emrin Fronti Nacionalçlirimtar. U miratua një rezolutë, në të cilën thuhej se përfaqësuesit e të gjitha prirjeve nacionaliste, PKSH-së, rinisë komuniste, rinisë nacionaliste dhe rinisë femërore popullore, miratonin deklaratën përkatëse, në të cilën përkrahej koalicioni kundër Boshtit; përkrahej lufta e atyre çetave që kishin luftuar deri në ato çaste; ngrihej çështja e këshillave nacionalçlirimtarë; akuzohej rëndë Mustafa Kruja etj.¹⁶

Mbledhja zgjodhi Këshillin e Përgjithshëm Nacionalçlirimtar të përbërë nga: Kamber Qafmolla-kryetar, (i cili nuk ishte i pranishëm), Mustafa Gjinishi-sekretar; Ndoc Çoba, Myslym Peza, Abaz Kupi, Enver Hoxha, Ymer Dishnica - anëtarë. Meqenëse mbledhjet do të bëheshin në Tiranë, Abaz Kupi dhe Myslym Peza autorizuan Mustafa Gjinishin t'i përfaqësonte dhe t'i lajmëronte për vendimet që do të merrte këshilli.¹⁷

Dialektika e debatit midis nacionalistëve dhe komunistëve në këtë konferencë, ishte një dialektikë që shkonte drejt bashkimit, duke e motivuar nevojën e arritjes së tij, për zgjidhjen e një detyre tjetër, atë të “vendosjes së një regjimi demokratik”,¹⁸ ku të gjithë të kenë të drejtën të jetojnë të lirë dhe të mendojnë lirisht.¹⁹ Në këtë linjë, diskutanti Ymer Dishnica shprehet se “*ishte e panevojshme të bisedohej për të ardhmen , me fjalë të tjera për regjimin, sepse populli vetë do të vendosë ç’ të dojë*”.²⁰

Konferenca përcaktoi startegjinë e këtij bashkimi në luftë për “*Shqipërinë e lirë,*

¹⁵Dezhegiu, Muharrem., *Forcat politike shqiptare nga Peza në Mukje*, në Studime Historike, Nr. 3-4, Tiranë 1991, f 106.

¹⁶ Dervishi, Kastriot., *Historia e Shtetit Shqiptar...* f. 466

¹⁷ Po aty.

¹⁸ Megjithëse mendohej “për një regjim demokratik”, lihej në heshtje çështja e rivendosjes së sovranitetit të shtetit shqiptar të paraluftës. Duhet të kujtojmë se mbreti Zog nuk kishte abdikuar dhe as kapitulluar ndaj Italisë, por i kishte shpallur luftë pushtuesit italian. Ai ruante legjitimitetin e shtetit shqiptar të paraluftës.

¹⁹ Procesverbali i Konferencës së Pezës, 17 shtator 1942, diskutimi i Koço Tashkos.

²⁰ Dezhegiu, Muharrem., *Ideja dhe realizimi i Frontit Antifashist në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore*, në Studime Historike ,Nr. 1-2, Tiranë, f. 92.

të pandashme, indipendente dhe demokratike” dhe kjo do të arrihej “me një organizim të shëndoshë të të gjithë shqiptarëve pa dallim feje, krahine, klase dhe rryme politike”.²¹

Mbi bazën e kompromiseve, Konferenca e Pezës hodhi bazat e krijimit të një lëvizjeje gjithpërfshirëse kundër pushtuesve italianë, që u pagëzua me emrin *Fronti Nacionalçlirimtar* (FNÇL). Pikat kryesore u hodhën në një platformë themelore e cila përfshinte :

1. Luftën pa kompromis kundër pushtuesve fashistë dhe tradhtarëve, për një Shqipëri të lirë, të pavarur dhe demokratike.
2. Organizimin e të gjithë shqiptarëve në një front për çlirimin kombëtar pa dallim klase, bindjeje politike, feje a krahine.
3. Ngritjen e këshillave nacionalçlirimtarë kudo, si organe të bashkimit dhe mobilizimit të popullit në luftë dhe si organe të pushtetit popullor.
4. Kryengritjen e armatosur popullore që duhej të popullarizohej dhe të përgatitej për fazën e saj të fundit, si rrjedhojë e luftës partizane.²²

2. Nga Peza në Mukje, një shans i humbur për bashkim kombëtar kundër pushtuesve.

PKSh, duke shfrytëzuar përparësinë e momentit historik në atë kohë si e vetmja forcë politike e shtrirë në territor, arriti të merrte pozita dominuese, jo vetëm në Këshillin e Përgjithshëm Nacionalçlirimtar (të përkohshëm) që u zgjodh në Pezë, por dhe në këshillat nacionalçlirimtarë, të cilat u krijuan më pas.²³ PKSH u përpoq ta maskonte synimin e saj për marrjen e pushtetit që gjatë luftës. Megjithatë, pati mjaft raste ku këshillat nacionalçlirimtarë, të cilët duhej të kishin funksione politike për organizimin e bashkimit të shqiptarëve në luftë, morëntribute të njëanshme, thjesht si organe pushteti.²⁴

Për pasojë, nuk është për t'u habitur që Këshilli i Përgjithshëm i Frontit Nacionalçlirimtar të miratonte propozimet e hedhura nga PKSH lidhur me

²¹ Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi 40, viti 1942. Dosja 1, fl 2. Procesverbali i Konferencës së Pezës, më 17 shtator 1942, f. 3.

²² Duka, Valentina., *Histori e Shqipërisë 1912-2000*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë, 2007.

²³ Dezhëgiu, Muharrem., *Ideja dhe realizimi i Frontit... f. 95*

²⁴ Po aty.

mënyrën e kryerjes së luftës dhe krijimin e fillimeve të një strukture administrative.²⁵ Fakti që PKSH kishte një shtrirje të konsiderueshme në terren (më pak në zonat katolike të Shqipërisë së Veriut) e vendosi atë në një pozitë dominuese në raport me forcat e tjera që ishin në aktivitet. Kjo fuqi dominuese gradualisht fitoi trajtën e një politike të mirëmenduar për të transformuar KPNC në një “maskë” të strategjisë komuniste për marrjen e pushtetit të vetëm, fill pas mbarimit të luftës. Kjo prepotencë zbehu qëllimin e Konferencës së Pezës që ishte bashkimi i shqiptarëve në luftë dhe zhgënjeu shumë nacionalistë. Ky transformim përjashtues i Konferencës u pranua si realitet që në 1943, kur Liri Gega shprehet se ajo “ka pas më tepër vlerë morale”²⁶. Oficeri britanik Reginald Hibbert, që vepronte në kontakt të ngushtë me rezistencën shqiptare, konfirmon devijimin e Konferencës së Pezës drejt interesit politik të një grupi të caktuar: “Enver Hoxha ishte shumë më i interesuar të siguronte epërsinë e PKSH në rezistencën shqiptare, për të marrë pushtetin, se sa të terhiqte në luftë një gamë sa më të gjerë të mundshme të fuqive nacionaliste kundër okupatorit.”²⁷

Gjithsesi, duhet theksuar se në bazë të dokumenteve arkivore (1. letra e Koco Tashkos dërguar Komiternit dhe për dijeni Miladin Popoviçit me titull: *Disa vëretje për shokun Miladin*²⁸ 2. Përgjigje e Miladin Popoviçit letrës së Koco Tashkos²⁹ 3. Procesverbali i Plenumit të KQ të PKSH i 23 nëntorit 1944, i quajtur nga Enver Hoxha “Prapaskenat e Beratit”³⁰), roli i Hoxhës është shumë periferik në Konferencë dhe organizatorët kryesorë kanë qenë Mustafa Gjinishi, Koço Tashko e Ymer Dishnica.

Një problem tjetër madhor, që solli krisjen e Konferencës së Pezës, ishte çështja e Kosovës e cila ishte dhe pika më delikate midis grupimeve politike. Me pushtimin e Jugosllavisë nga ana e Gjermanisë, në pranverë të vitit 1941, u shpall bashkimi i Shqipërisë më Kosovën. Suksesi apo dështimi i politikës së bashkimit që kishte si qëllim Konferenca ishte qëndrimi që duhet të mbante Fronti ndaj çështjes së Kosovës. Po kështu, prania e Miladin Popoviçit dhe

²⁵ Duka, Valentina., *Histori e Shqipërisë 1912-2000*, f. 218

²⁶ Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi 40, viti 1943. Dosja 10, fl. 86, diskutimi i Liri Gegës.

²⁷Hibbert, Reginald., *Fitorja e hidhur. Lufta Nacionalçlirimtare e Shqipërisë*, Shtëpia botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, Tiranë 1993, f.46.

²⁸ AQP, fondi 14, dosja 5.

²⁹ Po aty.

³⁰ AQP, fondi 14, dosja 2/1.

Dushan Mogushës pranë udhëheqjes së PKSH-së kishte sjellë përshtjellim të madh mes nacionalistëve, por jo vetëm. Këtu pati kundështime të thella midis Koço Tashkos dhe Miladin Popoviçit. Koço Tashkoja ishte kundër pikëpamjes së Miladinit se çështja e Kosovës “*s’na përket neve, por PKJ-së*”. Koço Tashkoja kërkonte që Luftën Nacionalçlirimtare në Kosovë ta udhëhiqnin shqiptarët, pasi fjala e PKJ-së në Kosovë “*nuk mund të ngrejë kandar*”. Ndërsa emisarët jugosllavë, duke njohur sensibilitetin që ngjallte çështja e Kosovës mes shqiptarëve, kërkonin të fitonin kohë dhe propozonin që çështja “*do të zgjidhet vetëm prej Jugosllavisë demokratike dhe Shqipërisë demokratike*”³¹

Çështja e pushtetit dhe çështja e Kosovës qëndronin si “Shpata e Demokleut”, jo vetëm midis komunistëve dhe nacionalistëve, por ishin arsyt kryesore të fillimit të përndjekjeve dhe eliminimeve brenda kampit komunist. Sipas studiuesit Liri Shimani “*qysh në përgatitjet e Pezës po përvijoheshin dy drejtime në PKSH: njëri grupim ishte i moderuar, mbi gjithçka vinte çështjen kombëtare, çështjen e organizimit të frontit kombëtar kundër pushtuesve. Këtu hynin Mustafa Gjinishi, Koço Tashko, Ymer Dishnica, Nako Spiro. Ndërsa në grupin tjetër bënin pjesë Miladin Popoviçi, Enver Hoxha, Ramadan Çitaku e më pas Liri Gega etj, të cilët kërkonin medoemos sigurimin e rolit udhëheqës të PKSH-së në Frontin Nacionalçlirimtar*”³²

Kur “mjegulla” e mosmarrëveshjeve mbi rezistencën shqiptare po bëhej më e dendur, në fund të vitit 1942, një ngjarje e rëndësishme ndodhi për Shqipërinë. Për herë të parë pas 4 vitesh, më 17 dhjetor 1942, ministri i Jashtëm britanik, Anthony Eden, deklaroi se shteti i tij dëshironte ta shihte Shqipërinë të “*çliruar prej zgjedhës italiane*”, duke e lënë popullin shqiptar ta zgjidhte vetë formën e regjimit që dëshironte, pas luftës.³³

Ndryshimi i qasjes së fuqive aleate ndaj rezistencës së popullit shqiptar erdhi në një moment kur hapësira e nacionalistëve brenda Frontit kishte ardhur gjithmonë dhe duke u zvogëluar. Për të realizuar bashkimin e vërtetë në luftë kishin

³¹ Për më shumë mbi qëndrimin e PKSH-së ndaj çështjes së Kosovës referohu: Plasari, Ndreci., *Politika antikombëtare e Enver Hoxhës: Plenumi i 2-të i KQ të PKSH, Berat, 23-27 nëntor 1944 : dokumente*, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Tiranë 1996.

³² Shimani, Liri., *Rreth organizimit të Konferencës së Pezës*, Studime Historike, Nr. 3-4, Instituti i Historisë, Tiranë 1991, f. 113.

³³ Dervishi, Kastriot., *Historia e Shtetit Shqiptar 1912-2005*, f. 466

obligime të gjitha forcat politike të vendit. Nëse komunistët i ngritën këshillat për të rritur ndikimin te masat në mënyrë të organizuar, nuk qëndronin prapa edhe rrymat e tjera politike për të bërë mobilizimin e simpatizantëve të tyre. Në këto rrethana, nacionalistët e gjetën të arsyeshme të mbanin qëndrimin e tyre, duke krijuar Ballin Kombëtar si organizatë që do të realizonte një program nacionalist.³⁴ Organizata përfshinte në gjirin e saj disa rryma politike dhe luftonte për një formë regjimi republikan. Në krye qëndronte një figurë e pastër dhe intelektuale siç ishte Mit'hat Abdyl Frashëri.³⁵ Programi i Ballit Kombëtar ndryshonte në mjaft drejtime nga programi i Lëvizjes Nacionalçlirimtare të drejtuar nga PKSH, por në thelb ai mëshironte platformën e bashkimit kombëtar.³⁶

Dualizmi që po shfaqej brenda rezistencës shqiptare midis Frontit dhe Ballit Kombëtar po bëhej më i theksuar, kur nacionalistët kuptuan që Fronti Nacionalçlirimtar i ngritur në Pezë po bëhej dita ditës një front përjashtues dhe po përdorej si maskë për të fshehur objektivin e komunistëve që të kishin monopolin e vendimmarrjes brenda frontit. Vetë Hoxha, në fund të luftës do të pranonte se *“ne vetë nuk e shihnim në dritën e vërtetë Frontin dhe se ç’duhej të përbënte dhe të përmblihte në gjirin e vet ky Front. Përgatitjet dhe punimet tona për këtë konferencë si referate , mbanin vulën e një pune të improvizuar, të shpejtë dhe me pikëpamje të ngushta.”*³⁷

Dalja e Ballit Kombëtar përbënte një realitet historik që duhej marrë në konsideratë nga Lëvizja Nacionalçlirimtare.³⁸ Pasi kishin njohur pikëpamjet dhe qëndrimet e njëra-tjetrës, duke patur parasysh platformën e Konferencës së Pezës, të dyja forcat politike, Lëvizja Nacionalçlirimtare dhe Balli Kombëtar, bënë takime e bisedime, si në rrafshin lokal, ashtu dhe në nivelet më të larta të tyre.³⁹ Formimi i komisioneve lokale të koordinimit që u bë në shkurt të vitit

³⁴ Po aty.

³⁵ Po aty

³⁶ AQSH, Fondi 279, dosja 21, viti 1942 f. 1 *Dekalogu i organizatës nacionaliste Balli Kombëtar.*

³⁷ AQSH, Fondi 14, dosja 2/1, viti 1944, f. 84. *Raporti i Enver Hoxhës në Plenumin II të KQ të PKSH, 23 – 26 nëntor 1944 në Berat.*

³⁸ Dezhegiu, Muharrem., *Ideja dhe realizimi i Frontit... f. 95*

³⁹ Dezhegiu, Muharrem., *Shqipëria nën pushtimin Italian (1939-1943)*, Eneas, Tiranë, 2015, f.267.

1943 ishte rrjedhojë e disa aksioneve të përbashkëta, të organizuara në Qarkun e Vlorës, të Korçës dhe në Mallkastër. Fryma dhe mesazhi i bashkëpunimit u përkthye në një situatë të favorshme në terren, e cila u kuptua edhe nga Komanda e Lartë e trupave italiane në Shqipëri. Në raportin e 12 shkurtit 1943, kjo Komandë shprehet se “Përfundimisht nuk ekzistojnë tani në Shqipëri korrente (rryma) ose parti politike, por një front i vetëm antiitalian. Jemi përballë një lëvizjeje nacionaliste komuniste, me synim që të luftojë bashkimin me Italinë, për të realizuar në formën më të ashpër programin “Shqipëria e shqiptarëve”.⁴⁰ Vera e vitit 1943, ishte shumë e suksesshme për rezistencën shqiptare, duke parë dhe problemet e mëdha që kishte ushtria italiane në frontet e tjera të luftës. Për të konsoliduar bashkëpunimin, sidomos pas rënies së Musolinit (25 korrik 1943), u bënë disa takime intensive midis rrymave të ndryshme të rezistencës shqiptare, ku më i rëndësishmi ishte takimi i Tapizës më 26 korrik 1943 midis Këshillit të Përgjithshëm Nacionalçlirimtar dhe Ballit Kombëtar. Në Tapizë u morën dy vendime të rëndësishme:

1. Të formohej një komitet i përbashkët lufte që do të quhej “Komiteti për Shpëtimin e Shqipërisë (KShSh)”.
2. Të zgjidhej çështja e Kosovës sipas Kartës së Atlantikut mbi parimet e vetëvendosjes së kombeve.

Arritja e marrëveshjes për krijimin e “Komitetit për Shpëtimin e Shqipërisë” shënonte finalizimin e një procesi historik: krijimin e Frontit të Luftës të të gjithë shqiptarëve, të organizuar në formacione politike të veçanta, por që në interes të rezistencës, viheshin nën drejtimin e një organizmi të përbashkët. Duhet theksuar që KShSh nuk cënonte strukturat, programin politik të forcave politike, por shërbente si urë kalimi që do t’u lejonte shqiptarëve të zgjidhnin qeverinë e tyre pas zgjedhjeve, nëpërmjet një procesi të lirë dhe demokratik. Fill pas takimit të Tapizës, në frymën e bashkëpunimit dhe të rezistencës me moton “*Ardhi koha të çohemi të gjithë, të vegjël e të mëdhenj, burra e gra, intelektualë, patriotë, qytetarë, katundarë dhe të rrokni armët për dëbimin sa më të shpejtë të pushtuesit të huaj nga tokat e shtrenjtë shqiptare. Ngrihuni të gjithë pra dhe betohuni rreth Flamurit të Skënderbeut. Bashkohuni rreth “Komitetit për Shpëtimin e Shqipërisë” dhe sulmoni në çdo vend e në çdo kënd, me armë e me*

⁴⁰ Dezhegiu, Muharrem., *Ideja dhe realizimi i Frontit... f. 100.*

çdo mjet armikun pushtues”⁴¹, u thirr mbledhja e Mukjes.

3. Sfidat e historiografisë shqiptare në raport me të kaluarën.

Çështja e krijimit të fronteve antifashiste të luftës në Europë, që u angazhuan në Luftën e Dytë Botërore, është një problem historiografik që ka sjellë herë pas here debate dhe polemika, për shkak të ngarkesës ideologjike që kanë pasur frontet gjatë aktivitetit të tyre, pothuajse në të gjithë Europën Lindore. Si problem historiografik, çështja e krijimit të Frontit Antifashist përgjithësisht lidhet me kushtet dhe rrethanat historike të çdo vendi, me rëndësinë gjeopolitike që kishte vendi në funksion të planeve të luftës, të unitetit politik të brendshëm dhe kapaciteteve intelektuale që mund të organizonin rezistencën.⁴² Duhet thënë se rezistenca ndaj pushtimit nazifashist ndodhi pak a shumë në të gjitha vendet e pushtuara të Europës, por shkalla e qëndresës ishte e ndryshme nga një vend në tjetrin.⁴³

Sipas historianes Ana Lalaj, “*Tema e Luftës Antifashiste është ndër më të debatuarat në historiografinë e sotme shqiptare. Trashëgimia e shkrimeve për luftën është më e shumta, krahasuar me të gjitha periudhat e historisë sonë. Në letërsinë artistike, artet pamore etj, tema e Luftës Antifashiste mbeti më e lëvruara e viteve të komunizmit. Kujtimet për luftën, jetëshkrimet për dëshmorët e saj, u bënë lënda bazë për edukimin e fëmijëve në shkolla. Po kështu, studimet e deri historikët për veprimet e formacioneve të luftës në qarqe, rrethe etj, zunë vendin kryesor në programet e institucioneve shkencore, arsimore e kulturore, të organizatave të veteranëve të luftës etj*”⁴⁴

⁴¹ AQSH, Fondi 270-1 dosja 5, Viti 1943 *Proklamata e Komitetit për Shpëtimin e Shqipërisë*, gusht 1943.

⁴² Marrëdhënia midis lëvizjeve të Rezistencës dhe koalicionit antinazist meriton një vëmendje të vecantë. Nëse nga njëra anë lëvizjet e Rezistencës nuk lindën si rezultat i nismës së ushtrive aleate, nga ana tjetër duhet theksuar se pa to asnjë formë e rezistencës nuk do të kishte arritur suksesin përfundimtar në luftën kundër nazifashizmit. Nevoja për shpengimin moral të një populli kundër shtypësit, e kombinuar me ndjenjën e të qenit pjesë e një fronti të madh antifashist dhe antinazist, i shtyn lëvizjet e Rezistencës të bashkëpunojnë në forma dhe mënyra të ndryshme me ushtritë aleate.

⁴³ Rezistenca u ndërvar nga faktorë të tillë si: gatishmëria e forcave të brendshme për të sakrifikuar, mbështetja e jashtme, gjeografia e vendit ndërluftues, tradita etj.

⁴⁴ Lalaj, Ana, *Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore*, Instituti i Historisë « Ali Hadri » Prishtinë 2014, f 47.

Sipas historianit Romeo Gurakuqi *“Lufta e Dytë Botërore është një periudhë komplekse, posaçërisht e vështirë për t’u studiuar në Shqipëri, për shkak të rezistencës së faktorëve politikë diktatorialë, hendekut të madh në mes një historiografie vendase të ngurtësuar mbi shabllone njëdimensionale, me arritjet bashkëkohore në Perëndim, lidhur kjo me tipin e Shkollës që rezistoi me kokëfortësi antishkencore në tranzicion ndër ne, bazuar mbi gjysmë të vërteta, me fiksime njëdimensionale dhe me pamundësitë praktike për një kohë të gjatë në aksesimin e arkivave dhe bibliotekave të huaja”*⁴⁵

Kjo trashëgimi e ngarkuar me emocione, ideologji dhe politikë, kishte si qëllim glorifikimin e rezistencës nën ombrellën e PKS-së, në mënyrë që të justifikohesh forma dhe administrimi i pushtetit të pasvitit 1944, ç’ka solli dhe shtrembërime të mëdha në qasjen profesionale të historianëve për të zbrërthyer vitet e luftës mbi bazën e dokumenteve arkivore. Për këtë klimë të krijuar, mban qëndrim dhe historia Sonila Boci kur shprehet: *“Ndonëse ka një sërë studimesh objektive, ata më të zhurmshmit vijnë ta mbushin opinionin publik me tezat e tyre ekstremiste që rreken, nga njëra anë, të glorifikojnë rezistencën antifashiste të shqiptarëve dhe, nga ana tjetër, ta mohojnë tërësisht këtë rezistencë, duke i veshur, thjesht dhe vetëm, me petkun e një lufte civile, terroriste e të tjera epitete të tilla”*.⁴⁶

Kjo qasje e historiografisë shqiptare e pas Luftës së Dytë Botërore e ndau shoqërinë në dy kategori: *“tradhtarët”*, ata që gjatë luftës ishin pozicionuar me formacionet politike jashtë Frontit si: Balli Kombëtar apo Legaliteti. Grupi i dytë ishte i atyre që *“ishin në anën e drejtë të historisë”* pra, ata që kishin marrë pjesë në formacionet ushtarake partizane, apo kishin mbajtur një qëndrim pozitiv ndaj lëvizjes komuniste në Shqipëri.⁴⁷

Pikërisht për këto *“shtrembërime”*, që po rezistojnë gjatë në kohë, flet me nota shqetësuese Bernard Borchart, ish-kryetar i prezencës së OSBE-së në Shqipëri: *“Regjimeve shtypëse mund t’u vijë fundi, ose me revolucion, ose nga kolapsi, por nëse ato nuk diskreditohen edhe publikisht, ideologjia e tyre mund të*

⁴⁵ Gazeta “Panorama”, 17 shtator 2024

⁴⁶ Gazeta “Panorama”, 3 dhjetor 2024.

⁴⁷ Mbi ndarjen e shoqërisë shqiptare në kategori sipas ideve politike referohu *Profile të Armikut të Popullit në diktaturë*, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentat e ish-Sigurimit të Shtetit, Onufri, Tiranë 2021.

rezistojë. Njohja e “të keqes dhe të së gabuarës” e ndan shoqërinë edhe më shumë nga regjimi i mëparshëm, dhe kontribuon te njohuria kolektive që përbën lëvizjen normative, duke hedhur poshtë ideologjinë e mëparshme, si dhe te veprimi dhe afirmimi i ndryshimit ideologjik që përbën transformimin çlirues”⁴⁸.

Në këtë “mjegull” që ka bllokuar “transformimin çlirues” për të cilin flet ambasadori Borchard, veprimi (e vepron) klasa e re politike shqiptare e post-komunizmit, e cila është kujdesur “të mbajë peng” shqiptarët me kategori dhe forma mendimi që “ushqenin” përplasjen sociale edhe pas 80 viteve të Luftës së Dytë Botërore. Për këtë situatë flet antropologu shqiptar Sokol Suparaku: “në fazën e re ku hyn shoqëria shqiptare pas rënies së regjimit, akuzat për tradhëti ndaj interesit kombëtar që partitë politike shkëmbejnë me njëra-tjetrën i bazojnë në aleancat e krijuara në të shkuarën, duke i klasifikuar këto në alenca me miq apo armiq të kombit. Kështu e djatha e re që lindi në fillim të viteve 1990, akuzonte të majtën si tradhëtarë të interesit kombëtar, sepse ishte e lidhur politikisht dhe historikisht me botën sllavo-orthodokse që kishte qenë përgjithësisht antishqiptare. E majta, nga ana e saj akuzonte, të djathtët si trashgimtare të një tradite politike që ishte bashkëpunore me nazifshistët, dhe identifikonte veten me luftën antifashiste”⁴⁹

Tranzicioni politik, ekonomik dhe social që përfshiu Shqipërinë pas rënies së regjimit komunist (1992), i dha mundësinë historiografisë shqiptare që të rishikonte qëndrimin e vet tradicional mbi këto vite, duke shfrytëzuar mundësinë e rindërtimit të ngjarjeve historike, të bazuara në kriteret e mirëfillta shkencore, larg atyre ideologjive të nacional-komunizmit që fatkeqësisht vazhdon të jetë dominante në qarqet tona akademike, universitare dhe në masën dërrmuese të shqiptarëve.⁵⁰ Për të kuptuar “pavarësinë” dhe “metodologjinë” e

⁴⁸ Pjesë nga përshëndetja e Bernard Borchard, në Konferencën Shkencore Ndërkombëtare “Emigracioni politik Shqiptar në vitet 1944-1990», Autoriteti për Informimin mbi Dokumentat e ish-Sigurimit të Shtetit, Tiranë 2021, f 24.

⁴⁹Suparaku, Sokol., *Albanità in ebollizione: studio delle dinamiche dell'identità e delle rappresentazioni sociali degli albanesi nella transizione tra epoca moderna e postmoderna*, Università Ca' Foscari Venezia

⁵⁰ Sipas intelektualit Fatos Lubonja “Ndarja nga Kampi i Lindjes, që iu shtua ndarjes në vitin 1945 nga bota perëndimore, bashkë me izolimin e Shqipërisë rriti edhe izolimin e shkencave dhe të studiuesve shqiptarë nga arritjet e shkencës botërore. Në kuadrin e ruajtjes së shqiptarëve nga “ndikimet e huaja borgjeze-revizioniste”, izolimi i shkencave, kryesisht ato albanologjike,

punës së njerëzve të shkencës në periudhën komuniste, mjafton t'i referohesh letrës përshëndetëse të 20 prillit 1949, të Institutit të Shkencave drejtuar Komitetit Qendror të PPSH-së: *“Ne, punëtorë të Shkencës në Institutin e Shkencave të Republikës Popullore të Shqipërisë, në një mbledhje të posçme që bëmë sot, lexuam vendimin e KQ të PPSH-së për trajtimin e njerëzve të kulturës, arteve, shkencave dhe sporteve dhe e pritëm me entuzjazëm dhe mirënjohje të thellë... Në këtë ditë të gëzuar ne i premtojmë Komitetit Qendror të Partisë sonë dhe Sekretarit të saj të Përgjithshëm Shokut Enver Hoxha se duke u nisur nga parimet e pavdekshme të shkencës Marksiste-Leniniste dhe sipas shëmbullit të shkencës ngadhënjimtare Socialiste Sovjetike, do të vemë gjithë forcat tona për zhvillimin dhe përparimin e shkencës, për mirëqënien dhe lumturinë e popullit, forcimin e Republikës sonë dhe paqen në botë”*.⁵¹

Ndërsa glorifikoi Luftën Antifashiste, duke ua atribuar rezistencën antifashiste tërësisht komunistëve, vendosi në funksion të kësaj linje të gjitha institucionet kulturore dhe shkencore si në nivel qendror, ashtu dhe atë lokal, duke selektuar ato burime dhe dokumente historike që shërbenin për të ilustruar idenë e parafiksuar më lart.⁵²

Përfundime

Lufta, sigurisht nuk ishte një fenomen i rastit. Ajo ishte rrjedhojë e rrethanave dhe e faktorëve që vepruan në vitet '20 dhe '30 të shekullit të kaluar. Shqipëria u përfshi në Luftën e Dytë Botërore, pasi kishte kaluar një histori të trazuar luftrash fill pas Pavarësisë si: luftat ballkanike, Luftën e Parë Botërore, kryengritjet lokale dhe Lëvizjen e Qershorit 1924. Rikuperimi i lehtë, por konstant, pas vitit 1925, u ndërpre në mënyrë të dhunshme në pranverën e vitit 1939, kur ushtria fashiste e Musolinit zbarkoi në Durrës duke përmbushur ëndrrën e kahershme të Italisë që e shikonte Shqipërinë si *“ishullin e saj të tretë”*, pas Sicilisë dhe Sardenjës. Të gjendur në këto kushte, shqiptarët u kapën në befasi, të papërgatitur, por edhe të braktisur nga faktori ndërkombëtar, ç'ka

synonte ruajtjen e monopolit të shfrytëzimit të historisë në funksion të pushtetit nga partia komuniste”. Gazeta “Panorama, 25 mars 2021

⁵¹ Buletin i Institutit të Shkencave, Botim i Institutit të Shkencave, Nr. 1, Tiranë 1949, f 4

⁵² *Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar*, Vëll I, II, Tiranë 1984 ; *Historia e Shqipërisë*, Vëll III (1912-1939), Tiranë 1984, *Historia e Partisë së Punës së Shqipërisë*, Tiranë 1982

solli një apati fillestare në fillimin e rezistencës. Pasi kaloi këtë apati, në Konferencën e Pezës u vendos që të zhvillohej një luftë e përbashkët “*pa dallim krahine, feje dhe bindjeje politike*” kundër çdo pushtuesi. Ky front i përbashkët antifashist, i lindur si një lëvizje antifashiste dhe gjithpërfshirëse, iu shmang misionit të vet në mënyrë graduale, kur në horizont u shfaq ideja e marrjes së pushtetit, pas mbarimit të luftës. Kjo devijancë solli që aktorët politikë dhe ushtarakë shqiptarë ta shikonin njëri-tjetrin me mosbesim, madje deri në armiqësi. Për pasojë, lufta kundër pushtuesve është pasqyruar si e dyfishtë: si kundër pushtuesve, ashtu dhe kundër klasës shfrytëzuese. Kjo do të thotë që Lufta Nacionalçlirimtare u shndërrua në revolucion popullor, kur ajo duhej të ishte vetëm kombëtare dhe nacionalçlirimtare. Ky lexim i tillë i rezistencës, që mori pothuajse legjitimitet të plotë pas dështimit të takimit të Mukjes, solli pasoja të rënda, jo vetëm në fushën ushtarake, por edhe në vendosjen e paqes shoqërore që ishte tronditur gjatë viteve të luftës.

Bibliografia

Alberto Basciani, *L'impero nei Balcani, L'occupazione italiana dell'Albania (1939-1943)*, Viella, Roma 2022.

Alessandro Roselli, *Italia e Albania, Relazioni finanziarie nel ventennio fascista*, Bologna, 1986.

Ana Lalaj, *Dosjet e Luftës*, Toena, Tiranë, 2004.

Ana Lalaj, *Shqiptarët gjatë Luftës së Dytë Botërore*, Instituti i Historisë « Ali Hadri », Prishtinë 2014.

Beqir Meta, *Qëndrimi i Britanisë së Madhe ndaj Shqipërisë në fillimet e Luftës së Dytë Botërore (1939-1941)*, *Studime Historike*, Nr.1-2, Tiranë, 2005.

Bernard J. Fischer, *Shqipëria gjatë luftës 1939-1945*, Çabej, Tiranë, 2000.

Bisser Petrov, *Great Britain and the Resistance in Albania, April 1939-1941*, *Ettudes Balkaniques*, no.1. Bulgaria, 2004.

Buletini i Institutit të Shkencave, Botim i Institutit të Shkencave, Nr. 1, Tiranë, 1949.

Dejvid Smajli, *Vitet e mia shqiptare '43-'45, kujtimet dhe fotot e kolonelit anglez gjatë Luftës së Dytë Botërore*, UET Press, Tiranë, 2012.

Emigracioni politik Shqiptar në vitet 1944-1990, Autoriteti për Informimin mbi Dokumentat e ish-Sigurimit të Shtetit, Tiranë, 2021.

Faik Quko, *Qëndresa Shqiptare gjatë Luftës së Dytë Botërore, (1941-1944)*, Vëll II, Ilar, Tiranë, 2006.

Aktet e Seminarit Shkencor organizuar në kuadër të 80-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë

Francesco Jocomoni, *La politica italiana in Albania*, Bologna, 1965.

Gjet Ndoji, *Qeversija e Shqipërisë gjatë Luftës së Dytë Botërore (1939-1945)*, Fast Print, Tirane 2023,

Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar, Vëll I, II, Tiranë, 1984.

Historia e Partisë së Punës së Shqipërisë, Tiranë, 1982.

Historia e Shqipërisë, Vëll. III (1912-1939), Tiranë, 1984.

Kastriot Dervishi, *Historia e Shtetit Shqiptar 1912-2005*, Shtëpia botuese 55, Tiranë, 2006.

Liri Shimani, *Rreth organizimit të Konferencës së Pezës*, Studime Historike, Nr. 3-4, Instituti i Historisë, Tiranë, 1991.

Lorenzo Iaselli, *L'espansione economico-finanziaria italiana nei Balcani durante il fascismo*, Università degli studi di Napoli Federico II.

Muharrem Dezhëgiu, *Forcat politike shqiptare nga Peza në Mukje*, Studime Historike Nr. 3-4, Tiranë 1991.

Muharrem Dezhëgiu, *Ideja dhe realizimi i Frontit antifashist në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore*, Studime Historike Nr.1-2, Tiranë, f. 91

Muharrem Dezhëgiu, *Shqipëria nën pushtimin Italian (1939-1943)*, Eneas, Tiranë, 2015.

Ndreci Plasari, *Politika antikombëtare e Enver Hoxhës: Plenumi i 2-të i KQ të PKSH, Berat, 23-27 nëntor 1944*, dokumente, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Tiranë, 1996.

P. Pastorelli, *Italia e Albania (1924-1927)*, Firenze 1967.

Pranvera Dibra, *“Appeasement”, politika britanike dhe pushtimi i Shqipërisë më 7 prill 1939*, Studime Historike Nr 3-4, Tiranë, 2004.

Profile të « Armikut të Popullit në diktaturë » Autoriteti për Informimin mbi Dokumentat e ish-Sigurimit të Shtetit, Onufri, Tiranë, 2021.

Reginald Hibbert, *Fitorja e hidhur. Lufta Nacionalçlirimtare e Shqipërisë*, Shtëpia botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, Tiranë, 1993.

Sokol Suparaku, *Albanità in ebollizione: studio delle dinamiche dell'identità e delle rappresentazioni sociali degli albanesi nella transizione tra epoca moderna e postmoderna*, Università Ca' Foscari Venezia

Uran Butka, *Lufta civile në Shqipëri 1943-1945*, Drier, Tiranë, 2006.

Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë 1912-2000*, Shtëpia Botuese e Librit Universitar, Tiranë 2007.

Aktet e Seminarit Shkencor organizuar në kuadër të 80-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë

Arkivat

Arkivi Qendror i Shtetit, Fondi 40, viti 1942. Dosja 1, fl 2. Procesverbali i Konferencës së Pezës, më 17 shtator 1942.

AQP, fondi 14, dosja 5.

AQP, fondi 14, dosja 2/1.

AQSH, Fondi 279, dosja 21, viti 1942 f. 1 Dekalogu i organizatës nacionalist Balli Kombëtar.

AQSH, Fondi 14, dosja 2/1, viti 1944, f. 84. Raporti i Enver Hoxhës në Plenumin II të KQ të PKSH, 23 – 26 nëntor 1944 në Berat.

AQSH, Fondi 270-1 dosja 5, Viti 1943 Proklamata e Komitetit për Shpëtimin e Shqipërisë, gusht 1943.

KRAHINA E VAKËFEVE GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

Dr. Orjon AGO

*Departamenti i Historisë dhe i Gjeografisë
Universiteti “Fan S. Noli”*

Abstrakt

Ky punim synon të hedhë dritë mbi ngjarjet e Luftës së Dytë Botërore të zhvilluara në Krahinën e Vakëfeve. Kontributi dhe roli i banorëve të zonës në këtë luftë është i njohur, por ka disa ngjarje të veçanta, të cilat për arsye të ndryshme nuk janë përmendur, janë fshehur ose janë shtrembëruar. U mohua kontributi i disa familjeve dhe i shumë individëve në këtë luftë, sepse historia u shkrua nën syzet e luftës së klasave. U vranë njerëz të pafajshëm dhe për 45 vjet ata u lanë në harresë. Askush nuk u fajësua e askush nuk kërkoi falje për këto krime.

Detyra e historianit është të hedhë dritë mbi faktet dhe të sjellë të vërtetën. Nisur nga këto parime, punimi sjell për lexuesin ngjarjet ashtu si kanë ndodhur, duke mos mbajtur anë dhe duke u qëndruar besnik dokumenteve arkivore, monografive, por edhe kujtimeve të pasardhësve.

Fjalë kyç: *dokumente arkivore, Lufta e Dytë Botërore, Krahinë e Vakëfeve, monografi*

Hyrje

Krahina e Vakëfeve,* ka qenë vatër e kulturës dhe arsimit shqip gjatë periudhës së Rilindjes, vlera që u transmetuan edhe në periudhat e mëpasshme. Në këtë krahinë, që në vitin 1854 u çel një shkollë shqipe¹, 23 vite përpara Mësonjëtores.

* Emri i kësaj krahine lidhet ngushtë me emrin e Ilia Panariti (i biri i priftit Papa Petro), i mbiquajtur Iljaz Bej Mirahori nga Panariti i Korçës. Ka diskutime për këtë çështje, se kush duhet përfshirë dhe kush jo në “Vakëfe”. Mbështetur në (fermanet e viteve 1496, 1497, 1503) të Sulltan Bajazit të II-të dhe Vakufnamenë (testamentin e Mirahorit, 1505), këtu përfshihen Leshnja, Vithkuqi, Panariti, Trebiçka, Treska, Stratobërdha dhe Katundi. Natyrisht që pjesë e kësaj krahine është edhe Graboçka si dhe Shtylla, që njihet si fshat i ri, themeluar në vitin 1873. Që nga ajo kohë, treva filloi të thirrej me emrin Vakëf, Pra, nga emër pronësie, Vakëfi u shndërrua natyrshëm në një nocion gjeografik, që tregonte një krahinë të tërë me disa fshatra dhe që thirrej Vakëfe. Është fakt se, në të gjitha dokumentet e huaja e të historiografisë shqiptare, që nga shekulli XV-të e kësaj krahinës e gjejmë me emrin Vakëfe. Shih: Sejdin Ramo “Ilia Panariti dhe Korca”, (Korçë: Kotti, 2003), shih Petrit Zeneli, “Gjurmime në krahinën e vakëfeve Korçë”, (Tiranë: Mirgeeralb, 2010), 28-33

¹ Në këtë shkollë djemtë me nga një abetare bërë prej Naum Bredhit, të cilin më të shumtit e dinë me emrin Naum Veqilharxhi, e me sa gaz i mësonin zantoret (zanoret) a, u, y, e, ë, i; po për

Në vitin 1892,² në Treskë u çel shkolla shqipe me mësues Nuçi Naçin për të forcuar rrënjët e atdhedashurisë tek kjo popullsi arsimdashëse. Krahinë e Vakëfeve ka qenë gjithashtu edhe një qendër e çetave patriotike gjatë periudhës së Rilindjes dhe Luftës së Parë Botërore. Gjatë kësaj periudhe, Zona e Vakëfeve ishte një nga zonat që pësoi shumë shkatërrime, deri edhe masakra. Këto ngjarje forcojnë ndjenjat për atdhedashurinë, prandaj banorët e krahinës e zgjeruan aktivitetin e tyre në mbrojtje të Korçës dhe rajonit të saj.

Mbajtja në gjendje pushtimi e territoreve juglindore të Shqipërisë pas Shpalljes së Pavarësisë, nga ana e Greqisë, bëri që patriotët e Krahinës së Vakëfeve të bashkoheshin me Themistokli Gërmenjin e Sali Butkën për largimin e trupave greke gjatë fundit të vitit 1913 dhe fillimit të vitit 1914. Trupat e xhandarmërisë dhe vullnetarët çliruan fshatrat e Krahinës së Vakëfeve në janar të vitit 1914 dhe ngritën në to flamurin kombëtar.³ Ngritja e flamurit kombëtar në harkun kohor të datave 11-16 janar 1914 ishte ngjarje e rëndësishme jo vetëm për Krahinën, por edhe një sinjal se Korça do të çlirohej së shpejti. Në mars 1914 çeta e Qamil Panaritit dha kontributin e saj në administrimin e Korçës pas largimit të trupave greke. Në ngjarjet e 2-5 prillit të vitit 1914, kjo çetë luftoi për mbrojtjen e qytetit, në ndihmë të xhandarmërisë së sapoformuar shqiptare, që vepronte në Korçë. Barbaritë e kryera nga bandat greke në 10 korrik 1914 në zonën e Panaritit nuk e thyen shpirtin liridashës të krahinës.⁴ Nga kjo krahinë dhanë jetën shumë luftëtarë në mbrojtje të atdheut, prandaj nuk është i rastësishëm fakti që, nga 102 dëshmorë që ka Qarku i Korçës për periudhën deri në 7 prill 1939, 61 dëshmorë janë nga kjo zonë.⁵

Në 7 prill të vitit 1939, nisi pushtimi italian ndaj Shqipërisë. Në qarkun e Korçës trupat italiane hynë më 10 prill. Rezistenca e ushtrisë shqiptare rezultoi e dobët dhe pushtuesit u shtrinë shpejt në të gjithë vendin. Në ditët kur pritej ardhja e ushtrive italiane, në rajonin e Korçës u organizuan një sërë mitingjesh të cilat kundërshtonin pushtimin e Shqipërisë.

fat të lig nuk ndenja përveçse një dimër, dëshmon Spiro Dine. Shih Petrit Zeneli, “Gjurmime në krahinën e vakëfeve Korçë”, (Tiranë: Mirgeeralb, 2010), 35

² Nuci Naci filloi mësues në shkollën shqipe të Treskës, që u çel më 1 shtator 1892, pa lejen e autoriteteve osmane, por me mbështetjen e vendosur të fshatarëve arsimdashës dhe me ndihmën e shoqërisë “Drita” të Bukureshtit. Shih: Hysni Murrizi, “Nuci Naci”, (Tiranë: Instituti i Studimeve Pedagogjike, 1986), 16

³ Petraq Katro, “Kush ishte Sali Butka: kronikë historike”

⁴ Petrit Zeneli, “Masakra e Panaritit”, (Tiranë: DDS, 2014), 39-54, Shih edhe Kosta Papa Tomorri, “Barbaritë greke në Shqipëri. Kujtime Historike 1913-1914”, (Tiranë: Naimi, 2012), 163

⁵ Ministria e Mbrojtjes, Dëshmorët e Atdheut, (Tiranë: 2012) Dëshmorët e Atdheut deri në periudhën 7 prill 1939

Pasi kaloi tronditja e parë, njerëz dhe grupe të ndryshme shoqërore filluan një rezistencë ndaj pushtuesit italian sipas mënyrës së tyre në rajonin e Korçës dhe në gjithë Shqipërinë. Në ditën e përvjetorit të Pavarësisë Kombëtare, më 28 Nëntor 1939, në Korçë në mënyrë spontane u organizua një demonstratë për festimin e ditës kombëtare, si në shumë qytete të vendit. Në këtë demonstratë të madhe, spikati figura e Abaz Ermenjit, i cili u arrestua dhe u dërgua në ishullin e Ventotenes, ku mbaheshin edhe të burgosur të tjerë antifashistë.

Në 20 nëntor të vitit 1940 Korça u pushtua nga ushtria greke e cila filloi përpjekjet për ta trajtuar pushtimin si një çlirim. Mospranimi i Komitetit për Mbrojtjen e qytetit që të kthehej në një vegël të autoriteteve greke bëri që këta të fundit të krijonin një “Këshill Bashkiak” në përbërje të të cilit hynë ata që njiheshin si grekomanë. Në 28 nëntor u përsërit skenari i një viti më parë. Popullsia e qytetit të Korçës dhe ajo e rajonit zhvilluan demonstrata me flamuj kombëtarë dhe këngë patriotike.⁶

Italianët u rikthyen pas gati gjashtë muajsh në rajonin e Korçës, por prestigji i tyre, si një fuqi e madhe, kishte rënë. Në 8 nëntor 1941 në Korçë u organizua një tjetër demonstratë e fuqishme. Numri i demonstruesve ishte i madh dhe shkaktoi shqetësim tek autoritetet pushtuese italiane, të cilat morën masa për ta shpërndarë atë. Këmbëngulja e demonstruesve çoi në përlëshje me trupat italiane, të cilat qëlluan mbi civilët duke vrarë dy demonstrues⁷ dhe duke plagosur mbi 30 të tjerë. Në fillim të vitit 1942 lëvizja komuniste filloi të jetë me aktive. Nga prefektura e Korçës lajmërohet Ministria e Brendshme për gjetjen e trakteve në disa banesa në qytetin e Korçës.⁸ Këto veprime paralajmërojnë rritjen e veprimtarisë së tyre.

Pas këtyre ngjarjeve, rezistenca antifashiste u zhvendos në zonat malore të rajonit të Korçës. Një nga zonat më të spikatura të kësaj rezistencë ishte Krahina e Vakëfeve. Kjo krahinë shtrihet në jugperëndim të Qarkut të Korçës (në një sipërfaqe prej rreth 230 km²) dhe kufizohet me Kolonjën, Përmetin, Skraparin.

1. Rezistenca në Krahinën e Vakëfeve gjatë Luftës së Dytë Botërore

Krahina e Vakëfeve spikati edhe gjatë Luftës së Dytë Botërore në rezistencën shqiptare kundër pushtuesve. Ka disa arsye që kjo zonë u bë një nga qendrat më të fuqishme të rezistencës. Së pari, ashtu si u theksua më sipër, kjo krahinë është

⁶ Ligor K. Mile, Stavri Naçi, “Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare në qarkun e Korçës 1939-1944”, (Tiranë: Akademia e shkencave të RPS të Shqipërisë, 1986), 84-85

⁷ Muharrem S. Butka, “Rruga e vështirë e lirisë”, (Tiranë: Maluka 2022), 192-193

⁸ Arkivi i Ministrisë Mbrojtjes, (më tej AMM), Viti 1942, Dosja nr 1, Komanda e Qarkut Korçë, Mbi shpërndarjen e disa manifestash në dëm të shtetit

me tradita dhe kontribute të mëdha në dobi të çështjes kombëtare. Së dyti, një faktor i rëndësishëm në ndihmë të luftës ishte edhe terreni i thyer dhe malor i zonës, që e vështirësonte mbajtjen nën kontroll të territorit nga trupat ushtarake italiane dhe më vonë gjermane.

Gjatë vitit 1942, në Krahinën e Vakëfeve u krijuan dhe vepruan disa çeta që iu kundërvunë me armë pushtuesve italianë. Një nga çetat e para ishte ajo e Panaritit, komandant i së cilës u caktua Dajlan Gani Panariti. U krijua çeta e Vithkuqit, me komandant Nasi Vithkuqi, por edhe çeta të tjera si ajo e File Backës, Demir Staraveckës,* Riza Kodhelit, Xhelal Staraveckës, të krijuara në zonat kufitare të Skraparit dhe Kolonjës⁹. Ato e shtrinë aktivitetin e tyre edhe në Krahinën e Vakëfeve, për shkak të lidhjeve që kishin me banorët e zonës. Në këtë vit, duke u goditur nga çetat partizane, postat italiane i detyruan trupat e tyre të tërhiqen në drejtim të Vithkuqit. Kështu që, në këtë periudhë, Krahina e Vakëfeve përtej Vithkuqit ishte zonë e lirë e çliruar nga trupat italiane. Në prill të vitit 1943 posta italiane u detyrua të tërhiqet edhe nga Vithkuqi.¹⁰

Aktiviteti i çetave shqetësoi trupat pushtuese italiane të cilat ndiqnin me vëmendje veprimtarinë e tyre. Gjatë verës së vitit 1943, zona midis Vithkuqit dhe Vakëfeve vlerësohej kështu nga Komanda e Epërme e forcave italiane në Shqipëri: *“Zona Vithkuq-Shtyllë-Panarit del se është qendra taktike, logjistike dhe organizative e krahinave të Korçës dhe një nga qendrat më të rëndësishme të të gjithë lëvizjes kryengritëse shqiptare”*.¹¹

Konstatimi i komandës italiane del të jetë i saktë, sepse në këtë zonë u zhvilluan disa ngjarje me rëndësi gjatë verës së vitit 1943. Kështu, me urdhër të Shtabit të Përgjithshëm të UNÇ më 10 korrik 1943 u formua batalioni “Qamil Panariti” mbi bazën e çetave të krahinës. Në fund të korrikut, në Vithkuq u gjendën anëtarët e Shtabin të Përgjithshëm të UNÇ, batalionet “Hakmarrja” dhe “Qamil Panariti”. Në këtë krahinë, më 15 gusht u formua Brigada I që ishte dhe formacioni më rëndësishëm i Luftës.¹²

Krijimi i batalionit “Qamil Panariti” u shoqërua më luftime të herëpashershme

* Çetat e File Backës dhe Demir Staraveckës janë nga çetat e para nacionaliste të cilat kishin kishin një aktivitet sidomos gjatë pushtimit italian. Këto çeta i pritën italianët me armë në prill të 1939 dhe vazhdimisht i sulmonin postat italiane. Gjatë vitit 1942 këto çeta vunë kontakte me Frontin, por duke mos pranuar komistarët e partisë komuniste pranë çetave të tyre ata vepruan të pavaruar deri në fillimet e luftës civile kur u asgjësuan nga forcat partizane gjatë përplasjeve të armatosura mes grupeve për të cilat do shkruajmë më vonë.

⁹Muharrem Dezhgiu, Shqipëria nën pushtimin italian (1939-1943), (Tiranë: Eneas, 2015), 276-277

¹⁰ Mile & Naci, Lufta, 270

¹¹ Po aty,

¹² Po aty, 272

me forcat italiane. Midis datave 5 dhe 15 gusht skuadrat e batalionit “Qamil Panariti”, kryen aksione duke dalë shpeshherë edhe nga zona e tyre, në fshatrat afër Korçës ose në rrugën Korçë-Ersekë duke mos lejuar forcat italiane të futeshin në Krahinën e Vakëfeve.¹³

Duke parë pamundësinë për të ndërhyrë në këtë zonë me forca të pakta, në 26 gusht 1943, komanda fashiste në Korçë vuri në lëvizje mijëra trupa në drejtim të Vithkuqit. Në mëngjesin e 26 gushtit, trupat italiane sulmuan fshatrat Bellovodë e Gjanç. Si pasojë e ndërhyrjes italiane u morën masa për zhvendosjen e spitalit, të infermierëve e të të plagosurve.

Në mbrojtje të Vithkuqit këtë herë luftuan batalionet “Qamil Panariti” dhe “Tomori” që tashmë ishin pjesë e Brigadës I. Luftimet u zhvilluan në rrugën automobilistike që të çonte në Vithkuq. Në mbrojtje të krahinës u rreshtuan rreth 1000 partizanë. Por mbas dy ditë luftimesh të ashpra dhe bombardimeve nga artilera e rëndë, italianët mundën të hyjnë në Vithkuq e Shtyllë ku shkatërruan e dogjën gjithçka. Forcat partizane u tërhoqën në drejtim të pyjeve të Mashkullorit dhe Panaritit,¹⁴ ku u rigrupuan dhe pas një sërë sulmesh të befasishme i detyruan forcat fashiste të largoheshin nga Shtylla e Vithkuqi për në Korçë. Ky ishte dhe aksioni i fundit i madh italian për të vënë krahinën nën kontroll.

Në 8 shtator 1943 Italia fashiste kapitulloi. Vendin e saj e zuri një armik më i ashpër, Gjermania naziste. Gjermanët u pritën me armë në Qarkun e Korçës. Pasi u futën në qytetet kryesore të qarkut, gjermanët morën masa për të goditur qendrat e qëndresës. Në 1 tetor 1943 u sulmua prej tyre Vithkuqi. Përleshje të ashpra u zhvilluan në Vithkuq midis banorëve, partizanëve të batalionit “Qamil Panariti” dhe trupave gjermane. Mbrojtësit përballuan sulmin e trupave gjermane, të cilat nuk mundën të hynin në fshat dhe u tërhoqën.¹⁵

Si pasojë e goditjeve të shumta që morën trupat gjermane që u futën në Shqipëri, komanda gjermane vendosi zhvillimin e një operacioni të madh për zhdukjen e rezistencës shqiptare. Planet e mësymjes gjermane në drejtim të krahinës së Vakëfeve nisën në datën 9 janar 1944. Një kolonë u nis në drejtimin Bellovodë-Vithkuq-Shtyllë. Një kolonë tjetër u nis nga Erseka dhe mori drejtimin Qafzez-Selenicë e Pishës-Panarit.¹⁶

Në datën 10 janar gjermanët kishin arritur në Shtyllë. Luftimet më të ashpra të këtij operacioni në zonën e Korçës u zhvilluan në malësitë e Gjergjevicës dhe

¹³ AMM, Viti 1943, Dosja nr 1, Historiku i formimit të batalionit “Qamil Panariti”.

¹⁴ AMM, Viti 1943, Dosja nr 3, Raport mbi luftimet e bëra nga Brigada I dhe e batalioneve të Qarkut të Korçës për mbrojtjen e Vithkuqit gjatë muajve maj shtator-1943 nga sulmi i ushtrisë italiane, fl 1

¹⁵ AMM, Viti 1943, Dosja nr 8, Komunikata që tregojnë mbi luftimet në qarkun e Korçës, fl 4

¹⁶ Mile & Naci, “Lufta”, 436

Oparit. Për shkak të dimrit të ashpër, trupat gjermane nuk ndërmorën ndonjë sulm të madh në drejtim të Panaritit nga ana e Vithkuqit. Edhe ekspedita e një skuadre alpine gjermane, që kaloi Mashkullorin, u zbraps. Në memorien e banorëve të zonës ruhet kujtimi i emrit të Xhafer Cenko Lubonjës, i cili mundi të ndalë këtë sulm, duke vrarë dhe dy gjermanë. Zona e Vakëfeve përtej Mashkullorit mbeti e çliruar. Në 20 Janar trupat gjermane u larguan nga Shtylla në drejtim të Vithkuqit e më pas në Korçë.

Operacioni i dytë i madh i gjermanëve kundër krahinës nisi më 28 maj 1944, i cili njihet si Operacioni i Qershorit. Në zonën e Korçës u sulmuan: Maliqi, Voskopi, Polena, Vithkuqi. Pasi u thye mbrojtja, sulmi u drejtua drejt Moglicës, Qafës së Martës dhe Qafës së Becit. Së bashku me sulmet që vinin nga ana e Elbasanit dhe e Përmetit synohej mbyllja e shtigjeve dhe rrethimi i partizanëve në Malin e Ostrovicës dhe të Oparit. Mbrojtja e Krahinës së Vakëfeve iu ngarkua batalionit “Tomorri”. Në 6 qershor u zhvilluan luftime të ashpra në Vithkuq, por pa mundur të ndalohej sulmi i trupave gjermane. Në datën 7 qershor aviacioni dhe artileria gjermane bombarduan Panaritin.¹⁷ Luftime të ashpra u zhvilluan edhe në vijën Mashkullorë-Çëmericë-Qafa e Martës, midis trupave gjermane dhe atyre partizane, por ishte e pamundur të ndalohej ofensiva gjermane. Në datën 8 qershor gjermanët hynë në Panarit e Grabockë. Partizanët e këtij batalioni panë nga larg sesi po digjeshin shtëpitë e Panaritit dhe Grabockës.¹⁸ Gjithsesi, gjermanët nuk mundën të qëndronin gjatë në këto zona. Batalioni “Hakmarrja” i dëboi forcat gjermane duke sulmuar nga ana e Gjergjevicës dhe në datën 12 mbërriti në Vithkuq.

2. Spitalet partizane në Krahinën e Vakëfeve

Krahina e Vakëfeve gjatë vitit 1943 e në vazhdim u kthye në një vend të sigurt për forcat partizane. Nuk është e rastësishme që disa ngjarjet më të rëndësishme që lidhen më Luftën e Dytë Botërore u zhvilluan në këtë zonë. Siç u theksua më sipër, terreni i thyer dhe malor i zonës, pa rrugë për lëvizjen trupave dhe automjeteve ushtarake, e vështirësonte shumë mbajtjen nën kontroll të këtyre zonave nga postat ushtarake italiane dhe më vonë gjermane. Këta faktorë gjeografikë së bashku me traditën liridashëse të vakëfllinjve bënë që krahina të shndërrohej në një zonë të lirë ku vepronin forcat partizane.

Kontribut për luftën vakëfllinjte kanë dhënë edhe në prapavijë. Këto prapavija shërbenin jo vetëm si bazë për t'u tërhequr nga sulmet e ushtrive pushtuese italiane e më vonë gjermane, por edhe për furnizime me ushqime, veshmbathje

¹⁷ Kollumbi, “Ditari”, 178

¹⁸ Mile & Naci, “Lufta”, 543

e sidomos në sigurinë e partizanëve të plagosur. Pra, banorët e këtyre fshatrave ofruan jo vetëm mikpritjen, por edhe mbrojtjen e partizanëve.¹⁹ Familjet e mëdha të zonës, duke filluar nga Vithkuqi, Katundi, Panariti e Graboçka i kthyen shtëpitë e tyre në spitale. Në muajt maj-qershor të vitit 1943k, në Vithkuq u ngrit dhe funksionoi infermeria, ku u përgatitën edhe infermierët e parë. Pas djegies së Vithkuqit, kjo infiermieri në korrik 1943 u vendos në Katund. Këtu u ngrit spitali, i cili funksionoi deri nga mesi i dhjetorit të vitit 1943.²⁰ Pas kësaj, në muajt pasardhës në këtë krahinë u ngritën e funksionuan edhe dy spitale partizane të tjera: i Panaritit dhe i Grabockës.

Spitali i Grabockës, për shkak të pozitës gjeografike*, u kthye në spitalin më të sigurt të Krahinës së Vakëfeve, por edhe të krahinave përreth. Fshati është i vendosur në një pllajë të bukur, përkrah lumit Osum në kufi me Skraparin, Përmetin dhe Kolonjën. Ky pozicion u ofronte mbrojtje partizanëve të plagosur dhe mundësi tërheqjeje në rast sulmesh nga pushtuesit. Numri i partizanëve të shtruar në këtë spital, në bazë të dokumenteve arkivore, është shumë i madh, për shkak se periudha kur funksionoi, dhjetor 1943-korrik 1944, përkon me luftimet që u zhvilluan në dy operacionet gjermane.

Janë të shumta dëshmitë që flasin për partizanët e plagosur, në spitalin e Grabockës. Gaqo Kollumbi, intendent, u dërgua i plagosur në Grabockë në datën 30 janar 1944. Në kujtimet e tij ai flet për një numër të madh të plagosurish që ishin të shtruar në këtë spital. Në këtë kohë aty ishte i plagosur Gjeli Argjiri komandat i Batalionit të Dytë të Brigadës së Parë.²¹ Muharrem Butka, komandant i Qarkut të Korçës për prapavijat, siç dëshmon edhe vetë, në shkurtin e vitit 1944 u dërgua në spitalin e Grabockës dhe aty ndenji rreth 1 muaj ku u mjekua dhe mori veten nga plagët e shumta.²²

¹⁹ Arkivët Qëndror Shtetëror (më tej AQSH) ish Arkivi Qëndror i Partisë, (më tej ish AQP) Fondi 42 (më tej F), APL 52, Komandës së Qarkut, Spitalit Ushtarak të Nikollarës

²⁰ AQSH, ish AQP, F 42, APL 9, Komandës Shtabit të Qarkut

* Graboçka në këtë kohë ishte një fshat i vogël, por një fshat relativisht i pasur me toka pjellore e tufa me bagëti. Banorët e fshatit kishin ardhur nga fshati ngjitur i Panaritit. Pothuasje të gjitha familjet kishin patur nga një anëtar të familjes si emigrant ekonomik të SHBA, dhe kjo e kishte forcuar gjendjen ekonomike të fshatit. Me paratë e fituara aty ata kishin blerë Grabockën nga bejlerët e Frashërit dhe kishin ndërtuar shtëpi të reja mjaft moderne për kohën. Ai ishte një fshat me kulturë, disa prej tyre ishin të arsimuar dhe kishin shërbyer edhe si mësuesit e parë të zonës. Për shkak të emigacionit në SHBA pothuajse çdo kryefamiljar dinte anglisht. Emigrimi në Amerikë dhe kontaktet që ata kishin vendosur me Federatën Panshqiptare Vatra i kishte bërë ata njerëz edhe më atdhetare. Në regjistrat e Vatrës gjenden emrat e shumë panaritasve që kishin kontribuar me para për ngritjen dhe funksionimin e saj.

²¹ Gaqo Kollumbi, “Ditar partizan (shtator 1943-tetor 1944), (Tiranë: Naim Frashëri, 1967), 95

²² Muharrem S. Butka, “Rrugë e vështirë e lirisë”, (Tiranë: Maluka 2022), 214

Përveç këtyre figurave të njohura, në spitalin e Grabockës, sipas dokumenteve arkivore, kanë qenë të shtruar shumë të plagosur që ishin partizanë të thjeshtë si: Gaqo Gubeta,²³ Zaim Kurto Pinderi, Safet Ali Lushka, Muhamet Selenica etj. Një nga të plagosurit e shumtë të spitalit të Grabockës ishte edhe Orhan Panariti, i plagosur në Dërsnik të Korçës.²⁴ Partizanët e plagosur që dërgoheshin në këtë spital vinin edhe nga zona të largëta. Në zonën e Barçit, gjatë korrikut të vitit 1944 u zhvilluan luftime të shumta mes forcave të Brigadës VI me forcat gjermane. Si pasojë e luftimeve, u plagosën një numër i madh partizanësh. Siç del nga dokumentet arkivore, ata u dërguan për t'u mjekuar në spitalin e Grabockës.²⁵

Ky spital nuk ishte i organizuar në një ndërtesë të vetme, por në disa nga shtëpitë e fshatit. Secila shtëpi ofronte ndihmën e saj për strehimin, ushqimin, higjienën dhe ruajtjen e të plagosurve edhe pse në kushte të vështira.* Fshati, në fakt, ishte kthyer i gjithi në spital. Çdo familje strehonte partizanë të plagosur, infermiere, mjekë etj. Qendra kryesore e spitalit, ku ishin shtruar të plagosurit, ishte në odat e Sali e Riza Agos. Të shtruar të tjerë ishin vendosur në shtëpinë e Novruz Hajros, apo në shtëpinë Ali e Dilaver Duros. Infermiera ishte vendosur në shtëpinë e Riza e Nexhpit Kajmakut. Kuzhina ishte e vendosur në shtëpinë e Kalem e Sulejman Maliqit. Mjekët (si Petro Cani etj) qëndronin në shtëpinë e Bektash Zenelit.

Në këtë spital, në sajë të talentit të madh të mjekëve, u kryen edhe ndërhyrje kirurgjikale në kushte të vështira. Mjeku Petro Cani përdornte edhe mjete rrethanore për operacione, kur ishte fjala për të shpëtuar të plagosur që rrezikonin jetën. Ai përdori madje dhe sharrën për të prerë këmbët e gangrenizuara të një partizani të plagosur,²⁶ të quajtur Pandi Kocaqi.*

Spitalet që funksiononin në Krahinën e Vakëfeve u përballën dy herë më sulmet e forcave gjermane. Në të dyja rastet partizanët e plagosur u transferuan në vende më të sigurta, por banesat-spitale u dogjën gjatë Operacionit të Qershorit. Operacioni gjerman i dimrit 1943-1944 i vuri në lëvizje të plagosurit e spitaleve

²³ AQSH, ish AQP F 42, ALP 90, Shtabit të Qarkut të Korçës.

²⁴ AQSH, ish AQP F 42, APL 52, Shtabit të Qarkut të Korçës

²⁵ AQSH, ish AQP, F 42, APL 52, Zona e lirë 9/VII, 44. Shtabit të Qarkut të Korçës.

* Duhet theksuar se gjatë luftës italo-greke e gjithë krahina kishte pësuar dëme të mëdha. Palët ndërluftruese kishin konfiskuar rezervat ushqimore, rrëmbyer bagetitet e imta dhe kafshët e punës për ti përdorur për transport.

²⁶ Kollumbi Gaqo, "Ditari", 91

* Partizani Pandi Kocaqi u dërgua në Grabockë pasi u gjend i ngrirë në borë. Ai iu nënshtua operacionit duke iu prerë të dyja këmbet. Për të u kujdes nënë Shazo Duro. Pandi jetoi dhe u kthye pranë familjes, madje krijoi edhe familjen e tij.

të Panaritit dhe Grabockës. Në këtë situatë, të plagosurit që ndodheshin në spitalet e kësaj zone, u grumbulluan në Grabockë dhe u drejtuan për në Frashër të Përmetit. Të plagosurit e spitalit të Grabockës, në kushte të vështira, u detyruan të kalojnë Osumin. Kushtet e vështira atmosferike, rruga e ndjekur duke kaluar në lartësi mbi 1500 metra të mbuluara me borë, apo edhe nëpër pyje të dendura, shkaktuan mjaft vështirësi. Pas informacioneve për situatën jo të mirë në Frashër, operacioni u pezullua dhe karvani me të plagosur iu drejtua Miçanit, për t'u kthyer më pas në Nikollarë e në Grabockë.²⁷

Gjatë së njëjtës kohë, edhe në zonën e Oparit zhvilloheshin luftime. Të plagosurit e kësaj zonë në datën 13 janar u gjendën në Potom. Një pjesë e të plagosurve u drejtua drejt të luginës së Osumit. Ata që kishin nevojë për ndërhyrje kirurgjikale, ose të sëmurët rëndë, iu drejtuan spitaleve të Nikollarës dhe Grabockës.²⁸

Krahina e Vakëfeve u sulmua drejtpërdrejt gjatë operacionit të Qershorit. U krijua një situatë e vështirë për partizanët e plagosur dhe për të sëmurët. Të plagosurit e spitalit të Grabockës u drejtuan për në Staraveckë të Skraparit. Më 4 e 5 qershor, të plagosurit, nga spitali i Tudasit dhe spitalet e Oparit, me vështirësi kaluan Qafën e Martës. Të plagosurit që erdhën nga spitali i Tudasit u drejtuan për në Staraveskë të Skraparit. Prej aty kolona u nis drejt Hotovës në Përmetit. Edhe të plagosurit e spitalit të Grabockës u drejtuan në drejtim të Përmetit.²⁹ Vapa e qershorit i mundonte, u shtonte etjen dhe u keqësonte plagët. Mbi 200 të plagosur rëndë u sistemuan në pyllin e Hotovës. Aty u krijua një fushim i vërtetë ushtarak me të gjitha rregullat. Mjeku iu përvesh punës për mjekimin e plagëve. Në pyllin e Hotovës të plagosurit qëndruan mbi 10 ditë, pastaj morën urdhër të niseshin për në Miçan dhe në Frashër. Në Miçan, të plagosurit u sistemuan nëpër shtëpitë e banorëve të zonës. Më vonë ata u lëvizën pjesë-pjesë për në destinacione të ndryshme.

3. Konfliktet mes dy grupimeve në krahinën e Vakëfeve si pjesë e luftës civile në Shqipëri

Gjatë Luftës së Dytë Botërore pati edhe luftë civile mes formacioneve ushtarake shqiptare të krijuara në këtë kohë. Në historiografinë komuniste të para viteve '90, nuk përmendet kjo terminologji, por flitet vetëm për luftën nacionalçlirimtare kundër armiqve të jashtëm dhe bashkëpunëtorëve të tyre të brendshëm. Termi luftë civile nuk shfaqet në tekstet e historisë.

²⁷ Lavdim Gjonça, "Mjekësia partizane", (Tiranë: 8 nëntori, 1979), 72

²⁸ Gjonça, "Mjekësia", 74

²⁹ *Po aty*, 93-94

Sot, një pjesë historianësh flasin për këtë fenomen. Disa autorë që janë më afër pikëpamjes komuniste flasin për elementë të luftës civile.³⁰ Autorë të tjerë mbrojnë pikëpamjen se në Shqipëri u zhvillua luftë civile midis grupeve ushtarake shqiptare.³¹ Në fakt ekzistojnë shumë përkufizime mbi luftën civile. Lufta civile përkufizohet si luftë ndërmjet grupeve kundërshtarë të qytetarëve të njëjtit vend, apo edhe në variantin: një luftë civile është një luftë midis grupeve të organizuara brenda të njëjtit shtet ose vend³². Ajo që u zhvillua në Shqipëri në asaj periudhe ishte e tillë.

Pas prishjes së Marrëveshjes së Mukjes dhe pas kapitullimit të Italisë, midis Frontit dhe Ballit Kombëtar nisën përplasjet e armatosura. Nga tetori i vitit 1943, Enver Hoxha dha urdhrin për asgjësimin e Ballit Kombëtar.³³ Kjo luftë e nisur në këtë kohë do të kishte pasojë afatgjatë për popullin shqiptar. Në mënyrë artificiale, shqiptarët po ndaheshin dhe po krijonin armiqësi me njëri-tjetrin vetëm se udhëheqësit e tyre nuk e gjetën gjuhën e përbashkët.

Krahina e Vakëfeve në këtë kohë kishte kaluar nën influencën e Frontit Nacionalçlirimtar, sepse disa nga familjet me emër, por dhe pjesa më e madhe e popullsisë ishin bërë pjesë e kësaj lëvizjeje. Shumë të rinj të krahinës ishin rreshtuar pranë formacioneve partizane. Ndërkohë, influenca e Ballit Kombëtar ishte e pakët, edhe pse në periudhën e Pavarësisë dhe të Luftës së Parë Botërore krahina ishte e lidhur me Sali Butkën dhe familjen e fuqishme Panariti. Familja Butka kishte miq të shumtë në krahinë. Safet Butka e vizitoi krahinën për të rikrijuar lidhjet e vjetra, por nuk gjeti përkrahje.*

Nga fundi i vitit 1943 dokumentet arkivore tregojnë se në terren kishin filluar përplasjet e armatosura midis dy formacioneve ushtarake. Pothuajse në të gjithë Qarkun e Korçës, duke filluar nga Kolonja, për të kaluar në fshatrat e Korçës, në drejtim të Maliqit, duke dalë në zonën e Padgories rrëzë Malit të Thatë e deri

³⁰ Beteja Jonë. Një bashkëbisedim me prof. dr. Paskal Milo <https://gazeta-shqip.com/>

³¹ Uran Butka, "Lufta civile në Shqipëri në vitet 1943-1945" në tre vëllime.

³² <https://ëëë.merriam-ëëbster.com/dictionary/civil%20ëëar>

³³ Bernd J. Fischer, "Shqipëria gjatë Luftës 1939-1944", (Tiranë: Çabej, 2004), 261

* Safet Butka vizitoi Grabockën në vitin 1943 dhe takoi miqtë e vjetër të babait. Mbledhja u zhvillua në shtëpinë e Qazim Panaritit një bashkëluftatarët më të afërt të Sali Butkës. Këtë herë ai nuk gjeti përkrahjen e tyre. Ata u përgjigjën se tashmë e kishin dhënë fjalën dhe ishin të lidhur me Frontin. Fjala e dhënë dhe tradita e shqiptarit nuk i lejonte të ndryshonin qëndrim edhe pse fjalët e profesorit ishin të ëmbla dhe të arta. Për disa orë u zhvilluan bisedime dhe profesori i njohur i paralajmëroi për rrezikun që i vinte vendit nga ideologjia komuniste, paralajmërim që fatkeqësisht rezultoi i vërtetë, por fjalët e tij nuk u kuptuan. Në të njëjtën situatë ai u gjend edhe në Panarit dhe u largua pa mundur që ti bindte.

në Devoll, dokumentet hedhin dritë mbi këto luftime të armatosura.³⁴ Në fund të nëntorit në Teqenë e Turhanit u sulmuan dhe u vranë tre figura kryesore të Ballit Kombëtar: Sabri Panariti*, Baba Zylfoja* dhe Refat Goskova.³⁵

Në kufijtë e Krahinës së Vakëfeve, në krahun e Kolonjës këto përplasje të armatosura ishin të shpeshta. Nga këto përplasje pati edhe të vranë. Ndërkohë, komunikatat e Frontit tashmë e kanë ashpëruar gjuhën, duke i etiketuar kundërshtarët si: *tradhëtarët, armiqtë* etj.³⁶ Në fundin e muajit nëntor, midis forcave të batalionit “Tomorri” dhe forcave të Ballit Kombëtar u zhvilluan luftime në disa fshatra të Kolonjës siç ishte ajo në Selenicë të Pishës, afër Krahinës së Vakëfeve. Sipas dokumenteve, në këto luftime, nga ana e Ballit Kombëtar u vranë disa banorë.³⁷ Operacioni gjerman i Dimrit i detyroi formacionet partizane të tërhiqeshin drejt zonave në thellësi të Krahinës së Vakëfeve, për të kaluar në Skrapar e Përmet.

Nga fundi i janarit ato u rikthyen. Në datën 20 këto forca ndodheshin në Vithkuq. Pas kësaj date batalionet partizane filluan sulmin kundër fshatrave kufitare me Kolonjën duke goditur forcat balliste. Goditja me e madhe u përqendrua në Lubonjë, natën e 31 janarit duke gdhirë 1 shkurti. Nga ky sulm u vranë 15 njerëz dhe 10 të tjerë u plagosën.³⁸ Sikur të mos mjaftonin të vranët, të nesërmen u pushkatuan edhe disa banorë të tjerë.* Këto sulme tregonin ashpërsinë e forcave partizane dhe paralajmëronin dhunën që do të instalohet në forcat e sigurisë së shtetit të ardhshëm shqiptar.

Një tjetër ngjarje e rëndë në këtë periudhë që lidhet me Krahinën e Vakëfeve është pushkatimi i 4 panaritasve në shkurt të vitit 1944. Këta njerëz³⁹ nuk ishin

³⁴ AMM, Dosja nr 8, Komunikata që tregojnë mbi luftimet në qarkun e Korçës komunikon, 16 nëntor 1943, fl 9

* Sabri Panariti ishte djali i patriotit të njohur Dajlan Panariti edhe vetë një figurë me kontribute të rëndësishme

* Baba Zylfoja kishte luajtur një rol të rëndësishëm gjatë periudhës së LIB. Ai ishte mikëpritësi i takimit që u mbajt më 29 tetor 1916 në teqenë e Melçanit midis dy udhëheqësve kryesore të çetave shqiptare Themistokli Gërmenji dhe Sali Butka.

³⁵ AMM, Viti 1943, Dosja nr 7, Komunikata që tregojnë mbi luftimet në qarkun e Korçës. Lajme të rëndësishme

³⁶ AMM, Viti 1943, Dosja nr 8, Komunikata që tregojnë mbi luftimet në qarkun e Korçës komunikon, 16 nëntor 1943,

³⁷ AMM, Viti 1943, Dosja nr 7, Komunikata që tregojnë mbi luftimet në qarkun e Korçës, Lajme të brendshme, fl 19-20

³⁸ Mile & Naci, “Lufta”, 454

* Nga ky sulm u vra File Baçka nacionalist i vjetër dhe drejtues i një prej çetave me të hershme të krijuara në Shqipëri. Vrasjes nuk i shpëtuan as 2 nga djemtë e tij të cilët u pushkatuan pa asnjë gjyq.

³⁹ Zenel Orhan Demko, Orhan Koçi Koleci, Sabri Tamaz Demko, Zenel Zotkë Koleci

të përfshirë në luftimet që u zhvilluan midis dy forcave kundërshtare në Lubonjë. Rastësia i gjeti aty atë ditë. U arrestuan dhe u pushkatuan pa gjyq, pa akuzë, madje u lanë edhe pa varr.* Një banor i zones, i quajtur Hamit Tarja, i varrosi duke mos lejuar përdhosjen e trupave të tyre.*

Episodi i fundit i luftës vëllavrasëse ndodhi në qershor të vitit 1944. Pas Operacionit të Qershorit forcat e Frontit u urdhëruan që të sulmonin fshatrat, banorët e të cilëve nuk pranonin të kalonin nën këshillat e Frontit. Batalioni “Tomorri” kishte urdhër të “*spastronte*” nga ballistët disa nga fshatrat e Kolonjës. Në këtë kohë luftimet mes dy formacioneve ishin më të ashpra sesa ato mes tyre e gjermanëve. Në Selenicë të Pishës u vranë 7 partizanë të cilët janë dëshmorë të atdheut ndërkohë që edhe nga ana e Ballit u vranë dy të tjerë.⁴⁰ Dy prej këtyre dëshmorëve ishin nga Krahina e Vakëfeve. Ua ndërpreu jetën lufta vëllavrasëse.

Përfundime

Nderimi ndaj atyre që kanë kontribuar për atdheun është detyrë jo vetëm e historianëve, por e të gjithëve. Sakrifica e atyre që luftuan dhe gjaku i dëshmorëve duhet përkujtuar e vlerësuar përjetë. Luftëtarët janë njerëz që kanë ideal të tyre dashurinë për atdheun. Kujtimi i veprës së tyre rrit dhe forcon krenarinë kombëtare për brezat e ardhshëm.

Traditat liridashëse të vakëfllinjve bënë që territori i tyre të shndërrohej në një zonë të lirë ku vepronin forcat partizane. E gjithë popullsia dha ndihmën e vet në luftën kundër pushtuesve, sipas mundësive. Një pjesë e rinisë u bë pjesë e formacioneve partizane, ndërsa familjet me ekonomi më të madhe i strehuan dhe ushqyen këto forca.

Shkrime të tilla shërbejnë jo vetëm për të kujtuar ato ngjarje, por edhe për të sjellë në dritë të vërtetën ashtu si ka ndodhur duke u dhënë meritën të gjithë atyre që kontribuan, meritë kjo shpeshherë e mohuar në vitet e errëta të komunizmit. Një tjetër rëndësi e punimit qëndron në hedhjen dritë mbi padrejtësisë e bëra gjatë luftës, pasojat e të cilave vazhduan gjatë kohës së komunizmit e ndoshta edhe sot.

Luftrat çlirimtare janë trashëgimi historike dhe shpirtërore e të gjithë

* Shtëpia e Zenel Orhan Demkos ishte vendqëndrimi i Shtabit të Ushtrisë Nacionalçlirimtare ku kishte bujtur edhe vet Enver Hoxha. Kjo nuk e ndihmoi as atë as familjen e tij. Kujtimi i biri tregon se edhe pse nuk e njohu të atin gjatë gjithë jetës u përball me përndjekejn dhe persekutimin komunist. Ai u rrit jetim e me vështirësi të mëdha si armik i Partisë. Gjatë 45 viteve të komunizmit nuk u bë asnjë përpjekje për të vënë në vend këtë padrejtësi.

* Eshtrat e tyre u zhvarrosën nga familjarët vetëm në vitin 1992.

⁴⁰ Mile & Naci, *Lufta*, 552

Aktet e Seminarit Shkencor organizuar në kuadër të 80-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë

popullit jo vetëm e një pjese të tij. Luftat çlirimtare janë ngjarje që bashkojnë njerëzit dhe popujt dhe jo ngjarje që i ndajnë ata. E tillë duhet të ishte edhe Lufta e Dytë Botërore.

Literaturë

Burime arkivore

Arkivi i Ministrisë së Mbrojtjes, (më tej AMM),
AMM Viti 1943, Dosja nr 1, Komanda e Qarkut Korçë,
AMM, Viti 1943 Dosja nr 8, Komunikata që tregojnë mbi luftimet në qarkun e Korçës
AMM, Viti 1943, Dosja nr 1, Historiku i formimit të batalionit “Qamil Panariti”.
AMM, Viti 1943, Dosja nr 3, Raport mbi luftimet e bëra nga Brigada I dhe e batalioneve të Qarkut të Korçës për mbrojtjen e Vithkuqit gjatë muajve maj-shtator 1943 nga sulmi i ushtrisë italiane,
Arkivit Qëndror Shtetëror (më tej AQSH)
AQSH Fondi 42 (më tej F), APL 52, Komandës së Qarkut,
AQSH, ish AQP F 42, APL 52, Shtabit të Qarkut të Korçës
AQSH, ish AQP F 42, ALP 90, Shtabit të Qarkut të Korçës.
AQSH, ish AQP, F 42, APL 52, Zona e lirë 9/VII, 44. Shtabit të Qarkut të Korçës.
AQSH, ish AQP, F 42, APL 9, Komandës Shtabit të Qarkut

Bibliografi

Bernd J. Fischer, “*Shqipëria gjatë Luftës 1939-1944*”, Tiranë: Çabej, 2004.
Gaqo Kollumbi, “*Ditar partizan (shtator 1943-tetor 1944)*”, Tiranë: Naim Frashëri, 1967.
Kosta Papa Tomorri, “*Barbaritë greke në Shqipëri. Kujtime Historike 1913-1914*”, Tiranë: Naimi, 2012.
Ministria e Mbrojtjes, “*Dëshmorët e Atdheut deri në periudhën 7 prill 1939*”, Tiranë: 2012.
Lavdim Gjonça, *Mjekësia partizane* Tiranë: 8 nëntori, 1979.
Ligor K. Mile, Stavri Naçi, “*Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare në qarkun e Korçës 1939-1944*”, Tiranë: Akademia e Shkencave e RPS të Shqipërisë, 1986.
Muharrem Dezhgiu, *Shqipëria nën pushtimin italian (1939-1943)*, Tiranë: Eneas, 2015.
Muharrem S. Butka, “*Rruga e vështirë e lirisë*”, (Tiranë: Maluka 2022),
Petraq Katro, “*Kush ishte Sali Butka: kronikë historike*”
Petrit Zeneli, “*Gjurmime në krahinën e vakëfeve Korçë*”, Tiranë: Mirgeeralb, 2010.
Petrit Zeneli, “*Masakra e Panariti*”, Tiranë: DDS, 2014.
Sejdim Ramo “*Ilia Panariti dhe Korca*”, Korçë: Kotti, 2003.

Aktet e Seminarit Shkencor organizuar në kuadër të 80-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë

Uran Butka, *“Lufta civile në Shqipëri në vitet 1943-1945”* në tre vëllime.

Sitografi

<https://www.merriam-webster.com/dictionary/civil%20war>

Beteja Jonë. Një bashkëbisedim me prof. dr. Paskal Milo <https://gazeta-shqip.com/>

**KUJTESA KOLEKTIVE HISTORIKE
NË 80-VJETORIN E ÇLIRIMIT TË VENDIT:
RAST STUDIMI RAJONI I KORÇËS**

Prof. as. dr. Alba KREKA

*Departamenti i Historisë dhe i Gjeografisë
Universiteti “Fan S. Noli”*

Abstrakt

Lufta Antifashiste Nacional Çlirimtare është një ndër periudhat më të rëndësishme të historisë shqiptare, sepse përfaqëson një moment të rëndësishëm që kërkon ripërtëritjen e kujtesës historike te brezat e rinj. Përmes këtij punimi synohet të eksplorohej kujtesa kolektive historike në rajonin e Korçës, duke u fokusuar te perceptimet e të rinjve mbi Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare (më tej LANÇ). Në kuadër të 80-vjetorit të Çlirimit të Shqipërisë, artikulli paraqet të dhëna mbi rolin e kujtesës kolektive në formësimin e qëndrimeve të të rinjve lidhur me veprimtarinë e LANÇ-it në qytetin dhe rajonin e Korçës.

Metodologjia e përdorur i referohet një analize përshkruese të një anketimi të kryer me të rinj të rajonit të Korçës, realizuar përmes një pyetësori të strukturuar me pyetje të hapura dhe të mbyllura. Pyetësori vlerëson njohuritë historike bazike, burimet e informacionit dhe perceptimet mbi ngjarjet dhe personalitetet që lidhen me LANÇ-in në këtë rajon. Gjetjet tregojnë një lidhje komplekse ndërmjet njohurive të përfituara nga burimet tradicionale dhe ato moderne, si dhe një interes të vazhdueshëm për të njohur dhe ruajtur trashëgiminë historike.

Ky studim thekson rëndësinë e përfshirjes së kujtesës historike kolektive në edukimin e brezave të rinj, për të siguruar që ngjarje të tilla me peshë kombëtare të mos harrohen dhe të vijojnë të shërbejnë si burim reflektimi mbi identitetin dhe historinë kombëtare.

Fjalët kyçe: *histori kombëtare, identitet kombëtar, kujtesë kolektive, LANÇ-i, rajon, të rinjtë*

Qëllimi i studimit

Ky studim synon të hedhë dritë mbi nivelin e ndërgjegjësimit të të rinjve korçarë lidhur me rëndësinë e ruajtjes së memories historike mbi ngjarjet e rëndësishme të Luftës së Dytë Botërore, me fokus të veçantë në veprimtarinë e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare (më tej LANÇ). Në kuadër të 80-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë, synimi është të kuptohet sa dhe si të rinjtë vlerësojnë dhe përvetësojnë rëndësinë e kësaj periudhe historike, (Wineburg 2001) duke u thelluar në perceptimet dhe qëndrimet e tyre për ngjarjet e asaj kohe. Për rrjedhojë kemi ngritur një pyetje kërkimore të lidhur drejtpërdrejt me *Perceptimet e të rinjve në këtë 80- vjetor të Çlirimit mbi veprimtarinë e LANÇ-it në Korçë, gjatë Luftës së Dytë Botërore.*

LANÇ-i përfaqëson një moment të rëndësishëm për historinë tonë kombëtare, që kërkon ripërtëritjen e vazhdueshme të kujtesës kolektive, veçanërisht te brezat e rinj, për të ndihmuar në ruajtjen e identitetit kombëtar dhe promovimin e reflektimit mbi të kaluarën. Në këtë drejtim, përmes një analize të perceptimeve të të rinjve, (Stephanie 2017) studimi kontribuon në debatin mbi rishikimin dhe rishkrimin e historisë, duke eksploruar burimet nga të cilat formohen njohuritë e tyre dhe rëndësinë e përfshirjes së memories kolektive në edukimin dhe ndërgjegjësimin historik. Kjo punë kërkimore ka nisur si interes i shtuar për të kuptuar më thellë lidhjet midis ngjarjeve historike lokale dhe perceptimeve të brezave të sotëm mbi veprimtarinë e LANÇ-it në rajonin e Korçës, një qytet me rëndësi historike gjatë kësaj periudhe.

Metodologjia e Punimit

Metodologjia e përdorur në këtë studim ka si qëllim mbledhjen e të dhënave të detajuara mbi perceptimet dhe qëndrimet e të rinjve korçarë për LANÇ-in në rajonin e Korçës, duke përdorur një qasje kryesisht sasiore dhe përshtetëse. (Creswell 2014) Për mbledhjen e të dhënave është përdorur një pyetësor i strukturuar, i cili përbëhet nga një kombinim pyetjesh të mbyllura (me alternativa) dhe pyetjesh të hapura. Kjo qasje lejon mbledhjen e informacionit të standardizuar për analiza sasiore dhe njëkohësisht ofron mundësi për shprehje të lirë të mendimeve dhe qëndrimeve të të anketuarve. (Bryman 2016) Pyetësori përfshin tre seksione kryesore:

Aktet e Seminarit Shkencor organizuar në kuadër të 80-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë

- Njohuritë bazike historike – Pyesim të rinjtë mbi ngjarjet kryesore të Luftës së Dytë Botërore dhe veçanërisht mbi veprimtarinë e LANÇ-it në rajonin e Korçës;
- Burimet e informacionit – Identifikojmë mënyrat përmes të cilave të rinjtë kanë marrë informacionin historic;
- Perceptimet dhe qëndrimet – Analizojmë opinionet e të rinjve mbi rëndësinë e LANÇ-it dhe ndikimin e saj në formimin e identitetit historik kombëtar.

Pyetësi është shpërndarë përmes platformave online për të arritur një kampion të gjerë dhe të larmishëm të të rinjve nga rajoni i Korçës. Në total, pyetësi është plotësuar nga 105 të rinj, të cilët përfaqësojnë grupmosha të ndryshme, brenda rajonit të Korçës.

Analiza e të dhënave

Përgjigjet nga pyetësi i janë nënshtruar analizës përshkruese në mënyrë që të identifikohen nivelet e njohurive dhe qëndrimeve të të rinjve referuar kujtesës kolektive mbi LANÇ-in në Korcë dhe ngjarjeve më të njohura lidhur me këtë periudhë. Për të bërë interpretimin e të dhënave jemi fokusuar te niveli i njohurive të pjesëmarrësve në studim në raport me burimet e informacionit (libra, mësimet shkollore, familja, media, historia orale etj.), ndikimin e kujtesës kolektive në formimin e identitetit lokal dhe kombëtar të tyre, si dhe identifikimin e nevojës, ose jo, për të kujtuar, festuar dhe monumentalizuar ngjarje të tilla, parë nga këndvështrimet dhe perceptimet e të rinjve sot. Kjo metodologji siguron një qasje të balancuar që kombinon aspekte sasiore dhe cilësore për të kuptuar më mirë kujtesën kolektive dhe perceptimet e brezit të ri mbi këtë periudhë historike të rëndësishme. Në analizën që i është bërë të dhënave demografike rezulton se pjesa më e madhe e të anketuarve (60%) janë në grupmoshën 19–25 vjeç, duke treguar një përqendrim të lartë të të rinjve; 26% janë në grupmoshën 15–18 vjeç, që sugjeron një përfaqësim të konsiderueshëm të adoleshentëve dhe vetëm 11% e të anketuarve janë mbi moshën 26 vjeç. (Figura 1) Referuar nivelit arsimor të të anketuarve, 76% e tyre kanë arsim të lartë dhe vetëm 20% e tyre kanë arsim të mesëm. (Figura 2) Një rezultat i tillë pasqyron një grup të mirarsimuar, që mund të kontribuojë me

perceptime më të informuara rreth temës së studimit.

Figurë 1.

Niveli arsimor:



Figurë 2

Përsa i përket shpërndarjes demografike të pjesëmarrësve, vendbanimi më i përmendur, me një përqendrim të konsiderueshëm është Korça, por të dhënat tregojnë një përfaqësim shtesë rural të zonës përreth si në tabelën 1:





Table 1

Korçë	72
Pogradec	13
Devoll	4
Maliq	3
Drenove	2
Bregas	3
Podgorie	2
Mborje	4

Një aspekt i rëndësishëm i mbledhjes së të dhënave është edhe niveli i njohurive bazike të të anketuarve në lidhje me ngjarje historike të periudhës së marrë në studim. Bazuar në figurën nr. 3, i cili mat njohuritë e të anketuarve mbi veprimtarinë e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare në Korçë (në një shkallë nga 1-5), rezulton se niveli mesatar i informimit mbi këtë çështje është 3.26. Shumica e përgjigjeve janë në nivelin 3 (39 të anketuar), që sugjeron një njohuri të moderuar mbi temën, një numër i konsiderueshëm janë në nivelin 4- 5 (42 të anketuar), duke treguar një grup të mirinformuar dhe 22 të anketuar kanë raportuar njohuri të ulëta ose mungesë të saj.

12. Nga 1-5, sa e njohur është për ju veprimtaria e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare në Korçë?

[More details](#)




Figurë 3

Të pyetur në lidhje me burimet kryesore të informacionit për aktivitetin e LANÇ-it në Korçë, (Figura 4) të anketuarit referojnë se shkolla është burimi më i zakonshëm i informacionit, duke i dhënë vend parësor edukimit formal. Librat

Aktet e Seminarit Shkencor organizuar në kuadër të 80-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë

historikë dhe Interneti janë burimet e tjera të informacionit, çka tregon se jashtë shkollës, njerëzit mbështeten shumë në përmbajtjen e shkruar ose digjitale për informacion historik. Një përqindje e vogël e pjesëmarrësve mendojnë se disa njohuri transmetohen brez pas brezi nëpërmjet rrëfimeve ose diskutimeve familjare. Në vlera të barabarta renditen mediat dhe monumentet historike, të cilat priren të fokusohen më pak në edukimin historik, sesa në rrugët e tjera. Jo vetëm të renditura në fund të listës, por edhe të fundit në përzgjedhje paraqiten burimet e historisë gojore, si një tregues i përdorimit të kufizuar të tregimeve personale rreth të mësuarit për ngjarje të caktuara historike. Si përfundim, mund të themi se të dhënat sugjerojnë një preferencë të fortë për burimet formale dhe të shkruara arsimore ndaj të mësuarit informal ose të bazuar në familje për njohuritë historike, si dhe mbi rëndësinë e burimeve digjitale në informimin e publikut për ngjarjet historike si Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare në Korçë.

13. Nga cilat burime keni mësuar për aktivitetin e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare në Korçë: (Mund të zgjidhni më ... [More details](#))



Figurë 4


Figura e mëposhtme ilustron të dhënat e marra nga kampioni lidhur me ngjarjet kryesore historike të ndodhura në rajon gjatë periudhës së marrë në studim. Specifikisht, Çlirimi i Korçës renditet prej 42% të kampionit si një nga ngjarjet më të rëndësishme që lidhet me aktivitetin e LANÇ-it, pasuar nga 21% e tyre që zgjedhin rezistenca antifashiste ndaj forcave italiane dhe gjermane, si dhe Masakrat e luftës, e cila përzgjidhet prej 18% e kampionit.

Aktet e Seminarit Shkencor organizuar në kuadër të 80-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë

14. Cilat nga ngjarjet kryesore ju sjell ndërmend veprimtarinë e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare ne Korçë: (Mund të ...

[More details](#)

● Rezistenca ndaj forcave fashiste italiane dhe gjermane	31
● Çlirimi i Korçës (24 tetor 1944)	63
● Masakrat e luftës	27
● Përfshirja e patriotëve korçarë në Luftën Italo - Greke	16
● Tjetër	14





Figurë 5

Të pyetur nëse LANÇ-i ka ndikuar në formimin e identitetit historik të rajonit të Korçës, pjesëmarrësit në këtë pyetësor përgjigjen me një vlerësim mesatar prej 3.69 si në figurën nr.6. Numri më i lartë i përgjigjeve është në Nivelin 3, me 37 përgjigje, i ndjekur nga Niveli 5 me 29 përgjigje, çka tregon një besim mesatarisht të lartë lidhur me këtë çështje.

16. Nga 1-5, sa besoni se Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare ka formuar identitetin historik te rajonit te Korces?

[More details](#)



Figurë 6


Të dhënat sugjerojnë se shumica e të anketuarve e pranojnë rolin e LANÇ-it në formësimin e identitetit historik të Korçës.

Pyetja e radhës i referohet ruajtjes së memories kolektive mbi LANÇ-in si në figurën nr. 7.

Aktet e Seminarit Shkencor organizuar në kuadër të 80-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë

23. Nga 1 - 5, sa është ruajtur memoria kolektive historike mbi Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare në Korçë:

[More details](#)




Figurë 7

Nga një shkallë prej 1-5, të anketuarit mendojnë se kujtesa historike kolektive mbi LANÇ-in në Korçë është ruajtur mesatarisht në vlerën 3.21. Përafërsisht 27% e të rinjve kanë zgjedhur nivelin poshtë vlerës 3, çka mund të përputhet edhe me të dhënat mbi moshën, ku 60% e të anketuarve janë të gjeneratës 19-25. Nëse do t'i referohemi Halbwach dhe përkufizimit të tij mbi kujtesën kolektive “Çdo grup ka kujtesën e vet kolektive dhe kjo kujtesë kolektive ndryshon nga grupi në grup”, (Halbwachs 1992) atëherë ne do ta kemi më të lehtë të kuptojmë qasjen e grupmoshës së marrë në këtë studim me ngjarjet historike të Luftës së Dytë Botërore.

Tre pyetjet e radhës kanë të bëjnë me nivelin e njohurive që pjesëmarrësit prezantojnë në raport me vendet historike që përkujtojnë veprimtarinë e LANÇ-it. Përafërsisht 41% e pjesëmarrësve mendojnë se i njohin vendet historike që lidhen me veprimtarinë e saj nën nivelin mesatar (2;1), 32% e tyre i njohin në nivelin mesatar (3) dhe përafërsisht 26% kanë një nivel njohurie mbi mesataren (4;5). (Figura nr. 8)

24. Nga 1-5, sa i njihni ju vendet historike që ju sjellin ndërmend veprimtarinë e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare n...

[More details](#)



Figurë 8

Aktet e Seminarit Shkencor organizuar në kuadër të 80-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë

Të pyetur nëse kanë vizituar vende historike që lidhen me këtë periudhë, rreth 54% e tyre përgjigjen JO, 20% përgjigjen PO dhe 25% nuk e mbajnë mend. Këto të dhëna konfliktohen me përgjigjet e pyetjes pasardhëse, ku vetëm 14% (nga 20%) identifikojnë disa nga vendet historike të vizituara. (Figura nr. 9)



Figurë 9

Table 2

Varrezat e dëshmorëve
Monumenti i Themistokli Gërmenjit
Muzeu i Korçës
Lapidarë të ngritur si përkujtimore për rënien e dëshmorëve të Luftës Nacionalçlirimtare
Ushtari i panjohur
Abc
Kolonjë / Rehovë
Drenovë

Një aspekt tjetër i rëndësishëm i pyetësorit është edhe matja e qëndrimeve të të anketuarve në raport me rëndësinë e përkujtimit të ngjarjeve historike. Në këtë 80-vjetor të Çlirimit, për ne ishte e rëndësishme të matnim rëndësinë që të rinjtë i japin festimit të kësaj ngjarjeje në nivel lokal, por njëkohësisht edhe në nivel kombëtar. 62% e tyre mendojnë se festimi i 80-vjetorit të Çlirimit konsiderohet shumë i rëndësishëm, duke përfaqësuar një mesatare prej 4.38, si në figurën nr. 10.

Aktet e Seminarit Shkencor organizuar në kuadër të 80-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë

15. Nga 1-5, sa mendoni se është e rëndësishme të festohet 80-vjetori i Çlirimit të Korçës?

[More details](#)



Figurë 10

Pyetja përmbyllëse e këtij pyetëtori lidhet me rekomandimin nga ana e të rinjve për të bërë pjesë të Guidave Turistike vendet historike që lidhen me veprimtarinë e LANÇ-it në Korçë. Përafërsisht 83% e kampionit (niveli 3,4,5) e rekomandojnë përfshirjen e vendeve historike në Guidat Turistike mbi nivelin e mesatares (3.59). Një rezultat i tillë (figura nr. 11) tregon se pjesa më e madhe e të anketuarve mendon se përfshirja e këtyre vendeve në guidat turistike të Korçës është e rëndësishme, por jo domosdoshmërisht thelbësore për ta.

27. Nga 1-5, sa do t'a rekomandonit përfshirjen e vendeve historike që lidhen me veprimtarinë e Luftës Antifashiste Nacio...

[More details](#)



Figure 11

Përfundime

Ky studim ka nxjerrë në pah disa gjetje thelbësore që pasqyrojnë marrëdhënien e të rinjve me historinë e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare dhe kujtesën kolektive. Rezultatet ofrojnë një pasqyrë të gjendjes aktuale të njohurive dhe perceptimeve të tyre, duke evidentuar sfida dhe mundësi për ndërhyrje të mëtejshme.

Së pari, niveli i njohurive dhe interesimi për historinë e LANÇ-it u vlerësua si i

moderuar, por me një nevojë të qartë për përmirësim. Ky rezultat thekson rëndësinë e ndërhyrjeve edukative për rritjen e ndërgjegjësimit mbi këtë periudhë historike. Ndërhyrjet duhet të fokusohen, jo vetëm në përfshirjen e temave përkatëse në kurrikulat shkollore, por edhe në përdorimin e teknologjisë për të bërë historinë më tërheqëse dhe më të arritshme për të rinjtë. Platformat digjitale, mësimet interaktive dhe aplikacionet multimediale mund të luajnë një rol kyç në ndërtimin e një qasjeje më moderne ndaj historisë. (Domi 2018)

Së dyti, historia gojore rezultoi të ketë një ndikim të kufizuar në kujtesën kolektive të të rinjve. Kjo gjetje sugjeron nevojën për të promovuar historinë gojore jo vetëm si një burim informacioni, por si një mënyrë për ndërtimin e identitetit kolektiv, ruajtjen e trashëgimisë dhe forcimin e lidhjes midis brezave. Siç argumenton Nora, historia gojore përfaqëson një komponent thelbësor të memories kolektive (Nora 1989) dhe mund të luajë një rol vendimtar në ruajtjen e traditave dhe vlerave lokale. Për këtë arsye, është e nevojshme të integrohet historia gojore në proceset edukative dhe projekte kulturore, përmes intervistave, rrëfimeve dhe dokumentimit multimedial.

Së treti, vendet e kujtesës historike rezultuan të jenë pak të vizituara nga të rinjtë dhe shpeshherë të panjohura për ta. Kjo mungesë e përfshirjes në hapësirat e kujtesës ndikon në ruajtjen e memories kolektive dhe në perceptimin e rëndësisë së LANÇ-it për identitetin kombëtar dhe lokal. Për të adresuar këtë problem, rekomandohet që vendet e kujtesës të promovohen më gjerësisht përmes fushatave ndërgjegjësuëse dhe përfshirjes së tyre në guidat turistike. Aktivitetet edukative dhe kulturore, si ekskursionet shkollore dhe projekte artistike, mund të ndihmojnë në krijimin e një lidhjeje më të fortë midis të rinjve dhe këtyre vendeve.

Së fundi, ceremonitë festive u evidentuan si një komponent i rëndësishëm i memories historike, duke ndihmuar në forcimin e lidhjes emocionale të të rinjve me periudha dhe ngjarje të caktuara historike. Përfshirja aktive e të rinjve në këto aktivitete përmes roleve kreative dhe organizative mund të thellojë angazhimin e tyre. (Claus and Marriott 2017) Gjithashtu, përfshirja e vendeve historike në itineraret turistike lokale dhe kombëtare do të kontribuonte në promovimin e identitetit historik dhe kulturor të rajonit.

Në përmbyllje, këto rezultate nënvizojnë nevojën për një qasje të integruar që bashkon edukimin formal dhe informal, teknologjinë dhe aktivitetet komunitare

për të forcuar lidhjen e të rinjve me historinë dhe kujtesën kolektive. Përmes këtyre masave, historia e LANÇ-it mund të bëhet një burim më i rëndësishëm frymëzimi dhe identiteti për brezat e ardhshëm.

Referenca

- Bryman, Alan. 2016. *Social Research Methods, 5th ed.* Oxford: Oxford University Press. <https://ktpu.kpi.ua/wp-content/uploads/2014/02/social-research-methods-alan-bryman.pdf>.
- Claus, P, and J Marriott. 2017. *History: An introduction to theory, method and practice, second edition.* New York, NY 10017: Routledge. https://www.researchgate.net/publication/318944178_History_An_introduction_to_theory_method_and_practice_second_edition?enrichId=rgreq-ee3b995568f7deefe76668e31ee51a00-XXX&enrichSource=Y292ZXJQYWdlOzMxODk0NDE3ODtBUzoxMDI3MzEzMDZlMzE2QDE2MjE5NDE5MTc2NT.
- Creswell, John W. 2014. *Research Design: Qualitative, Quantitative, and Mixed Methods Approaches.* Thousand Oaks, CA: SAGE Publications. https://spada.uns.ac.id/pluginfile.php/510378/mod_resource/content/1/creswell.pdf.
- Domi, Etleva. 2018. "Albanian Cultural Heritage in Digital Area." *Sociology and Anthropology* 6, no. 2 203-212. doi: <https://doi.org/10.13189/sa.2018.060202>.
- Halbwachs, Maurice. 1992. *On Collective Memory*,. Chicago: University of Chicago Press. <http://ereserve.library.utah.edu/Annual/COMM/5620/Choi/comm5620halbwachs.pdf>.
- Nora, Pierre. 1989. "Between Memory and History: Les Lieux de Mémoire." *Representations*, no. 26 7-24. doi:<https://doi.org/10.2307/2928520>. .
- Stephanie, Doi M. 2017. *Collective Memory and History: An Examination of Perceptions of Accuracy and Preference for Biased "History" Passages.* California, April 24. https://scholarship.claremont.edu/cgi/viewcontent.cgi?article=2695&context=cmc_theses.

Wineburg, S. 2001. *Historical Thinking and Other Unnatural Acts: Charting the Future of Teaching the Past (Critical Perspectives on The Past)*. Philadelphia: Temple University Press.
<https://www.scirp.org/reference/referencespapers?referenceid=1660080>.

ANAMNEZA E DREJTUESIT POLITIK TË PKSH GJATË LUFTËS SË DYTË BOTËRORE

Nuredin NAZARKO

Abstrakt

Historia është një shkencë që, pa të, qenia njerëzore dhe shoqëria nuk do të kishin mundësinë të njihnin të kaluarën, të mësonin nga ajo dhe të bënin korrigjime kur lind nevoja. Çdo brez ka sfidat e veta, të cilat duhen gjykuar në bazë të parimeve dhe virtyteve, për të gjetur zgjidhjet më të mira për shqetësimet dhe problemet që janë krejt të natyrshme për individin dhe shoqërinë.

E kaluara shërben si lëndë e papërpunuar për një varg shqyrtimeve dhe analizash, që jo vetëm zbardh ngjarje, situata, dhe karaktere, por edhe na drejton drejt sintezash që ishin të pamundura për Shqipërinë gjatë regjimit komunist.

Historia nuk duhet të instrumentalizohet për interesat e një regjimi politik. Ajo nuk duhet të shtrembërohet dhe të përdoret për të manipuluar ndërgjegjen historike të një kombi. Historia nuk duhet të lexohet dhe interpretohet nga një këndvështrim i vetëm, akoma më keq kur ky këndvështrim është politik dhe ideologjik. Po të ndodhë kjo, atëherë do të vazhdojmë të elaburojmë një histori të mitizuar dhe jo një histori që është bazuar në fakte, analiza dhe sinteza. A na shërben një histori e mitizuar apo një histori objektive për të ardhmen? Kjo është pyetja që duhet të udhëheqë punën e historianëve, për të mos lënë faktet historikë në dorën e politikës së ditës dhe politikës së interesave të ngushta.

Fjalë kyçe: *Filozofi e historisë, instrumentalizim, Miladin Popović, Enver Hoxha, karakter, logjikë marksiste – leniniste, PKSH, Komiteti Qendror, Sekretar politik.*

Hyrje

Historia është një fushë studimi që pa u ngërthyer me filozofinë, psikologjinë, dhe sociologjinë, do të mbetet në nivelin përshkrues, në mbledhjen, radhitjen dhe parashkrimin e fakteve. Ky proces ka vlerën e vet, por në qoftë se do të ndaleshim këtu, historia do të kthehej në një lëndë të mërzitshme e të lodhshme për lexuesin. Historia nuk duhet të jetë vetëm përshkruese. Duhet thyer koncepti që historinë ta mësojmë vetëm kronologjikisht. Disiplinat e tjera të sjella në tryezën e lëndës së historisë do të ndërtonin një mozaik më të bukur, më interesant dhe grishës, veçanërisht për hulumtuesit e rinj. Historia nuk duhet lënë

vetëm në dorën e historisë.

Pjesa më e bukur e historisë është ana e pakapshme nga shqisat, e lexueshme vetëm nga intuita. Përsiatja mbi faktet, analiza me objektivitet dhe paanësi që mbetet e vështirë për t'u arritur, por jo e pamundur, dhe sinteza për të sjellë në vëmendje mësimet e mesazhe që vijnë prej së kaluarës, duhet të jetë në fokusin e punës së historianit. Filozofia e historisë duhet duhet të jetë bashkëudhëtare e pandarë e punës së tij. Nuk duhet të ketë vetëm histori të filozofisë, por edhe filozofi të historisë. Përsiatja dhe produkti i saj si sintezë e asaj që historiani ka përshkruar është proces që shmang riprodhimin e thatë të fakteve historikë, i jep gjallëri mendimit kritik, thellon nivelin e arsytimit dhe grish lexuesin për të zbuluar më shumë nga pjesa që endet padukshëm mes rreshtave. E bën historianin apo të pasionuarit pas historisë të jenë në kërkim të vazhdueshëm të asaj ane që nuk shquhet vetëm se me intuitë. A mund të gabojë intuita? Edhe mundet se tek e fundit është njerëzore të gabosh. Më mirë një gabim i kryer në përpjekje për të arritur tek e vërteta historike, sesa një vetëmjaftueshmëri që të mban mbërthyer si ujë i palëvizur në leximin dhe interpretimin e saj.

Koha fizike e ndarë në e shkuar, e tashme dhe e ardhme, mes lindjes dhe vdekjes së çdo gjëje që lind, është hapësira ku çdo qenie përpiqet të zbulojë e të realizojë vetveten, të vendosë qëllime dhe të punojë për t'i arritur. Është hapësira ku e ardhmja e panjohur as nuk mund të parashikohet e as nuk mund të kontrollohet, e shkuara mbetet ashtu siç ndodh dhe nuk mund të zhbëhet dhe mbetet e tashmja e cila në çdo çast merr nga e ardhmja dhe dërgon në të shkuarën. E tashmja është çasti që përdor njeriu për të ndërtuar vizionin, ëndrrat mbi të ardhmen, përsiatjen mbi të shkuarën. Pa këtë simbiozë jeta e njeriut do të ishte tejet e cunguar dhe pa nerv. Në rrjedhën e kohës shpërfaqen të gjitha fytyrat, pasi deti i jetës është sa i qetë aq edhe i sertë për t'i dhënë secilit mundësinë të bëhet ashtu siç duket, apo të duket ashtu siç dëshiron të bëhet. Zbulimi i vetvetes dhe ndërtimi i saj lidhet ngushtë edhe me kohën fizike në të cilën lind dhe rritet njeriu, rrethanat jetësore që i japin ngjyrë jetës, qëllimet që i vendos vetes dhe njerëzit që i ke në krah të realizimit të qëllimit apo kundërshtarë të rrugëtimit tënd si njeri. Njeriu është amalgamë e gjithë sa thamë dhe lënda bazë e kësaj amalgame është ADN me të cilën vjen në jetë dhe ajo çfarë ai ushqen më shumë tek vetvetja.

E kaluara si pikënisje

Për shumë syresh e kaluara është një kapitull i mbyllur që nuk duhet trazuar në

heshtjen e saj. Duhet lënë në hije a në mes të pluhurit të kohës e pashqetësuar. Ndërsa për të tjerë syresh nuk mund të jetë kësisoj. Kumti i saj është i vazhdueshëm. Mesazhet e saj ende të padeshifruara presin hulumtuesit e pasionuar që të zbresin shkallët e kohës për të nxjerrë prej andej atë çfarë njeriu dhe shoqëria kanë nevojë në të tashmen. Sado kohë të kalojë, ngjarjet e së shkuarës së afërt apo të largët nuk duhet të hyjnë në fondin e indiferencës. Indiferenca na çon në shpërfillje e harresë dhe populli që shpërfill e harron të kaluarën është i paracaktuar ta ripërsëritë atë. Kjo është ligjësi natyrore universale. Kush nuk nxjerr mësim nga e kaluara bie në të njëjtin qerthull, përsërit të njëjtat gabime dhe nuk korrigjon dot të shkuarën në të tanishmen për të projektuar të ardhmen mbi bazamentin e reflektimit historik.

E kaluara duhet të shërbejë jo si harresë, por pikënisje për reflektime të reja, interpretime të reja dhe çelje të udhëve për të shkundur pluhurin e njëtrajtshmërisë së të shkruarit dhe interpretimit të historisë. Është një vuajtje që Shqipëria e ka përjetuar dhe është në rrugën e përpjekjeve për të sendërtuar një qasje ndryshe mbi historinë, mbi mënyrën e të shkruarit dhe të interpretuarit të historisë së saj. Është nevojë ontologjike dhe aspak revanshiste.

Shoqëria njerëzore ndryshon dhe bashkë me ndryshimin lind nevoja e përgjigjes ndaj sfidave të së tashmes. Por kjo e tashme nuk mbiu krejt rrufeshëm si kërpudha pas shiut. Nuk u ndërtua sakaq në një djerrinë. Dhe as nuk mund të lihet jashtë vëmendjes, aq më tepër kur ajo është kaq afër dhe kaq ndikuese në të tashmen. Të kapërcesh sfidat e së tashmes, të zgjidhësh probleme që nuk presin, të marrësh vendime të pjekura dhe vizionare duhet me patjetër të jesh lexues dhe kritik i mirë i së shkuarës, si në rrafshin individual ashtu edhe atë shoqëror. Nuk duhet të shohim me skepticizëm interpretimet e reja historike, bazuar në fakte të panjohura deri dje apo të interpretuara apolitikisht. Duhet të jemi optimistë dhe t'i vlerësojmë mundësitë e krijuara për qasje të reja në shkrimin dhe interpretimin e historisë, në të kundërt do të vazhdojmë të ripërsëritim të njëjtat teza, të ruajmë të njëjtën mendësi dhe të mos shohim e gjykojmë drejt anët pozitive të ndryshimeve bashkëkohore në shkrimin dhe interpretimin e historisë.

Instrumentalizimi i së shkuarës

Historia është një nga disiplinat me të cilën regjimet politike nuk i kanë punët mirë. Më keq me filozofinë e historisë. Pse regjimet politike përpiqen të manipulojnë historinë? Pse duan të shkruajnë një histori ku lavdërohet një palë dhe kritikohen palët e tjera? Pse shoqëria duhet të mësojë një histori të krasitur dhe gdhendur sipas interesave të regjimit politik? Përgjigjja nuk mund të jetë thjesht dhe vetëm, historinë e shkruajnë fitimtarët, dhe me këtë të lajmë duart si Ponc Pilati. Regjimet politike përpiqen të manipulojnë historinë, sepse i druhen së vërtetës.

Rrjedha e kohës e bën njeriun të jetë më racional në raport me të shkuarën. I rritur dhe me përvojë, i rrahur nga jeta, i gdhendur nga vështirësitë, shumë nga vendimet e së shkuarës nuk do të donte t'i kishte marrë kurrë, shumë nga veprat e së shkuarës nuk do të donte t'i kishte kryer. Por e kaluara nuk zhbëhet. Përballë moszhbërjes njeriu ka dy rrugë: ose të pranojë gabimet e së shkuarës dhe të korrigjojë vetveten, ose të fshehë gabimet e së shkuarës duke iu ikur si djalli temjanit dhe të ndërtojë një realitet ndryshe në sytë dhe mendjet e atyre që nuk i njohin faktet historike ashtu siç kanë ndodhur në të vërtetë.

Për të ndërtuar një histori që njeh vetëm suksese e asnjëherë dështime, shumë fakte duhet të lihen në harresë, të tjerë duhet të paraqiten pjesërisht duke hequr pjesët që bien ndesh me atë çfarë synohet të shkruhet e të prezantohet në shoqëri. Faktet më problematikë për të vërtetën duhet të marrin statusin “top secret” dhe të mos kenë qasje as studiuesit, jo më lexuesi.

Në regjimet totalitare kontrolli mbi historinë dhe jo vetëm, i shërben plotësisht instrumentalizimit të së shkuarës në funksion të propagandës për madhështinë e regjimit dhe gjenialitetin e udhëheqësit. Për këtë kryhet një punë e kujdesshme në përzgjedhjen e fakteve historikë, radhitjen dhe shkrimin e tyre, ndalimin e të gjitha botimeve me sens kritik, dënimin e atyre që mund të flasin e të nxjerin në pah të metat dhe dobësitë e udhëheqësit, prej rrethit të afërt apo prej kundërshtarëve. Kësisoj historia bëhet disiplina më e sakatuar dhe nga një dritare prej nga ku mund të përsiatnim për të kaluarën lirshëm, kthehet në një shërbëtoje gojëkyçur të regjimit politik. Megjithatë ajo nuk e shuan dashurinë për të vërtetën dhe pret çastin kur koha do t'i japë të drejtë të flasë e të kumtojë të vërtetat që pa e nuk i foli, të vërtetat që njohu e u soll sikur nuk i pa, të vërtetat që dëgjoji e i ruajti, të vërtetat që lexoi e që më pluhur i mbuloi për të mos u djegur e harruar. Prandaj historia është prova se koha, gjykatësi i paanshëm dhe

i drejtë, nuk fal askënd. Ajo e bën çdokënd të paguajë çmimin e zgjedhjeve të veta.

Ditët përkujtimore si mundësi reflektimi

Në historinë e çdo kombi ka ngjarje madhore, që lënë gjurmë dhe mbeten të pashlyeshme në kujtesën historike. Ngjarje të kësaj natyre nuk duhet lënë në harresë, por as nuk duhen instrumentalizuar. Ato duhet të shërbejnë si gurë kilometrikë për të përcjellë tek brezat e rinj realitetin e trajektores historike të kombit, me të mirat dhe të këqijat e veta, me figura pozitive e negative.

Vetëm duke synuar të vërtetën do të kemi mundësinë të shohim dhe kuptojmë gjëra të cilat as që do të na shkonin nëpër mend, nëse interpretimin e fakteve historike do ta bënim përmes filtrave të politizimit të historisë. A mund të arrihet gjithmonë tek e vërteta historike? Ndoshta edhe mund të mos arrijmë, por do të kemi çelur shtigje që të çojnë brezat që vijnë atje ku duhet. Nuk mund t'i kryejë të gjitha shërbimet ndaj kombit një gjeneratë e vetme.

Mundësitë e kufizuara nuk do të duhet të na shterin energjinë për të hulumtuar. Këmbëngulja për të gërmuar në arkivat e kohës ka për të sjellë ndryshime të mëdha, ndryshime të cilat duhet të mirëpriten dhe mbështeten përderisa qëllimi mbetet shërbimi i mirë ndaj kombit. T'i rezistosh ndryshimeve që vlejné, të cilat i sjell rrjedha e kohës, nuk na çon askund. Mbetemi peng i narrativës së interpretimit historik njëtrajtësor dhe të tashmen e të ardhmen i dënojmë të qëndrojnë tek e kaluara. Është koha për refleksione të kthjellta. Ku gabuan brezat e së shkuarës? Cilat ishin dobësitë që duhet t'i korrigojmë? Cilat rrugë na çuan drejt dështimeve, e cilat drejt sukseseve? Si i duhet shërbyer kombit? Nga cilat ide e mendime e ka pësuar kombi? Kush na e do të mirën e kush nuk na do? A do të vazhdojmë të thellojmë ndarjet e së kaluarës apo do të përpiqemi të lexojmë historinë me akull të mendjes, ashtu siç edhe duhet ta kishim lexuar në rrjedhën e kohës?

Enver Hoxha në krye të PKSH

Formacionet politike që i njohim si parti politike janë grupime individësh që ndajnë besimin tek të njëjtat ide, qëllime dhe interesa të përbashkëta dhe organizohen për t'i arritur këto qëllime. Rendi natyror ka në themel hierarkinë. Shoqëria njerëzore epokë mbas epoke ka shkuar drejt organizimeve që përpiqen

t'i japin zgjidhje sfidave të kohës në të cilën jeton njeriu. Vlera apo kundërvlera, e mira apo e keqja e këtyre përpjekjeve gjykohet nga koha, pasi në përmasën e saj fizike shfaqen të gjitha qëllimet dhe përfundimet. Organizimi dhe funksionimi i formacioneve politike merr ngjyrat e interesave që synohen të realizohen dhe njëkohësisht ngjyrat e karakterit të udhëheqësit. Partia politike është simbiozë mes udhëheqësit dhe grupit. Ka udhëheqës që i imponohen grupit, ashtu sikundërse ka dhe udhëheqës që plotësojnë kërkesat e grupit. Asgjë nuk është e prerë me thikë dhe rrugës gjërat edhe mund të përmbysen.

Partia lind në një çast të caktuar si nevojë e rrethanave ku gjendet vendi, apo si mundësi për të realizuar aspiratat e një individi apo grupi të caktuar shoqëror. Edhe pse çdokush ka në vetvete dëshirën për të marrë në dorë kryesimin, hierarkia si ligj natyror kërkon që një të jetë në krye. Më 8 nëntor 1941 themelohet PKSH dhe drejtuesi i saj politik gjatë viteve të mbetura të Luftës së Dytë Botërore dhe jo vetëm, u bë dhe mbeti Enver Hoxha. Si arriti Enver Hoxha të zgjidhej në krye të PKSH? Si arriti t'i mbijetonte luftës politike brenda partisë dhe të imponohej si udhëheqësi i saj i padiskutueshëm dhe i pazëvendësueshëm? A ishin vetëm aftësitë e tij individuale apo pati edhe mbështetje nga të tjerë aktorë që iu interesonte figura e tij në krye të PKSH? Historia jo rrallë është një kombinacion iracional mes fakteve dhe fatit, mes rrethanave dhe përmbysjve të paparashikuara nga logjika.

Në rrugëtimin politik të Enver Hoxhës kemi dy versione që japin panorama të ndryshme të ngjithjes së tij politike në Shqipëri. Versioni i parë është ai zyrtar 1944-1991, ku figura e tij ngrihet në kult dhe çdo gjë i blatohet gjenialitetit të tij prej udhëheqësi të madh e legjendar. Versioni i dytë është ai i fakteve historike, njerëzve që e kishin njohur nga afër, dokumenteve arkivore të kohës, kritikëve të tij politikë, bashkëluftëtarëve të vet.

Ngjitja në krye të PKSH, dominimi i padiskutueshëm i saj ishte rezultat i:

- 1) Mbështetjes së padiskutueshme të PKJ përmes njeriut të saj në Shqipëri Miladin Popoviç.

Erdhi në krye të PKSH në heshtje, ndoshta pa shumë ambicie, por që rrjedha e kohës dhe fati bënë të vetën dhe kalemi jugosllav firmosi për Enver Hoxhën.

Njeriu që ia kishte propozuar Titos Enver Hoxhën, Stanoje Simiçi, kryekonsulli të cilin Jugosllavia e kishte dërguar në Korçë qysh në vitin 1932 e që qëndroi në postin e tij për 7 vjet, është një urith komunist i cili, ndonëse i bënte temena

krajlit, në të vërtetë donte ta fuste atë shtatë pashë nën dhe. Ishte nga ata që të hante dhenë nën këmbë dhe ta jepte ujin me pe dhe bukën ta hidhte me hobe...Simiçi e kishte bindur Titon se njeri më të përshtatshëm se kandidati që do të paraqiste ai nuk mund të gjendej kurrën e kurrës në Shqipëri. Bandill dhe bukurosh, kali i huqeve më të ndryshme dhe i veseve më të ndyra, dështak nga të tëra anët, njeri që nuk zbrapset përpara asnjë poshtërsie apo krimi, ambicioz dhe mendjemadh gjer në mani, - ja personi që kërkonte koha e veçantë: njeriu i duhur në vendin e duhur. Dhe ky kampion që propozonte Simiçi quhej Enver Hoxha.¹

Në Shqipëri vepronin tri grupe komuniste të cilët nuk kishin arritur të gjenin gjuhën e përbashkët dhe secili prej tyre punonte sipas ideve të veta. Dora jugosllave i mbledhi në një të vetëm, duke u parashtruar trajektoren që do vijonte më pas.

Mbledhja e grupeve kryesore komuniste të Shqipërisë u bë në fillim të nëndorit të 1941 në Tiranë, sipas marrëveshjes së arritur midis udhëheqësve të këtyre grupeve. Në mbledhje muarën pjesë grupi komunist i Korçës, grupi komunist i Shkodrës dhe grupi i të Rinjve. Secili prej këtyre grupeve përfaqësohej me nga 5 vetë. Mbledhja zgjati rreth 5 ditësh dhe mbaroi në orët e vona të natës, më 8 nëndor 1941.²

*Këtu bëri një ndërhyrje të zgjuar Miladini, në rolin që **kishte luajtur si arbitër në mes grupeve***, dhe tha:*

...Prandaj unë, duke e parë propozimin vetjak të Koços në kuadrin e përgjithshëm, i sugjeroj Mbledhjes që në përbërjen e Komitetit Qendror të Përkohshëm të mos zgjidhet asnjë nga krerët e ish grupeve, as kryetarët, as nënkryetarët.³

Mbledhja vendosi shkrirjen e grupeve komuniste dhe krijimin e Partisë Komuniste të Shqipërisë, ajo zgjodhi Komitetin Qendror të përkohshëm. Shoku Enver Hoxha u zgjodh sekretar i përgjithshëm i PKSH. Në Komitetin Qendror, sipas kushtit të pranuar nga të gjitha grupet pjesëmarrëse në mbledhje, nuk u

¹ Beqir Ajazi, *Kush ishte Enver Hoxha*, (Tiranë: Shtëpia Botuese 55, 2007), 17.

*Të gjitha theksimet me bold në artikull janë të miat.

² Dokumenta kryesore të P.P.SH, (Tiranë: Instituti i Historisë së Partisë pranë KQ të PPSH vëllimi I, 1960), 7.

³ Enver Hoxha, *Kur lindi Partia*, (Tiranë : Shtëpia Botuese “8 nëntori”, 1983), 221.

*zgjodh asnjë nga ish krerët kryesorë të grupeve, me frymën e sëmurë fraksioniste dhe grupazhi.*⁴

Dora dhe fuqia e Miladin Popoviçit ishte kyçe për të gjithë mbarëvajtjen e procesit të themelimit të PKSH dhe drejtimin e saj gjatë LANÇ. Vetë Enver Hoxha, edhe pse ka shkruar historinë ashtu siç ka dashur, ka lënë copëza të vërtetash të cilat dëshmojnë qartë se pa dorën jugosllave dhe veçanërisht të Miladinit nuk do të ishte shndërruar në njeriun më të pushtetshëm në Shqipëri, gjë që i habiti të gjithë ata që e njihnin nga afër dhe që nuk kishin besuar kurrë se një njeri si ai do të bënte prokopi në jetë e jo më të merrte në dorë frenat e pushtetit në Shqipëri. Miladin Popoviç, Dushan Mugosha, Bllazho Jovanoviç, Svetovar Vukmanoviç Tempo, Velimir Stoiniç, Nijaz Dizdareviç, jo vetëm kanë mbikëqyrur punët e PKSH, por kanë sjellë orientimet dhe këshillat e Titos se si duhej kryer gjithë organizimi dhe veprimtaria e saj, për t'i lënë Shqipërisë në krye Enver Hoxhën.

Kryesorja është ta themelojmë Partinë sa më shpejt. Por, gjersa jemi në prag të nëntorit dhe e kemi në dorë caktimin e ditës së Themelimit, unë propozoj 8 nëntorin.

Shokët e aprovuan njëzëri propozimin tim. Ia thashë të gjitha këto Miladinit e shtova:

-Të lutem, ua propozoj këtë dëshirë të grupit tonë shokëve të grupeve të tjera dhe, në rast se nuk kanë kundërshtim, e vendosim përfundimisht. Ne, nga ana jonë jemi gati.

*Nuk vonoi dhe Miladini më lajmëroi se pranohej propozimi i bërë nga grupi ynë, për datën e fillimit të Mbledhjes së Grupeve Komuniste për të formuar Partinë Komuniste të Shqipërisë.*⁵

*Pastaj falenderova nga zemra Partinë Komuniste të Jugosllavisë dhe Komitetin Qëndror të saj për ndihmën që po jepte nëpërmjet shokëve Miladin e Dushan, të cilët, tok me ne, u përpoqën e dhanë kontributin e tyre në arritjen e takimit të kësaj dite.*⁶

Pas Bacës e mori fjalën Miladini.

-Unë jam anëtar i saj (PKJ) dhe jam urdhëruar prej saj që, me propozimin e

⁴ Dokumenta kryesore të P.P.SH, 7.

⁵ Hoxha, *Kur lindi Partia*, 156-157.

⁶ Hoxha, *Kur lindi Partia*, 169.

*komunistëve shqiptarë, - vazhdoi ai, - të jap ndihmën time modeste dhe eksperiencën që mund të kem, qoftë edhe të vogël, duke e vënë atë, si internacionalist, në shërbim të Partisë Komuniste të Shqipërisë, që ju do të formoni.*⁷

*Bëmë pushim. **Të gjithë e përqafuam Miladinin.***⁸

*Menjëherë pas konsultës e biseduam këtë me Miladin Popoviçin dhe i thamë që, për lidhjen tonë me Kominternin, mundësisht të ndërmjetësonte Partia Komuniste e Jugosllavisë, e cila ishte vetë anëtare e Kominternit dhe, mesa dinim, vazhdonte të mbante lidhje me “Qendrën”, pra me organet drejtuese të Internacionales.*⁹

*Njohjen dhe direktivat e Kominternit i solli në Shqipëri, në dhjetor të vitit 1942, Bllazho Jovanoviçi, anëtar i Komitetit Qendror të Partisë Komuniste së Jugosllavisë, një ndër drejtuesit kryesorë të Luftës Nacionalçlirimtare në Malin e Zi.*¹⁰

Urdhërat, kritikata, lëvdatat, qortimet që jepte shoku Miladin, - ka vërejtur Koço Tashko, - s’lanë asnjë dyshim, as në katundarin më të humbur, përsa i përket kryesisë së Partisë, që kryetari është serb.¹¹

*...qysh nga momentet e para të njohjes me Miladinin e vazhdimisht, ne pamë tek ai një komunist të brumosur, me shpirt të gjallë e luftarak, një mik të vërtetë të Partisë e të popullit tonë, të gatshëm të jepte edhe jetën për çuarjen përpara të çështjes sonë.*¹²

*Sipas atyre që lexoi Xoxja dilte se udhëheqja e Partisë sonë gjatë viteve të luftës na qenkësh monopolizuar nga tre-katër veta dhe , shprehimisht “s qaroi” se këta qenë, **i pari Miladin Popoviçi; i dyti unë; i treti Ramadan Çitaku dhe i katërti, për një periudhë, Ymer Dishnica e, pastaj, sidomos, Liri Gega! Të tjerët, sipas Koçit, ishin lënë mënjanë, ose nuk pyeteshin fare.***¹³

⁷ Hoxha, *Kur lindi Partia*, 190.

⁸ Hoxha, *Kur lindi Partia*, 192.

⁹ Hoxha, *Kur lindi Partia*, 333.

¹⁰ Hoxha, *Kur lindi Partia*, 334.

¹¹ AQSH/Ap, F.14, v.1942, D.5, fl.8. Letër e Koço Tashkos për Internacionalen Komuniste [tetor 1942]. Cituar sipas, Muharrem Dezhgiu, *Shqipëria nën pushtimin Italian (1939-1943)*, (Tiranë: Eneas, 2015), 236.

¹² Enver Hoxha, *Titistët*, (Tiranë:Shtëpia Botuese “8 nëntori”, 1982), 20.

¹³ Hoxha, *Titistët*, 175.

Miladin Popoviçi mbeti me PKSH. Është e qartë nga akuzat që u bënë kundër Enver Hoxhës në Plenumin e Beratit në vjeshtë 1944 (për të cilin shih hollësisht më poshtë), se Popoviçi ishte shumë i afërt me të dhe ka marrë pjesë plotësisht në udhëheqjen e partisë.¹⁴

Emri i Miladinit shfaqet në çdo moment që nga themelimi i PKSH e deri në largimin e tij nga Shqipëria. Pa arbitrimin e tij shkrija e grupeve komuniste do të kishte qenë e vështirë dhe ndoshta e pamundur. Misioni i tij në Shqipëri u përmyll me sukses. Enver Hoxha në fund të luftës kishte në duart e veta postet më të larta në parti dhe ushtri.

- 2) Karakteri intrigant dhe aftësia për të rrëshqitur mes kontradiktave të të tjerëve duke ecur me këmbëngulje drejt kreut të PKSH dhe Shqipërisë, duke treguar bindje të plotë ndaj palës jugosllave dhe politikës së saj në drejtim të elementit shqiptar në Ballkan.

Qysh nga themelimi i PKSH, i futur në Komitetin Qendror me propozimin e Koço Tashkos dhe më pak i rëndësishmi nga anëtarët e grupeve komuniste, Enver Hoxha do të zinte dalëngadalë postet më të rëndësishme në parti dhe ushtri; sekretar i përgjithshëm i PKSH, komisar dhe më pas kryekomandant i UNÇSH, kryeministër i qeverisë së përkohshme, poste që i ruajti edhe pas Plenumit të Beratit, pavarësisht kritikave që iu bënë dhe autokritikës së vet.

*Enver Hoxha nuk u zgjodh Sekretar i Parë i Partisë Komuniste të Shqipërisë në atë mbledhje. Ai, si dhe Qemal Stafa e Vasil Shanto, përkrahu idenë e Miladin Popoviçit që në Byronë e Partisë së sapokrijuar të mos zgjidheshin ish-drejtues të grupeve komuniste që kishin pasur konflikte mes tyre dhe që Partia, deri në një mbledhje të dytë, të mos kishte kryetar. Një komitet prej 7 vetash, i përbërë nga Qemal Stafa, Koçi Xoxe, Ramadan Çitaku, Gjin Marku, Tuk Jakova, Kristo Themelko dhe Enver Hoxha, do të kryente funksionet deri në mbledhjen tjetër...Zgjedhja e tij në Komitetin Qendror u bë me propozimin e Koço Tashkos, siç dëshmonte edhe vetë Hoxha në vitin 1944. “Kur u formua Partia unë u gjenda në Komitetin Qëndror, këtu hyra me propozimin e Koços...”*¹⁵

¹⁴ Reginald Hibbert, *Fitorja e hidhur, Lufta Nacionalçlirimtare e Shqipërisë*, (Tiranë: Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, 1993), 38.

¹⁵ Blendi Fevziu, *Enver Hoxha*, (Tiranë: UET Press. 2011), 73.

Dora jugosllave bëri goditjen e parë, duke përjashtuar nga drejtimi i PKSH ish-drejtnesit e grupeve komuniste. Kjo ishte dera e dytë që u hap për karrierën politike të Enver Hoxhës, pas asaj të parës, futjen në Komitetin Qendror me propozimin e Koço Tashkos. Në vijim do të hapeshin dhe shumë dyer të tjera, po nga e njëjta dorë për të lehtësuar ngjitjen e Enver Hoxhës në piramidën e pushtetit.

*Konferenca (Labinot, mars 1943, N.N) zgjodhi Komitetin Qendror të PKSH me 11 anëtarë dhe 6 kandidatë. Shoku Enver Hoxha u zgjodh sekretar i përgjithshëm i PKSH.*¹⁶

Edhe këtu nuk mungoi dora jugosllave për të nxjerrë në krye Enver Hoxhën. Me pretendimin se jemi në ilegalitet dhe ruajtjen e konspiracionit, në vend të emrave konkretë u votuan fletët me karakteristikat jetësore të kandidatëve të propozuar. Askush nuk ishte në dijeni se për cilin emër votoi. Si përfundim rezultoi që sekretar politik doli Enver Hoxha. A do të kishim të njëjtin rezultat po të ishte votuar me emra konkretë? Për të shmangur luftën e brendshme për pushtet hilet nuk munguan. Që kjo mënyrë e të zgjedhuri ishte gabim e pranon edhe vetë Enver Hoxha, por e justifikon me ilegalitetin, konspiracionin, mungesën e përvojës.¹⁷

Në Plenumin e Beratit e pranon po vetë se pa mbështetjen e Miladinit nuk do të ishte ngjitur aty ku kishte arritur.

*Do të theksoj zgjedhjen time si Sekretar Politik. Aliu (pseudonim i Miladin Popoviç) s'kishte besim tek asnjeri veç meje. Unë nuk e di vendimin që u mor për këtë, por di që Aliu mbrojti tezën që unë të isha Sekretar Politik.*¹⁸

Pasi u zgjodh në postin e sekretarit të përgjithshëm të PKSH, Enver Hoxha zuri vend të rëndësishëm edhe në UNÇL si komisar i saj, duke forcuar pushtetin politik përmes atij ushtarak.

...më 10 korrik 1943 në Labinot të Elbasanit, u mblodh Këshilli i Përgjithshëm i Frontit Antifashist Nacionalçlirimtar, si dhe përfaqësues të formacioneve partizane. Kështu u vendos krijimi i Ushtrisë Nacionalçlirimtare dhe Shtabi i saj i Përgjithshëm, i përbërë prej 12 vetësh:

¹⁶ Dokumenta kryesore të P.P.SH, 94.

¹⁷ Shih më gjerësisht, Enver Hoxha, *Titistët*, 36

¹⁸ Enver Hoxha, Autokritikë në Plenumin e Beratit, cituar sipas Blendi Fevziu, *Enver Hoxha*, 74.

1. Spiro Moisiu, komandant

2. Enver Hoxha **komisar**¹⁹

Ngjitja e Enver Hoxhës në majën e piramidës së pushtetit në Shqipëri ecte me shpejtësi. Dukej sikur koha punonte për të dhe fati ishte bashkuar me rrethanat historike për t'i dhënë në dorë këtij njeriu çelësat e Shqipërisë.

*Ngjarja, më e rëndësishme gjatë majit në jug ishte politike. Kjo që mbajtja e Kongresit I Antifashist Nacionalçlirimtar në Përmet ndërmjet 24 e 28 majit...Kongresit iu dha roli i një asambleje kushtetuese. Ajo u thirr për të zgjedhur një Komitet Antifashist Nacionalçlirimtar, i cili do të kishte atributet e një qeverie të përkohshme. Enver Hoxha u bë Kryetar i Komitetit, pra **kryetar i qeverisë së përkohshme**.*²⁰

*Nga ana ushtarake Këshilli nxori dekretin që UNÇSH, një ushtri partizane, kthehej në ushtri të rregullt dhe u vendosën gradat ushtarake. Enver Hoxha u bë **kryekomandant**.*²¹

Ndërkohë që ndaj të vetëve, ndaj atyre që i cilësonte të devijuar apo tradhëtarë të vijës bolshevike mbante qëndrimet më të ashpra, përdorte fjalët më denigruese, për marrëdhëniet me jugosllavët kujdesej që të ishin të ngrohta dhe vëllazërore.

*Për vetë marrëdhëniet e posaçme që kishim krijuar me PKJ, ne e pritëm **ngrohtë e me përzemërsi të dërguarin e ri të udhëheqjes jugosllave**.*²²

Enver Hoxha tregojë i bindur ndaj kërkesave jugosllave, duke u justifikuar me vëllazërimin ideologjik internacional, edhe pse kushtet në të cilat gjendeshin formacionet partizane shqiptare ishin tejet të vështira.

*Na erdhi, në atë periudhë një letër prej anëtarit të Byrosë Politike të KQ të PKJ, Ivan Milutinoviç (në atë kohë punonte në Mal të Zi), ku na kërkonte ndihma urgjente materiale etj., për lëvizjen dhe forcat partizane jugosllave në Mal të Zi...Transmetojini shokut Milutinoviç, - u thashë këtyre (Ramadan Çitaku, Vasil Shanto, N.N), se udhëheqja jonë vendosi t'ua plotësojë të gjitha kërkesat që na bëjnë për ndihmë materiale.*²³

¹⁹ Thoma Bezhani, *Mjeshtri i prapaskenave*, (Tiranë:Iliria, 1995), 61-62.

²⁰ Hibbert, *Fitorja e hidhur, Lufta Nacionalçlirimtare e Shqipërisë*, 223.

²¹ Hibbert, *Fitorja e hidhur, Lufta Nacionalçlirimtare e Shqipërisë*, 224.

²² Hoxha, *Titistët*, 122.

²³ Hoxha, *Titistët*, 92.

Me tërë ato të holla, që ua nisëm me gjithë zemër, ne mund të kishim pajisur dy brigada partizane me veshje e armatime. I kemi shokët zbathur e zhveshur...

*S'ia dhamë Ivanit, o Spiro – i thashë për ta qetësuar. – Ua dhamë luftës, partizanëve vëllezër jugosllavë.*²⁴

Për të mos humbur mbështetjen jugosllave që për të ishte jetike edhe kur ishte në diskutim çështja e statusit të Kosovës dhe Metohisë pas luftës, ai mbajti qëndrim internacionalist, duke u treguar shumë i kujdesshëm që të mos cilësohej aspak si nacionalist.

*Vendosëm, pra, që edhe në këtë rast, të shfaqnim publikisht mendimin tonë, pa e atakuar direkt udhëheqjen jugosllave dhe **pa lënë asnjë shkas që ajo të na akuzonte për “nacionalizëm”, për “shqiptaromëdhenj”.***²⁵

Për të qenë në shërbim të palës jugosllave ai vazhdonte të bënte propagandë ndër shqiptarë, me kërkesë po të jugosllavëve, se duhet të kishin besim në premtimet e PKJ për zgjidhjen e çështjes shqiptare në Jugosllavi, dhe se me rëndësi ishte lufta kundër armikut jashtëballkanik dhe se me popujt ballkanikë jemi miq e vëllezër.

*-Na bombardojnë me pyetje, - më tha Haxhi Lleshi në një takim që pata ato kohë me të. “Përse Partia Komuniste e Jugosllavisë, na thonë, nuk shprehet hapur për çështjen tonë?”. “Përse nuk e zë fare në gojë çështjen e statusit të Kosovës, të Metohisë, të Dibrës etj., të paktën në ato raste kur shprehet për të drejtën për vetëvendosje të kombeve të tjera të ish-mbretërisë jugosllave?!”. “Kush na garanton nëse lufta që po bëjmë, e duhet ta bëjmë më me forcë, do të na e zgjidhë çështjen tonë të shenjtë?”. Ne mundohemi t’u përgjigjemi, - vazhdoi Haxhiu, - por, më beso, shoku Enver janë ca gjëra që s’dimë si t’u përgjigjemi. **Druhemi se mos padashur i bëjmë dëm partisë jugosllave.**- Ne duhet t’u themi vëllezërve tanë të vërtetën, - i thashë Haxhiut. – në rradhë të parë t’u shpjegojmë qëndrimin e Partisë sonë për këtë problem. T’u themi se mendojmë e besojmë që edhe Partia Komuniste e Jugosllavisë kështu e sheh problemin e çështjes nacionale. **Kryesorja tani, t’u shpjegojmë vëllezërve tanë, është lufta kundër pushtuesit të përbashkët.** Ai është armiku ynë kryesor, pra, i shqiptarëve, i maqedonasve, i serbëve, i të gjithëve...*

²⁴ Hoxha, *Titistët*, 93.

²⁵ Hoxha, *Titistët*, 99-100.

Në të njëjtën kohë, sipas kërkesave të Komitetit Krahinor të PKJ për Kosovën e Rrafshin e Dukagjinit dhe të shtabit maqedon, vazhduam të dërgonim gjithnjë e më shumë shokë partie për të punuar në këto zona, në terren, por sidomos si kuadro në çetat, batalionet e njësitë e tjera ushtarake që po krijoheshin.²⁶

Mbështetja për të qëndruar në krye duhej shpague. Dhe për Enver Hoxhën nuk kishte rëndësi çmimi i shpagimit, por vetëm arritja e qëllimit në marrjen e pushtetit politik.

- 3) Spastrimeve në parti të rivalëve që mund të rrezikonin pozitën drejtuese të tij përmes përjashtimeve nga partia dhe vrasjeve që nisën që gjatë luftës dhe vazhduan edhe më pas.

Qysh në krye të herës, eliminimi i kundërshtarëve politikë brenda dhe jashtë partisë ishte refreni kryesor i Enver Hoxhës. Që në mbledhjen themeluese të PKSH u vendos theksi tek ndjekja e shembullit bolshevik leninist e stalinist në forcimin e rradhëve të partisë së re. Gjatë gjithë jetës nuk u ndal për asnjë çast duke prodhuar armiq të vazhdueshëm. Ai shfrytëzoi në maksimum vijën marksiste për spastrimin e rivalëve, duke e bërë vijën marksiste si shpatën e Demokleut që priste këdo që devijonte nga kuptimi që vetë Enver Hoxha i jepte kësaj vije. Likuidim fizik, përjashtime, denigrime të rivalëve politikë morën jetë për të prerë gjithë pemët që i bënin hije në drejtimin e punëve të partisë dhe pushtetit.²⁷

Komitetit Qëndror të përkohshëm i ngarkohet barra e rëndë të seleksionojë elementët, të organizojë dhe të forcojë partinë në shembëll të Partisë Bolshevike të Leninit e të Stalinit.²⁸

Partia ka vendosur të marrë një qëndrim të caktuar për të spastruar rradhët e saj...²⁹

Duhet të luftojmë pa mëshirë kundër elementëve trockistë, kundër të gjithë deviatorëve dhe armiqve të partisë duhet të merret seriozisht spastrimi i partisë nga elementët e luejtshëm, inaktivë dhe të pavendosur dhe sidomos nga elementët grupash. Organizatat dhe anëtarët duhet të vazhdojnë pa mëshirë

²⁶ Hoxha, *Titistët*, 101-102.

²⁷ Shih më gjerësisht, Blendi Fevziu, *Enver Hoxha*, 77-93, 131-158.

²⁸ Dokumenta kryesore të P.P.SH, 15.

²⁹ Dokumenta kryesore të P.P.SH, dokumenti nr. 11, ditët e para të korrikut 1942, 83.

*luftën kundër armikut të [Internacionales] K[omuniste] dhe të partisë sonë trockistit Zaji Fundo dhe elementëve të ndryshëm trockistë: Dhimitër Fallos, Aristidh Qendros, Niko Zozit, Niko Kondit, Andrea Zizit etj.*³⁰

Shokë e shoqe,

*Duhet t'i vemë shpatullat partisë sonë të re dhe t'i bjemë kryes pa mëshirë armiqve të saj të jashtëm edhe të brendshëm. Duhet t'u shtypim kokën rrymave dhe elementit trockist dhe grupash, elementit të fëlliqur, dallaveraxhi dhe frikaman që mundohet të dobësojë radhët e partisë.*³¹

Në dokumentet e cituara gjuha e përdorur është ajo e një urrejtjeje ekstreme, a thua se këta që urreheshin kaq shumë i kishin sjellë Shqipërisë një mijë e një të zeza. Ndërkohë me jugosllavët raportet duhej të ishin të ngrohta e të përzemërta. Dukshëm vihet re mungesa e mëshirës në dënimin e atyre që u cilësuan armiq e tradhëtarë vetëm sepse nuk e kuptonin vijën marksiste-leniniste ashtu siç e kuptonte Enver Hoxha. Deklamimet e kësaj natyre ishin kambanë alarmi për atë çfarë e priste Shqipërinë në të ardhmen, nëse pushteti do të binte në duart e PKSH. Vala e spastrimeve dhe eliminimeve që nisi gjatë LANÇ nuk u ndal deri në fillet e ndryshimeve demokratike.

Më 1942 përjashtohen nga partia Anastas Lula dhe Sadik Premte.³² Përjashtimi pasohet me vrasjen e Anastas Lulës.³³ Urdhri ishte dhënë edhe për pushkatimin e Sadik Premtes, por që nuk u finalizua.³⁴ Dënohet me vdekje Ludovik Nikaj më 1942 dhe ekzekutohet menjëherë pas çlirimit.³⁵ Vritet Zef Ndoja në fundin e vitit 1943, Labinot.³⁶ U dha urdhri për dënimin me vdekje të Llazar Fundos.³⁷ Vritet Mustafa Gjinishi.³⁸

Spastrimet fizike e përjashtimet nga partia u shoqëruan edhe me riformatime të byrosë politike. Por si e qysh u bë që, edhe në ditët më të errëta të karrierës politike në Plenumin e Beratit 23-27 nëntor 1944, e hodhi lumin me vetëm një

³⁰ Dokumenta kryesore të P.P.SH, dokumenti nr. 14, 17 mars 1943, 119.

³¹ Dokumenta kryesore të P.P.SH, dokumenti nr. 21, Qershor 1943, 151.

³² Hoxha, *Kur lindi Partia*, 321.

³³ Hoxha, *Kur lindi Partia*, 322.

³⁴ Hoxha, *Kur lindi Partia*, 435.

³⁵ Hoxha, *Kur lindi Partia*, 326.

³⁶ Hoxha, *Kur lindi Partia*, 326.

³⁷ Hoxha, *Titistët*, 27.

³⁸ Fevziu, *Enver Hoxha*, 109-110.

autokritikë? Sërish dora jugosllave iu ndodh pranë. Koçi Xoxe zhvendosi kritikën nga Enveri tek Liria e Ramadani, duke ua lënë atyre dopio gjashtën në dorë për problematikat e deritashme në zbatimin e vijës së partisë.

Pas disa seancash me debate të tilla, sulmet e tyre veçanërisht të Koçi Xoxes, u përqëndruan papritur mbi Liri Gegën e Ramadan Çitakun: Liri Gegës iu ngrit me forcë akuza për sektarizëm, kurse Baca u akuzua për inaktivitet. U propozua e u vendos që të dy të përjashtoheshin nga Byroja Politike dhe, meqë mbeteshim vetëm tre, aty për aty u propozua të kooptonim dy të tjerë.³⁹

...nga 7 anëtarë të Byrosë që ishin zgjedhur në Konferencën e Parë, tani mbetën vetëm tre: Enver Hoxha, Nako Spiro e Koçi Xoxe. Sa për katër të tjerët, dy ishin përjashtuar qysh në Konferencën e Parë të vendit (Gjin Marku dhe Ymer Dishnica), në mars 1943 dhe dy të tjerët në Berat (Ramadan Çitaku dhe Liri Gega). Këta u zëvendësuan respektivisht me Pandi Kriston, Sejfulla Malëshovën, Tuk Jakovën dhe Bedri Spahiu.⁴⁰

Veç Koçi Xoxes që i dha mbështetje, të pamenduar prej Enver Hoxhës, edhe i dërguari jugosllav, Velimir Stoiniç, i doli në mbrojtje kur Sejfulla Malëshova e kritikoi fort për vijën e ashpër të spastrimeve fizike me prapavijë ideologjike.

Sektarizma e theksuar në vijë, - deklaroi ai (Sejfulla Malëshova, N.N) gjithë mllef, - po e kthen Partinë në një bandë terroristësh! Te shokët tanë, sidomos tek ata të udhëheqjes kryesore, ka humbur zemra e vërtetë e komunistit që i dhimbset jeta e njeriut.⁴¹

Kjo ishte rruga ku kishte përfunduar PKSH duke ndjekur vijën leniniste dhe staliniste nën ndikimin e fortë të Miladin Popoviçit e Dushan Mugoshës.

Duhet të krijojmë dhe të spastrojmë partinë si na ka mësuar i madhi Lenin, si na ka mësuar i madhi Stalin, duke krijuar partinë më revolucionare, dhe të marrim vënd të merituar në radhët e lavdishme të IK (Internacionales Komuniste, N.N).⁴²

Enver Hoxha u kritikua në këtë plenum jo vetëm nga të vetët, por edhe nga jugosllavët. Përtej kritikës, këta të fundit nuk mund të linin investimin e tyre të shkonte dëm. Stoiniç mori në mbrojtje Enver Hoxhën ndaj akuzave të

³⁹ Hoxha, *Titistët*, 161.

⁴⁰ Bezhani, *Mjeshtëri i prapaskenave*, 82-83.

⁴¹ Hoxha, *Titistët*, 171.

⁴² Dokumenta kryesore të P.P.SH, dokumenti nr. 14, 17 mars 1943, 119.

Malëshovës, duke lehtësuar pozitat e tij.

Bile vetë Stoiniçi, kur dëgjoi akuzën e Sejfullait, u ngrit dhe e quajti “të avancuar”, “të nxituar”, bile “të padrejtë”...”.⁴³

Pasi qeveria e përkohëshme ishte vendosur në Tiranë, ishte po vetë Stoiniç që i shpjegoi qartë Enver Hoxhës se Plenumi i Beratit ishte një mundësi për vetë atë për të spastruar partinë nga kritikët e tij, të cilët dolën hapur kundër në Berat. Edhe pse u kritikua ai nuk u shkarkua nga funksionet që kishte. Madje plenumi u ndërpre më datën 27 nëntor për të mos u vazhduar më, sepse të nesërmen qeveria provizore duhej të hynte në Tiranë. Një tjetër ndërhyrje e fatit historik në favor të Enver Hoxhës.

Vetë kolonel Stoiniçi, pas kaosit dhe pëishtjellimit që na shkaktoi në Berat, filloi të më afrohej.

Por ajo që na kishte ndodhur në Berat qëndronte si një re e zezë që nuk ishte zhdukur. Përkundrazi, çdo ditë ndihej efekti i saj i keq në punët tona të përditshme, të vogla ose të mëdha.

Ia thashë këtë Stoiniçit në një nga vizitat e shumta që nisi të më bënte pasi u vendosëm në Tiranë, duke i theksuar se nga Plenumi i Beratit hëpërhë po shohim vetëm efekte negative.

Sa të ftohen pasionet dhe do të shihni se gjithçka do të ndryshojë, - u mundua të më qetësonte ai. – Shokët në Berat u mësuan si të bëhet kritika e autokritika. Kjo është me shumë vlerë për sot e për të ardhmen.

Veç, - i thashë, - kam përshtypjen se kritika u bë duke hedhur baltë mbi prestigjin e Partisë, të udhëheqjes së saj dhe timin.

Duhet të më kuptoni drejt, - m’u përgjigj. – kurrsesi nuk kishim as unë, as shokët tuaj për synim të çënohej autoriteti i Partisë suaj dhe, ca më pak, juaji personalisht. Ju e patë vetë se dhe shokët e Byrosë nuk patën ndonjë gjë me ju direkt, përkundrazi, ata janë të kënaqur që ju jeni Sekretar i Përgjithshëm i Partisë!⁴⁴

I nisur si një rrugëtim që nuk dihej si do të ishte fundi, që nga pjesëmarrja pa kontribut në mbledhjen themeluese të PKSH, kooptimi në Komitetin Qendror, kapja e njëpasnjëshme e posteve kyçe në parti dhe ushtri, për t’u finalizuar me

⁴³ Hoxha, *Titistët*, 172.

⁴⁴ Hoxha, *Titistët*, 205.

atë të kryeministrit të qeverisë provizore, i ushqe Enver Hoxhës etjen për të shtënë në dorë pushtetin në Shqipëri dhe i thelloi intrigën dhe arrivizmin për arritjen e qëllimit.

*...ja ku ishte Enver Hoxha, i cili jo vetëm luante me luftën civile ose bënte gjëra që bartnin rrezikun e luftës civile, por edhe e kishte angazhuar në mënyrë të pakthyeshme gjithë lëvizjen e tij dhe ushtrinë partizane për të marrë pushtetin dhe për të ngritur një qeveri “popullore”, e cila nuk do t’u jepte zogistëve e të tjerëve asnjë mundësi tjetër, veçse: ose të nënshtroheshin, ose të eleminoheshin.*⁴⁵

Duke e ndier veten mjaftueshëm të fortë në pozitat drejtuese, shpalli hapur se Fronti ishte përdorur si maskë për qëllimet e vërteta të PKSH.

*Jemi në pragun e Çlirimit të plotë të Shqipërisë, jemi përpara detyrash të një rëndësie të madhe dhe **Partinë tonë**, që ka qenë udhëheqësja e vërtetë e kësaj lufte çlirimtare **nuk ka pse ta fshehim pas Frontit.***⁴⁶

PKSH qëndroi e fshehur pas Frontit që lufta për pushtet të qëndronte e maskuar brenda LANÇ-it dhe që propaganda e saj politike me frymë internacionaliste të zinte vend në mesin e popullsisë, në mënyrë që, kur të goditeshin kundërshtarët ideologjikë në luftën për pushtet, kjo të dilte si luftë kundër armiqve dhe tradhëtarëve të Shqipërisë. Ishe apo jo armik i popullit këtë e përcaktonte vija politike. Ky qëndrim është kryekëput i gabuar dhe aspak realist, por ideologjitë ecin me parimin: O me ne, o kundra nesh. Rrugë të tretë nuk ka.

*-Dëgjo, Zai Fundo! Ti je antifashist vetëm me fjalë, por me qëndrime e me vepra je trockist, armik i komunizmit, i Stalinit, pra je dhe armik i popullit tonë.*⁴⁷

LANÇ-i eci paralelisht me luftën për pushtet. Qëllimi i Enver Hoxhës për të marrë në dorë pushtetin u duk qartë me hedhjen poshtë të marrëveshjes së Mukjes.

Këmbëngul se dënimi që i bëte Mukjes ishte sektarizëm, - përsëriti Velimiri. – duhet të gjenit gjuhën për t’i bindur krerët e Ballit.

*Kurrë! Kjo do të ishte tradhëti, tradhëti ndaj Partisë, - iu përgjigj Miladini gjithë zemërim. – Po të kishim bërë këtë, ne duhej të na vinte populli shqiptar rrëzë një muri e të na hiqte plumbin. **Përse luftuan ky popull e kjo Parti? Që ta ndanin***

⁴⁵ Hibbert, *Fitorja e hidhur, Lufta Nacionalçlirimtare e Shqipërisë*, 224.

⁴⁶ Hoxha, *Titistët*, 201.

⁴⁷ Hoxha, *Kur lindi Partia*, 30.

*pushtetin me reaksionin?*⁴⁸

Fjalët e Miladinit në diskutimin me Stoiniç tregojnë shumë se kush qëndronte pas vendimeve të Enver Hoxhës për të minuar bashkëpunimin mes shqiptarëve me bindje dhe principe të ndryshme politike si dhe tregojnë qartë se lufta më e madhe ishte ajo për pushtet.

Përfundime

Nëse lexojmë të shkuarën me kujdes aty do të gjenden edhe shenjat e së ardhmes. Shumë të tregojnë si të jetosh, por pak të frymëzojnë. Shumë janë shembull si nuk duhet të jesh dhe pak janë kandilë që ndriçojnë.

Në rrafshin psikoanalitik karakteri i njeriut është i ndikuar nga fëmijëria. Traumata e fëmijërisë nuk humbin, por ato rishfaqen në stadi të mëvonshme moshore dhe kanë ndikimet e tyre në perceptimet dhe vendimet e njeriut.

Enver Hoxha nuk erdhi nga hiçi në jetën politike shqiptare. Një fëmijëri e vështirë, një rini e shturur dhe e ushqyer me vese, një njeri që nuk i skuqej faqja nga e keqja që vepronte, një njeri i tipit ha bukën e përmbys kupën, hakmarrës gjakftohtë, i gatshëm për çdo paudhësi e intrigë mjaft që të arrinte qëllimin, nuk kishte se si të mos e shpërfaqte karakterin arrivist gjatë gjithë jetës.

Para se ai të katapultohej në krye të PKSH, kishte njohur mjaftueshëm mjedisin politik shqiptar në vizitat dhe takimet që kryheshin në shtëpinë e kunatit, Bahri Omari dhe diplomacinë shqiptare si sekretar i konsullatës shqiptare në Belgjikë. Në mjedisin e Tiranës ka gëzuar mbrojtjen e Eqrem bej Libohovës, mbështetjen e kunatit Bahri Omari. Mbështetja e tyre e shpëtoi nga mjerimi në Paris pasi iu ndërpre bursa si student që nuk kishte marrë asnjë provim në dy vite universitet, nga papunësia kur u kthye në Shqipëri pas skandalit që shkaktoi në një darkë për përvjetorin e lindjes së mbretit të Belgjikës duke u prezantuar si princi i kurorës shqiptare.⁴⁹

Një karakter i tillë nuk e ka të lehtë të korrigjohet. Si jetohet rinia, ashtu vjen dhe pleqëria. Pa dyshim që karakteri i Enver Hoxhës mund të shërbejë si rast studimi në psikoanalizë, për të njohur në thellësi karaktere të kësaj natyre, për të kuptuar arsyet që e shtynë këtë njeri të eliminonte çdokënd që e kundërshtonte

⁴⁸ Hoxha, *Titistët*, 125.

⁴⁹ Shih më gjerësisht: Beqir Ajazi, *Kush ishte Enver Hoxha*, 23 – 31, 35 – 89.

dhe që fjalët dhe veprimet e tij i konsideronte gjithmonë të drejta dhe të keqen e projektonte gjithmonë tek tjetri.

Tregohet se një njeri që dëshironte të banonte në Athinë takoi Sokratin e madh dhe i tha:

- Dëshiroj të vendosem në Athinë. Si janë njerëzit e Athinës?

Sokrati e pyeti:

- Si janë njerëzit e vendit tënd?

Ai u përgjigj ,se njerëzit e vendit të tij ishin hajdutë, të poshtër, maskarenj, të ndyrë, të fëlliqur etj.

Sokrati i tha:

- Kështu janë edhe njerëzit në Athinë.

Pas njëfarë kohe erdhi një njeri tjetër dhe takoi Sokratin. I drejtoi të njëjtën pyetje. Sokrati i tha:

- Si janë njerëzit e vendit tënd?

Ai u përgjigj se njerëzit e vendit të tij ishin të butë, të mirë, të mëshirshëm, ndihmonin njëri-tjetrin, të drejtë, etj.

Sokrati i tha:

- Kështu janë edhe njerëzit në Athinë.

Nxënësit e tij të çuditur e pyetën se pse njërit i tha që njerëzit në Athinë janë të poshtër e tjetrit i tha që janë të mirë, kur dihet që ka dhe të mirë dhe të poshtër.

Sokrati u përgjigj:

- Ata do të gjenin të njëjtët njerëz në Athinë siç përshkruan njerëzit e vendit të tyre, sepse ai lloj karakteri rron brenda tyre.

Enver Hoxha nuk mund t'i shpëtonte karakterit të vet, edhe pse në të gjitha veprat e tij del si një udhëheqës i madh, gjenial e i pagabueshëm që gjithmonë ka ecur drejt, sepse kështu ia diktonte logjika marksiste – leniniste dhe për rrjedhojë veprimet e tij ishin po ashtu të drejta. Përmes sulmeve ndaj rivalëve e kundërshtarëve ai na ka treguar vetveten. Ai shihte tek të tjerët atë që gjallonte brenda tij.

Zai Fundo – skile e vjetër dhe dinake.⁵⁰ Plehër trockiste, bandit.⁵¹

Koço Tashko – megaloman, frikaman, dhjeraman.⁵²

⁵⁰ Hoxha, *Kur lindi Partia*, 31.

⁵¹ Dokumenta kryesore të P.P.SH, dokumenti nr. 14, 17 mars 1943, 119.

⁵² Hoxha, *Kur lindi Partia*, 43,88.

Andrea Zisi – qelbanik.⁵³

Anastas Lula – ngadhënjimtar dinak, llogaritar mediokër, trockist, shpirtlig, intrigant, katran nga fytyra, miop, gjarpër me syze, i fëlliqur, qen gjahu.⁵⁴

Sadik Premte – trockist, shpirtlig, intrigant, qen gjahu.⁵⁵ Dallaveraxhi, i pabesë, element i ndyrë, mikrob i fëlliqur.⁵⁶

Pandi Kristo – nulitet në çdo pikëpamje, bisht i verbër i Koçi Xoxes, kuzhinier shpifjesh e akuzash.⁵⁷

Liri Gega – ambicioze, karrieriste, kaqole, harbute e manjake për pushtet.⁵⁸

Koçi Xoxe – shikim të shtrembër si ai vetë.⁵⁹

Sejfulla Malëshova – vlera zero, prototip i një mikroborgjezi, gjoja ishte i penës, arrivist, i pëlqenin mburrjet, trockist, fodull, filozof pa kokë, fytyrë si brumë i prishur, blofist, kontradiktor, mishërimi më i përkryer i oportunistit klasik.⁶⁰

Nako Spiru – i prirur për intriga, njeri i tarafeve, thashethemexhi, ambicioz, i mbërthyer nga verbëria, meskin dhe kritizer i sëmurë, impulsiv, nervoz.⁶¹

Ymer Dishnica – oportunist.⁶²

Mustafa Gjinishi – agjent i Intelixhens Servisit anglez.⁶³

Ludovik Nikaj - provokator i ndyrë.⁶⁴

Jeta e njeriut që dominoi politikën shqiptare aktivisht, 8 nëntor 1941 – 11 prill 1985, nuk mund t'i përkasë vetëm historisë. Enver Hoxha është shembulli se si nuk duhet të jesh. E nëse ka një arsye të fortë pse duhet studiuar jeta e tij, është nxjerrja e mësimëve për të mos lejuar karaktere të tillë të marrin në dorë fatet e vendit, përmes monopolizimit të pushtetit.

⁵³ Hoxha, *Kur lindi Partia*, 179.

⁵⁴ Hoxha, *Kur lindi Partia*, 205,311,312.

⁵⁵ Hoxha, *Kur lindi Partia*, 311,312.

⁵⁶ Dokumenta kryesore të P.P.SH, dokumenti nr. 19, 17 qershor 1943, 138, 139.

⁵⁷ Hoxha, *Titistët*, 152, 163.

⁵⁸ Hoxha, *Titistët*, 149, 153, 154.

⁵⁹ Hoxha, *Titistët*, 169.

⁶⁰ Hoxha, *Titistët*, 144, 157, 170, 171.

⁶¹ Hoxha, *Titistët*, 147, 180,186.

⁶² Hoxha, *Titistët*, 125.

⁶³ Hoxha, *Titistët*, 125.

⁶⁴ Dokumenta kryesore të P.P.SH, dokumenti nr. 14, 17 mars 1943, 119.

Bibliografia

Ajazi, Beqir. *Kush ishte Enver Hoxha*. Tiranë: Shtëpia Botuese 55, 2007.

Bezhani, Thoma. *Mjeshtri i prapaskenave*. Tiranë: Iliria, 1995.

Dezhgiu, Muharrem. *Shqipëria nën pushtimin Italian (1939-1943)*. Tiranë: Eneas, 2015.

Dokumenta kryesore të P.P.SH. (Tiranë: Instituti i Historisë së Partisë pranë KQ të PPSH vëllimi I, 1960),

Fevziu, Blendi. *Enver Hoxha*. Tiranë: UET Press, 2011.

Hibbert, Reginald. *Fitorja e hidhur, Lufta Nacionalçlirimtare e Shqipërisë*. Tiranë: Shtëpia Botuese e Lidhjes së Shkrimtarëve, 1993.

Hoxha, Enver. *Kur lindi Partia*. Tiranë: Shtëpia Botuese “8 nëntori”, 1983.

Hoxha, Enver *Titistët*. Tiranë: Shtëpia Botuese “8 nëntori”, 1982.

TË PANJOHURAT E NGJARJEVE TË DATAVE 8-9 SHTATOR 1943 NË KORÇË

Ruela AGO

Abstrakt

Në bulevardin “Shën Gjergji”, ku sot ndodhet pedonalja e qytetit të Korçës, aty ku bulevardi bashkohet me rrugën “Ligor Rëmbeci”, në krah të godinës së konsullatës greke është e vendosur një pllakë përkujtimore ku shkruhet: “Këtu më 9 shtator 1943 gjatë një demonstrate antifashiste u vranë 59 demonstrues dhe u plagosën 120 të tjerë”. Në fakt kjo është një pllakë e vogël po të kemi parasysh sesa rëndësi u jepte regjimi komunist simbolikave të Luftës së Dytë Botërore. Anëmbanë Shqipërisë ngrihen lapidarë e përmendore të përmasave shumë të mëdha për nder të dëshmorëve të kësaj lufte. Pyetjet që mund të ngrihet nga kushdo janë: Pse kjo ngjarje nuk është studiuar sa dhe si duhet, qoftë nga historiografia komuniste qoftë ajo e pas viteve ‘90? Pse në kujtim të ngjarjes së 9 shtatorit 1943 është vendosur vetëm një pllakë e vogël? Pse jo një monument i përmasave të ngjarjes? Pse nuk janë të shënuar emrat e të vrarëve të kësaj ngjarjeje etj?

Ky punim është një përpjekje për të zbardhur të panjohurat e kësaj ngjarjeje. Gjithashtu punimi synon të risjellë në vëmendjen e autoriteteve lokale dhe qendrore përkujtimin e saj në përmasat që ka ndodhur. Së fundi, punimi ynë do të përpiqet që t’u japë përgjigje pyetjeve të mësipërme dhe njëkohësisht të rihapë një debat mes historianëve të sotëm për të gjitha aspektet e kësaj ngjarjeje.

Fjalë kyç: autoritete lokale, përmendore, pllakë përkujtimore, regjim komunist simbolika.

Hyrje

Ushtritë italiane kishin pësuar humbje ushtarake në të gjitha frontet. Sulmi i suksesshëm i Aleatëve në Sicili së bashku më intrigat e brendshme brenda qeverisë dhe forcave ushtarake i dhanë goditjen përfundimtare regjimit fashist në Romë. Në këtë situatë në 8 shtator 1943 u shpall kapitullimi pa kushte i Italisë.¹ Kjo gjë i çoroditi trupat italiane kudo që ato ndodheshin. Lajmi i armëpushimit, të Italisë fashiste para aleatëve anglo-amerikanë, u dha nga radioja, në orën 20:30. Njoftimi nga Roma krijoi menjëherë hutim, ankth dhe

¹ Bernd J. Fisher, “Shqipëria gjatë luftës 1939-1945”, (Tiranë: ÇABEJ, 2004), 209

pasiguri tek oficerët dhe ushtarët e divizionit italian “Arezzo” në Korçë.² Sipas studiuesit ushtarak Massimo Coltrinari, pasiguria u rrit kur gjatë mbrëmjes së 8 shtatorit nën komandën italiane në Korçë erdhën disa urdhra kontradiktorë. Një gjysmë ore para dhënies në lajmit nga radiot italiane, pati ardhur një urdhër nga korparmata, me qendër në Elbasan, e cila porosiste që të mos merrej parasysh çfarë thoshte Radio-Roma.³

Në orën 01:25 të 9 shtatorit komanda e divizionit “Arezzo” mori urdhrin që gjermanët të kundërshtoheshin me armë në rast se përpiqeshin të hynin në territorin shqiptar. Shumë shpejt, rreth orës 02:30, ky urdhër u ndryshua: para se të merrej vendimi për t’i ndaluar gjermanët duhej fillimisht të hetohej qëllimi i kolonës gjermane. Gjenerali Arturo Torriano këtë urdhër i’u përcollti garnizonit të Pogradecit, i vetmi që në këtë situatë ishte afër vendit të lëvizjes së autokolonës dhe mund të vepronte. Ky garnizon u nis nga kazeremat rreth orës 03:00 dhe në 05:30 zuri pozicione afër Shën Naumit.⁴

Në datën 9 shtator kur sapo pati kaluar mesdita, në komandën e divizionit “Arezzo” mbërriti urdhri që të gjitha trupat italiane në Qarkun e Korçës, të cilët qenë shtrirë që nga skaji më verilindor i rrethinave të Pogradecit deri në atë juperëndimor të Kolonjës, të grumbulloheshin pa u vonuar në qytetin e Korçës. Në orën 13:00 ndërhyri shtabi i korparmatës në Elbasan. Ai transmetoi të shkruar marrëveshjen e përfunduar mes asaj komande dhe autoritetit epror të divizionit 100 gjerman, i cili përfaqësohej nga majorët Lebner dhe Kress. Në bazë të marrëveshjes, njësitë italiane do të lëviznin lirisht në rrugët e Shqipërisë për të shkuar në drejtimet e parasaktësuar dhe si kompensim duhej t’u dorëzonin gjermanëve armët e artilerisë dhe armët e reparteve.⁵

Trupat duhej të mbanin pistoletat, armët personale automatike, mitralozat si edhe municionet e tyre. Pasditën e 9 shtatorit 1943 komanda e divizionit “Arezzo” në qytetin e Korçës urdhëroi të gjitha repartet vartëse të bëheshin gati, sipas një rregulli të caktuar, për të lëvizur në drejtim të Elbasanit. Po atë pasdite, komandës së garnizonit të Pogradecit i erdhi urdhri që të zihej me shpejtësi një

² Massimo Coltrinari “Qëndresa e ushtarakëve italianë jashtë vendit-Shqipëria 1943- 1945, botuar në “Rivista Militare” 1999.

³ Coltrinari “Qëndresa”

⁴ *Po aty*

⁵ *Po aty*

priti kundër gjermanëve në fshatin Lin dhe një tjetër në rrugën automobilistike, e cila të çonte në Ohër. Pas dy orësh, të dyja urdhrat u anuluan.⁶ Kjo ishte situata e paqartë e asaj që po ndodhte me ushtrinë pushtuese italiane tashmë të kapitulluar.

1. Kush e organizoi demonstratën e 9 shtatorit?

Studiuesit Ligor Mile dhe Stavri Naçi në librin “*Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare në qarkun e Korçës 1939-1944*” sjellin këtë version: Komiteti Qarkor i Korçës në datën 8 shtator, mbajti një mbledhje ku u thirrën sekretarët e celulave të Partisë Komuniste dhe disa komunistë. Aty u dhanë udhëzime për organizimin e një demonstrate të banorëve të qytetit. Për organizimin e saj u ngritën në këmbë komunistët, grupet edukative, të rinjtë komunistë, anëtarët e këshillave nacionalçlirimtare, anëtarët e sindikatave e anëtarë të gruas.⁷ Këtu vihet re gjuha e përdorur nga historianët e kohës e cila flet për një mobilizim të shtresave shoqërore pjesë e organeve të Partisë Komuniste.

Dëshmi me vlerë për këtë ngjarje është një dokument arkivor i hartuar nga një dëshmitar okular. Në arkivin e shtetit gjendet dokumenti i shkruar nga Idhomene Bratko, anëtar i Këshillit Nacionalçlirimtar të qytetit të Korçës.⁸ Ky dokument na sjell mjaft të dhëna: *së pari* ai thekson se kapitullimi i Italisë u njoftua në mbrëmje vonë nga radiostacionet dhe se një pjesë e qytetarëve tashmë kishin mësuar kapitullimin e Italisë. Ky dokument nuk sjell ndonjë të dhënë për mbledhje ose ndonjë organizim në datën 8. Ditën e nesërme në orën që lejohej qarkullimi, Bratko doli nga shtëpia për të takuar anëtarët e tjerë të Këshillit Nacionalçlirimtar. Sipas dëshmisë së tij gjithçka që ndodhi duket se është pasojë e datës 9 shtator.

Në orën 9 të mëngjesit ai takoi Koli Rrodhen, Kryetar i Këshillit Nacionalçlirimtar.* Koli propozoi që anëtarët e Këshillit të mblidheshin dhe të

⁶ *Po aty*

⁷ Ligor K. Mile, Stavri Naçi, “*Lufta Antifashiste Nacionalçlirimtare në qarkun e Korçës 1939-1944*”, (Tiranë: Akademia e shkencave të RPS të Shqipërisë, 1986), 325

⁸ AQSH, ish AQP, Fondi 304, Demonstrata e 9 shtatorit 1943- Kapitullimi i Italisë, fl 1

* Këshilli përbëhej prej Koli Rrodhe i cili ishte edhe kryetar, Idhomene Bratko, Myrteza Shkëmbi, Qani Mborja, Pandeli Nase, Koço Theodhosi dhe Sali Mborja.

takoheshin me gjeneralin italian dhe në emër të Këshillit t'i kërkonin atij, që së bashku me gjithë ushtrinë italiane që ndodhej në Qarkun e Korçës t'i dorëzohej këtij Këshilli, propozim me të cilin Bratkoja nuk ra dakord. Nga ana e tij ai propozoi ngritjen e një Komisioni,* pjesë e të cilit të ishin edhe autoritetet lokale shqiptare. Ky mendim sipas Bratkos, u pranua edhe nga Koli Rrodhe.⁹

Rreth orës 12 të mesditës së datës 9 shtator ai takoi disa anëtarë të Komitetit Krahinor (Qarkor) të Partisë Komuniste të Korçës dhe u bëri më dije dakordësinë me Rrodhen. Prej tyre mësoi se ata kishin marrë vendim që të organizonin një demonstratë aty nga ora 5. Ata nuk kishin pranuar të paraqiteshin tek komanda italiane, por qëndrimin e komandës italiane do ta mësonin gjatë demonstratës. Koli Rrodhe zhvilloi një takim me disa anëtarë të Komitetit Krahinor* dhe aty u njoftua për vendimin e marrë.¹⁰

Rrodhja dhe Bratkoja takuan gjatë paradites së 9 shtatorit disa individë që përfaqësonin autoritetet lokale. Nga këto takime nuk u mor një vendim për të organizuar ndonjë demonstratë. Rrodhja në bisedat e kryera të asaj dite, vazhdoi t'i mbetej idesë se duhej zhvilluar një takim me autoritetet italiane. Në bisedat që zhvilloi me përfaqësuesit e autoriteteve lokale të kohës, ai mësoi se komandanti i xhandarmërisë Mahmut Golemi ishte takuar me gjeneralin italian dhe ai e kishte lejuar që demonstrata të kryhej. Për këtë gjë u njoftua edhe Komiteti Krahinor, anëtarët e të cilit u shprehën të lehtësuar. Në orën 4 të mbasdites, sipas dokumentit, populli kishte filluar të mblidhej.¹¹

2. Çfarë ndodhi në demonstratën e Korçës më 9 shtator 1943?

Le t'i kthehemi datës 9 shtator 1943 për të parë se çfarë ndodhi. Janë disa burime që hedhin dritë mbi këtë ngjarje. Dokumentet e rkivit të Shtetit Shqiptar na sjellin të dhëna për këtë ngjarje. Dokumenti më i hershëm për ngjarjen mban datën 10/9/1943, por është hartuar që ditën e ngjarjes nga kuestura e Korçës. Dokumenti ka këtë përmbajtje: *Sot në orën 16:00 ndërsa po zhvillohej në*

* Komisioni duhej të përbëhej prej Mitropolitit, Kryemyftiu, zvendësprefekti, kryetari i bashkisë, kryetari i odës tregtare dhe së bashku Koli Rrodhe dhe Idhomene Bratko

⁹ AQSH, isha AQP, Fondi 304, Demonstrata e 9 shtatorit 1943- Kapitullimi i Italisë, fq. 1

* Anëtarët e Komitetit Qarkor që takoi Koli Rrodhe ishin Pëllumb Dëshnica, Petro Rapi, Naxhie Dume

¹⁰ AQSH, Fondi 304, Demonstrata e 9 shtatorit 1943- Kapitullimi i Italisë, fq. 2

¹¹ Po aty fq. 3

sheshin Ciano një demonstratë e qetë me shkrime antigjermane dhe të favorshme për Italinë dhe italianët, mbërritën dy ushtarë të Ushtrisë Mbretërore dhe pa paralajmëruar njeri, hapën zjarr drejt turmës. Autorët u arrestuan shpejt nga Komanda e Divizionit dhe u paditën në Gjyqin e Posaçëm.¹²

Sipas të dhënave të autorit Massimo Coltrinari: *Në orën 16:00 të datës 9 shtator popullsia e Korçës së bashku me oficerët, trupën dhe civilët italianë, inskenuan një lloj demonstrimi duke thirrur “Vdekje gjermanëve!”, “Rroftë Italia!”, “Rroftë Shqipëria e Lirë!”, por një autobлиндë e ardhur prej komandës së divizionit hapi zjarr mbi këta demonstrues.¹³*

Te vëllimi i parë i “Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar 1939-1944 theksohet se: *Në Korçë një ditë pas kapitullimit të Italisë u zhvillua një demonstratë. Ajo nuk po zhvillohej me parrulla antiitaliane, por me parrulla antinaziste, me thirrjen për vëllazërim me italianët.¹⁴*

Të trija burimet përputhen në disa dhëna për ngjarjen, kur pranojnë **një demonstratë kundër pushtimit gjerman apo parrulla antigjermane** dhe të trija burimet theksojnë se **të shtënat janë kryer nga një autobлиндë italiane mbi demonstruesit.**

Dokumente në lidhje me urdhrin për të qëlluar mbi demonstruesit nuk kemi gjetur, por një e dhënë vjen nga dëshmia e Bratkos. Pas të shtënave mbi protestuesit, Bratkoja takoi përsëri Koli Rrodhen. Nga ai mësoi se Mahmut Golemi dhe Ymer Starova kishin shkuar te gjenerali italian. Pas bisedës më ta, ai i kishte izoluar ata në një dhomë me roje dhe në atë kohë kishte dhënë urdhrin që të dilte tanku dhe të nisej për veprim.¹⁵ Edhe historiografia shqiptare mban qëndrimin se ishte komandanti italian ai që dha urdhrin për të qëlluar.

3. Cilët dhe sa, ishin të vrarët në masakrën e Korçës?

Të dhënat zyrtare shqiptare japin numrin e 59 të vrarëve dhe 93 të plagosurve. Ka disa gabime në këto të dhëna. Këto pasaktësi mund të lidhen me mungesën e një hetimi të saktë në kohën e ngjarjes ose me mungesën e një studimi tërësor

¹² AQSH, Fondi 152. Mbi situatën në Qarkun e Korçës.

¹³ Coltrinari, “Qëndresa”

¹⁴ Instituti i Studimeve Marksiste-Leniniste pranë KQ të PPSH “Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar 1939-1944”, 538

¹⁵ AQSH, Fondi 304, Demonstrata e 9 shtatorit 1943- Kapitullimi i Italisë, fq.4

për këtë ngjarje. Numri më i lartë i të plagosurve mund të lidhet me vdekjen e disa të plagosurve që nuk janë zbritur nga ky numër.

Në vëllimin e parë “Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar” jepen këto të dhëna: demonstrata e 9 shtatorit 1943 në Korçë është më e përgjakshme nga të gjitha demonstratat e zhvilluara në Shqipëri. Në këtë demonstratë u vranë 59 vetë. 32 u vranë në vend dhe 27 vdiqën nga plagët dhe u plagosën 93 të tjerë. Edhe në vëllimin e dytë shifrat janë të njëjta më 59 të vrarë dhe 93 të plagosur.¹⁶

Të dhënat e para për masakrën e 9 shtatorit filluan të mbledhen në ditën në vazhdim. Dokumenti që na jep të dhënat e para për viktimat është dokumenti i cituar më sipër. Ai mban datën 10/9/1943, por që është hartuar që në ditën e ngjarjes nga kuestura e Korçës. Sipas këtij dokumenti nga hetimet e para u identifikuan 30 të vdekur dhe 60 të plagosur.¹⁷ Dy dokumente të tjera që mbajnë datat 8/11/1943 dhe dhe 19/11/1943 japin shifrën 50 të vrarë në ngjarjen e Korçës.¹⁸ Dokumenti i datës 8 flet edhe për një numër të madh të plagosurish ndërsa dokumenti i dytë nuk përmend të plagosurit. Dokumentet italiane flasin për 20 persona të vrarë dhe 150 të tjerë të plagosur”.¹⁹

Një dokument tjetër i arkivit të shtetit që mban datën 4 tetor 1943 i hartuar nga Nuçi Shaka dhe Anastas Gadeshi na sjell një informacion më të saktë për të vrarët në demonstratën e Korçës. Dokumenti i referohet datës 10 e në vazhdim. Në datën 10, një grup personash së bashku me hartuesit e materialit vizitojnë spitalin e Korçës për të parë gjendjen e të plagosurve. Situata në spital paraqitej e rëndë. Me largimin e italianëve gjithë qyteti ishte në kaos të plotë. Në spital mungonte thujse gjithçka. Nga ilaçet tek ushqimet dhe mjete të tjera të domosdoshme.²⁰

Ky është dokumenti i parë që na jep të dhëna specifike për të vrarët. Në këtë dokument pasqyrohen edhe emrat e një pjesë të të vrarëve në demonstratën e 9 shtatorit, gjithsej 32 persona. Përsa i përket të vrarëve të tjerë ata kanë vdekur nga plagët në ditët në vazhdim. Dokumenti përmban një listë me 32 të vrarë me

¹⁶ I instituti, “Historia”, 538

¹⁷ AQSH, F 152, MPB 194, Korça gjendja politike

¹⁸ AQSH, F 152 Mbi situatën në Qarkun e Korçës. Sekretarisë së Përgjithshme

¹⁹ Coltrinari “Qëndresa”

²⁰ AQSH, Fondi 304, Raport mbi ndihmën e dhënë viktimave të datës 9 shtator, fq. 1

emrat përkatës. etj. Numri 32 përputhet edhe me burime të tjera dhe ky duhet të jetë burimi parësor.²¹ Këta emra janë edhe në listën e dëshmorëve të atdheut.

Për t'u ardhur në ndihmë qytetarëve të plagosur u bënë përpjekje për të mbledhur ndihma në të holla dhe ndihma materiale. 20 të plagosur janë ndihmuar me ushqime e ilaçe. Sipas dokumentit u mbledhën 5542 franga nga të cilat 2000 u dhuruan nga Jorgo Mosko, 2320 nga organizatorët dhe pjesa tjetër u dhuria nga sindikatat. Përveç të hollave, qytetarë të ndyshëm dhuruan: kuti qumështi, miell, mish, vezë etj. Fushata për mbledhjen e ndihmave u shtri edhe në fshatrat përreth.²²

Pas mbledhjes së ndihmave u organizua edhe ndarja e tyre. Ndihamat u ndanë sipas një kriteri të tillë:

1. Ndihma për familjet e varfra të të vrarëve
2. Ndihma për të plagosurit e spitalit
3. Ndihma për të plagosur jashtë spitalit.

Ndihma në ushqime iu dha menjëherë familjeve të të vrarëve dhe të të plagosurve, por sidomos vëmendje iu kushtua furnizimit me ushqime të ndryshme e të nevojshme për të plagosurit.²³

4. Si është trajtuar kjo ngjarje nga historiografia shqiptare

Historiografia shqiptare nuk e ka trajtuar si duhet këtë ngjarje. Kjo ngjarje, nga përmasat, mund të krahasohet me masakrat më të mëdha që kanë ndodhur në Shqipëri gjatë Luftës së Dytë Botërore. Në tekstet e Historisë së Shqipërisë përmenden me hollësi ngjarje që nuk kanë patur këtë numër viktimash. Kujtoj këtu demonstratën e Korçës, në 8 nëntor 1941 ku u vra Koci Bako, demonstratat e Tiranës etj. Këto dhe të tjera ngjarje, kanë zënë vendin e tyre në tekstet e Historisë.

Ngjarje të tjera më të mëdha në viktima si masakara e Borovës, ose ajo e 4 shkurtit kanë patur gjithmonë vëmendje dhe historianët kanë debatuar qoftë në mënyrën sesi kanë ndodhur, qoftë me vendin që ato duhet të zënë në historinë tonë.

Në tekstet mësimore në gjimnaze ngjarja e 9 shtatorit nuk përmendet fare. Librat

²¹ *Po aty, fq.2*

²² *Po aty,*

²³ AQSH, Fondi Raport mbi ndihmën e dhënë viktimave të datës 9 shtator. fq. 2

që mësuesit shfrytëzojnë për klasën e 11-të dhe 12-të kur zhvillohet periudha e Luftës së Dytë Botërore, nuk kanë ndonjë referencë. Edhe në tekste më të hershme, kur kurrikula e lëndës “Historia e Shqipërisë” ishte më e zgjeruar, përsëri kjo ngjarje nuk trajtohej. Gjithashtu, edhe në tekstet e “Historisë së Shqipërisë” në sistemin universitar nuk gjendej asgjë për këtë ngjarje.

Për të plotësuar studimin tim, konsultova Vëllimin IV të “Historisë së Popullit Shqiptar”, botim i vitit 2008. Edhe në këtë botim nuk gjeta asnjë të dhënë për këtë ngjarje.

Pas kësaj, mora në studim dy botime të periudhës komuniste. “Historia e Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare të popullit shqiptar 1939-1944” Vëllimi I dhe Vëllimi II.²⁴ Në këto studime, që lidhen me Luftën e Dytë Botërore ngjarjet e datës 9 shtator 1943 në Korçë, trajtohen fare përciptazi. Nuk flitet asgjë për organizimin e demonstratës, rolin e Komitetit Qarkor të Korçës, rolin e Këshillit Nacionalçlirimtar ose të aktorëve të tjerë lokalë. Të dhënat që jepen aty, lidhen vetëm më datën e demonstratës dhe numrin e të vrarëve.

Përfundime

Memo Meto i bën jehonë luftës çlirimtare të popujve të shtypur kundër armikut dhe përpjekjeve të tyre burrërore për të groposur rendin e vjetër që përftoi luftën zaptajnëse. Te “Vajtim i italjankës” e thurur si rrëfim i një gruaje të thjeshtë italiane për vuajtjet dhe të zezat që fashizmi i solli popullit italian, ai shprehu dhimbjen e thellë të poetit për tragjedinë e madhe të Italisë, të cilën krerët fashistë e zhytën në uri dhe mjerim të papërs shkruar. Krijimet e M.Metos janë relativisht mjaft për kohën, e cila ishte shumë pak e përshtatshme për veprimtari krijuese dhe veçanërisht, po të kemi parasysh jetën plot shqetësime dhe të dendur me aktivitet politik të poetit. Ai shkroi kushtrime lufte, këngë me

një frymë të theksuar lirike, himne dhe vaje, në stilin e këngëve popullore. Por, në shkrimet e tij të luftës gjejmë edhe vjersha satirike ; “*Bashkëfjalim me një bej*”, “*Prefekti në haur*”, “*Azis strategu*” etj.) në të cilat, ku me humor të ashpër, e ku me satirë të fortë, vë në lojë propagandën e armikut dhe vizaton me ngjyra qesharake disa nga krerët ballistë. Në frymëzimin e M. Metos ushtroi ndikim kënga popullore historike, tek e cila ai mori shumë elemente artistike. Por, krahas kësaj, në vjershat e M. Metos gjejmë reminishenca edhe prej poezisë së Çajupit dhe të këngëve revolucionare të Luftës Nacional Çlirimtare.

Një cikël më vetë përbëjnë ato vjersha që i kushtohen shokëve, të cilët u vranë ose u plagosën në luftime. Poezi të tilla shkruan Ali Demi, Dino Kalenja, Kristaq e Margarita Tutulani, Kristo Isak, Memo Meto, etj. Poetët dëshmorë u ndanë nga jeta në moshë të re, ndaj lirika e tyre është e sinqertë, shpirtërore e natyrore njëherazi. Rinia, natyra, lulet, bilbilat, pranvera, këngët, agimet përbënin leksikun më të përdorshëm të poezive të autorëve dëshmorë. Pjesëtarë të këtij brezi letrar do të qenë edhe vëllezërit Stafa. Veliu (i njohur me pseudonimin Platonikus) dhe Qemali, të cilët dhanë kontributin e tyre në fushën e lirikës. Të dy do të lëvronin poezinë sociale, me theks kritik, përshkruar nga nota humaniste, me nota të dhimbshme. Poezitë e tyre frymëzohen nga ide liridashëse, po dallojnë nga njëri-tjetri. Veliu thekson dhe evidenton më shumë vuajtjen dhe dhimbjen njerëzore, është hermetik dhe herë-herë ka mendime të mjegullta. Kurse, lirika e Qemalit, ndonëse shkroi më pak se i vëllai, pulson nga mendimi revolucionar dhe është transparente dhe e drejtpërdrejtë në mesazhet që i drejton lexuesit. (Jorgaqi, 2009:25)

Duke qenë të rinj, larg familjarëve, ndodh shpesh që figura e nënës, motrës apo vëllait të jenë motive që zgjojnë vazhdimisht frymëzimin e poetëve dëshmorë. Këto poezi janë çaste intime kur ata i zë malli për nënën apo motrën që presin t'i përqafojnë. Vargjet janë të thjeshta dhe dalin nga thellësia e zemrës. Kjo tipologji vjershe gërshetohet me motivin e vendlindjes dhe me atë të fëmijërisë. Te vjersha “*Kujtim i fëmijërisë këndon!*”, Kristaq Tutulani shkruan: *As eja motër! / Të shtyjme me ngadalë lundrën e kujtimit, / ë çajmë lehtaz ndër shkulma shkumbëzuar, / të detit të gjerë të ëndërrimit.* (Jorgaqi 2009: f.310) Mjaft poezi të autorëve dëshmorë u kushtohen shokëve të rënë në fushën e betejës. Këto janë dhe krijimet më prekëse, plot dhimbje për humbjen e shokëve të idealit dhe plot me besim se gjaku i tyre nuk do të shkojë kot. Komunikimi i

kësaj poezie me publikun sigurohej nëpërmjet dorëshkrimeve kaligrafike, shumëfishimeve me shaptilograf, kalimin gojë më gojë, si në folklor. Një pjesë e vogël poezish u botuan në shtypin e kohës si: “Bota e Re”, “Kushtrimi i Lirisë”, “Koha e Re”, “Vatra e Rinisë”, “Normalisti” etj. Poetët dëshmorë nuk mundën dot të botojnë përmbledhje poetike në gjallje të tyre. Ata shkruan vjersha të shkëputura, cikle poezish me numër të pakët vargjesh, prozë poetike në formë hartimesh, teksti i të cilave përdorej në formë traktesh. Kjo është arsyeja që poezia e ndërprerë e dëshmorëve duhet perceptuar jo si krijimtari individualitetesh, por si tërësi letrare e disa personave që për shkak të vdekjes nuk mundën të krijojnë profilin e tyre poetik. Disave prej tyre si Qemal Stafës, Veli Stafës, Memo Metos, Jani Dodës e Kristaq Tutulanit u është mbledhur dhe botuar e plotë ajo ç’ka ata kishin shkruar në gjallje. Një përmbledhje me poezi e autorëve dëshmorë është botuar në vitin 1979. Përgjithësisht, poezia e dëshmorëve, me gjithë dobësitë që lidhen me shumë faktorë dhe kryesisht me klimën artistike të papërshtatshme të kohës dhe kulturën letrare individuale të paplotësuar, vjen si krijimtari e personave të shkolluar. Disa kishin mbaruar studimet në Normalen e Elbasanit, Liceun e Korçës, Tekniken Amerikane të Tiranës, gjimnazet e Shkodrës e Gjirokastrës, institucione arsimore këto, që për kohën kishin nivel të lartë të metodave, mësuesve e programeve mësimore. Qemal Stafa, Kristaq Tutulani e Dino Kalenja, kishin studiuar në universitetet italiane, njihnin e përdornin gjuhët e huaja, me të cilat lexonin letërsi botërore në origjinal apo literaturë politike. Poezitë e autorëve dëshmorë janë të thjeshta e të qarta, formësohen përmes ligjëritimit të drejtpërdrejtë të modelit folklorik të vargëzimit. Dikush synon poezinë e shkurtër në strofë të rregullt e 4-vargësh, por të tjerë si Qemal Stafa e Gjik Kuqali përdorin me sukses vargun e lirë. Kjo poezi nuk është cilësore, nuk ka nivel të lartë estetik, është modeste dhe e thjeshtë ndaj përbën një fakt historiko-letrar, që lindi dhe shterroi bashkë me Luftën e dytë Botërore, për të treguar në momente historike se poezia mund të funksionojë dhe si akt moral.

Motive të reja ngjyra të reja fiton edhe proza e kësaj periudhe e autorëve dëshmorë, veçanërisht vlen të përmendim kapërcimin cilësor që vihet re në skicat e tregimet e Gjik Kuqalit. Me shumë dashuri skicon ai portretin e Qemal Stafës në skicën „Tri herë“. Në tregime të tjera të këtij autori si: “Gjaku“, “Në atë dhomën matanë“ etj., pasqyrohet artistikisht shpirti i lartë i sakrificës së bijve

të dalë nga populli. Për t'u përmendur është edhe shkrimi "Stina të qeta" e K. Tutulanit, që paraqitet si shtrim i linjave të një romani të ardhshëm.

Që prej vitit 1936, në kuadrin e luftës së Spanjës, rinia shqiptare dëshmoi shpirt lirisht dhe antifashist. Shumë të rinj u bashkuan në brigadat internacionaliste dhe një pjesë prej tyre ranë në betejat e zhvilluara atje. Një prej të rinjve pjesëmarrës është dhe Petro Marko, i cili në ato vite ishte vetëm një poet i ri. Pas kthimit në Shqipëri, ai vijon aktivitetin letrar antifashist. Në vitin 1940 ndalohet dhe burgoset në burgun e Tiranës nga fashistët. Në qelitë e këtij burgu shkroi poemën "*Horizonti në kuletë*" dhe poezitë "*Parada e të urtëve*", "*Flamuri i kuq*", etj. Këto krijime janë botuar në shtypin e kohës, ndërsa më vonë janë përfshirë në ribotimin e vëllimit "Horizont", në Prishtinë, në vitin 1972, nga Shtëpia Botuese "Rilindja".

Autorë të tjerë që kaluan muaj të tërë në burgim janë: Shevqet Musaraj, Dhimitër Shuteriqi, Esad Mekuli, Kolë Jakova. Në rrethana burgu u shkrua dhe kompozua melodia e këngës "Tre heronjtë e Shkodrës" i autorit Kolë Jakova, burgosur në Shkodër dhe Tepelenë. Vjersha-këngë u kushtojë dëshmorëve Jordan Misja, Branko Kadia dhe Perlat Rexhepi, që ranë heroikisht duke luftuar me italianët në Qershor të vitit 1942. Në vitin 1942, Esad Mekuli burgoset në kullën e Sheremetit në Pejë të Kosovës dhe shkruan vjershën "Kushtrimi". Poezitë përhapen nëpërmjet zinxhirit gojor të komunikimit. Përmbajtja e poezive është antifashiste në mbrojtje të lirisë. Vargjet përshkruhen nga fryma epiko-heroike, revolta popullore dhe ëndërra për një Shqipëri të lirë. Një pjesë poezish krijohen nëpër kampe përqëndrimi apo dhe në liri si: Fatmir Gjata, Andrea Varfi, Qamil Buzheli, Shevqet Musaraj në Shqipëri dhe Esad Mekuli, Mark Krasniqi, Ivzi Sulejmani e Tahir Jaha në Kosovë.

Në ditët tona, vjershat e tipit "Malet me blerim mbuluar", humbën përfundimisht autorësinë dhe emërtohen thjesht si këngë partizane. Ky fakt trajtohet nga Ismail Kadare në parathënien që ai i ka bërë librit të Shefqet Peçit "Udhët hedhin valle". Në këtë krijimtari poetike, autorët e burgosur sjellin frymëzimin individual të tyre që përshkohet nga atdhedashuria dhe sakrificat. Poetët e luftës, të burgosur apo jo shmangin vetveten nga krijimet e tyre. Vetvetja identifikohet me të përgjithshmen. Vjershëtori, duke shprehur qëndrimin ndaj fashizmit, trumbeton njëherazi idealet politike, sociale të kolektivitetit të tij. Kështu, një këngë e krijuar në ato vite në veri të Shqipërisë, transformohej me shpejtësi në një variant estetik

në trevat jugore p.sh: Kënga “Tre heronjtë e Shkodrës”, siç dëshmon edhe vetë autori, u këndua labçe në trevat e Tepelenës.

Në këtë periudhë figurë aktive e letërsisë revolucionare ishte dhe Sh. Musaraj, i cili dha një kontribut të çmuar për themelimin dhe afirmimin e saj. Gjatë luftës, përveç aktivitetit të gjerë publicistik që zhvilloi ai shkroi një tog vjershash me motiv patriotik e satirik. Krijimi i tij në fushën e poezisë është pamfleti në vargje “Epopeja e Ballit Kombëtar”, 1944. Kjo vepër lindi nga problemet politike të kohës dhe pati rëndësi të madhe aktuale. Fillimisht, poema shpërndahet ilegalisht në fletë të shaptilografuara dhe vetëm pas çlirimit botohet e plotë në veprën e Shevqet Musarajt. Poema “Epopeja e Ballit Kombëtar”, është krijim letrar satirik lindur në kushte të caktuara politiko-shoqërore. Në rrafshin historik, ajo pasqyron mosmarrëveshjet ideologjike e pragmatiste të dy blloqeve të mëdha politike, që vepronin në Shqipëri gjatë Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare: PKSH dhe Ballit Kombëtar. Kontradiktat mes tyre lidheshin me koncepte të ndryshme ndaj pushtuesve dhe luftës kundër tyre. Në aspektin praktik, poema është një mjet i fuqishëm propagandistik i përdorur nga komunistët me qëllim. Duke satirizuar ballistët, ata kërkonin të fitonin simpati në popull. Kështu, poema cilësohet polemike, satiriko-politike mes dy koncepteve kundërshtare, komunistëve dhe ballistëve. Ajo është poemë e tipit satirë. Është e gjatë, ndahet në tri pjesë dhe përmban fakte, portrete dhe ballafaqime. Poema kapet lehtë nga lexuesi dhe mësohet lehtë përmendësh. Poema ka tre momente: kapitullimin e Italisë fashiste, ardhjen e ushtrisë gjermane, muajt e fundit të luftës. Poema organizon dy pozicione ideologjike që përfaqësohen nga autori dhe Daj Ceni, i cili simbolizon popullin në një anë dhe përfaqësuesit e Ballit Kombëtar në anën tjetër. Pozicioni i krerëve të Ballit, improvizohet nga autori në trajtën e vetdeklarimit sipas parimit “parodi”. Poema është thurur bukur dhe është pëlqyer nga lexuesit e asaj kohe.

Temën e poemës Sh. Musaraj e kishte trajtuar dhe në pamfletin politik “Dje dhe sot”. Por, dilte nevoja për një vepër, që ta bënte këtë gjë në një formë më tërheqëse dhe të kuptueshme, lypsej një vepër letrare, që të mund të kapej dhe të mësohej lehtë prej masës së lexuesve e lidhur me lëvizjen dhe sidomos prej të rinjve. Për këtë qëllim, drejtuesit e organizatës së rinisë iu drejtuan Sh. Musarajt, i cili në atë kohë qëndronte ilegal në Tiranë, me lutjen që t’u shkruante, siç e thotë poeti në kujtimet e veta “një vjershë humoristike, që

të vinte në lojë Ballin Kombëtar”. Kështu lindi ”Epopeja e Ballit Kombëtar”.Vepra nuk ka ndonjë subjekt të lidhur. Idenë e vet poeti e zbulon, duke treguar historinë e Ballit Kombëtar, thelbin e fjalëve dhe të veprave të tij, që nga kapitullimi i Italisë dhe ardhja e pushtuesve gjermano-nazistë e deri në pragun e çlirimit të vendit prej ushtrisë nacionalçlirimtare. Themelin e veprës e formojnë disa episode dhe skena, që lidhen në mes tyre pjesërisht logjikisht e pjesërisht nga ana kronologjike. Për punët e ballistëve në këtë periudhë autori rrëfen me një ton të hollë ironik. Ballistët janë paraqitur në formë karikature.Me imtësira satirike poeti dha hutimin dhe pështjellimin që i kapi ballistët në çastin kur ra Musolini dhe u dukën të qarta shenjat e kapitullimit të Italisë.Të alarmuar nga rrokullisja e papritur e ngjarjeve, që u prishi planet, ballistët turren të shpëtojnë nga katastrofa që u kanoset si bashkëpunëtorë të italianëve dhe të ruajnë atë prestigj të pakët që u ka mbetur: *“U mbyt gjemija me federalë,/O burra, shpejto,/Kush mund të dalë”*. Me kapitullimin e Italisë dilte çështja e pushtetit.Balli Kombëtar, qysh në fillim kur u formua, pati si objektiv kryesor të mos lërë popullin që të vijë në fuqi. Në situatën e re që u krijua, ballistët marrin masat për të shtënë në duart e tyre drejtimin e vendit. Për këtë qëllim ata çirren poshtë e përpjetë se janë patriotë, se gjithnjë kanë luftuar për Shqipërinë dhe, për t’i mbushur mendjen botës, kurdisën së fundi edhe “vajtjen në mal”. Duke parodizuar me mjeshtëri tonin emfatik dhe frazat e bukura pseudopatriotike të krerëve të Ballit Kombëtar, poeti ka arritur fort bukur të vërë në lojë falsitetin e parrullave të ballistëve, demagogjinë e tyre: *“Flet Ali beu luft’për atdhenë !/ Se sot Atdheu pret shumë nga ne./Na vlon ndër deje gjak shqipëtari,/ s’durojmë kurrë zgjedhë barbari.* (Musaraj, 1948: 5) Efekti satirik në pjesën e parë të veprës krijohet përmes imtësirave dhe skenave të goditura satirike. Shkrimtari tregon se ballistët, që mundohen ta paraqesin veten si forcën politike, që historia i ka caktuar të shpëtojnë fatet e Shqipërisë, s’janë veçse llafazanë, që dinë vetëm të mbajnë fjalime bombastike dhe fare të paafte për veprime konkrete në dobi të Shqipërisë. Por ballistët s’arritën t’i bindnin njerëzit. Pasi populli u ktheu shpinën, krerët e Ballit i kap tërbimi dhe janë gati të bëjnë çdo gjë, madje jo vetëm t’u japin Shqipërinë të huajve, por edhe ta kthejnë në gërmadhë, vetëm populli të mos fitojë.

“Epopeja e Ballit Kombëtar” është ngritur mbi themelet e humorit të popullit

të thjeshtë. Veprat, sjelljen dhe planet e ballistëve, poeti i stigmatizon duke përdorur gjërësisht shprehjet humoristike popullore dhe proverbat. Sapo doli në dritë, "Epopeja e Ballit Kombëtar", u bë shpejt e njohur ndër të rinjtë antifashistë dhe partizanët. Vepra u shtyp me tipografi në 2500 kopje dhe brenda pak kohe qarkulloi në mijëra kopje të tjera, të shtypura me çiklostil, me makinë daktilografike, madje dhe me dorë. E thurur si alternim i fjalimeve të krerëve të Ballit Kombëtar me rrëfimin e autorit dhe ndërhyrjet e Dajë Cenit, ajo mësohej përmendsh dhe dramatizohej e luhej si skeç në mbledhjet e popullit dhe në çetat partizane.

Gjatë lëvizjes nacionalçlirimtare përhapje të madhe morën dhe këngët revolucionare. Kënga që forma poetike më e përshtatshme për të pasqyruar entuziazmin patriotik që rrëmbeu popullin në këto vite. Në këngën partizane gjeti shkrimin zemërimi popullor kundër fashizmit italian. Këngët i kënduan sakrificës supreme të komunistëve dhe të partizanëve për çlirimin e Shqipërisë. Ato shprehën gëzimin e përgjithshëm për hovin e madh që mori lufta me formimin e brigadave dhe të divizioneve të ushtrisë Nacionalçlirimtare (Bihiku, 1979: 67)

Rëndësia e këngëve nuk kufizohet vetëm me ndikimin e madh edukativ që ushtruan tek njerëzit, duke i përgatitur ata shpirtërisht për përlëshjen e afërt me pushtuesit e huaj. Ato luajtën një rol të madh edhe si modele të një letërsie të re në shërbim të njerëzve. Shpejt, në shembullin e tyre dolën një varg këngësh origjinale me përmbajtje revolucionare, të cilat u përhapën e u kënduan nga populli dhe veçanërisht prej të rinjve. Mjaft popullore u bënë sidomos këngët e F.Gjatës, i cili erdhi në letërsi në këto vite. Në "Kushtrimi", "Kënga e rinisë", "Hakmarrje", "Plaku dhe i riu", "Ato maja rripa-rripa", "Kudo malet buçasin", poeti i ri transmetoi romantikën e luftës çlirimtare, vrullin e ndjenjave që mbushnin zemrat e të rinjve antifashistë, në ato çaste të rëndësishme, kur populli ishte në luftë me armiqtë e vet. Te kënga "Kushtrimi i lirisë" mbizotëron toni epik. Autori flet për entuziazmin luftarak që ka përfshirë të gjithë vendin. Punëtorët dhe të rinjtë kanë hedhur armët supeve e kanë marrë malin. Çdo patriot i vërtetë, - thotë poeti, - duhet t'i përgjigjet detyrës karshi atdheut: *"La parmëndën sot fshatari, /S'mbeti burrë në shtëpi, /Kush ka zemër shqiptari, /Del sot malit për liri./ Zëri i pushkës me furi, /Po buçet sot anembanë"*.

Shpejt në shembullin e tyre dolën një varg këngësh origjinale me përmbajtje revolucionare, të cilat u përhapën e u kënduan nga populli dhe veçanërisht prej të rinjve. Me përhapjen dhe forcimin e lëvizjes partizane lindin këngë të reja, të cilat sollën me vete atmosferën luftarake të kohës, dashurinë e madhe të partizanëve dhe të rinjve për popullin, besnikërinë e tyre të palëkundshme ndaj idealit që i kanë kushtuar jetën ("Shqiponjat partizane" të K.Jakovës, "Kushtrimi", "Buçasinin mallet si gjësim", "Partizani n'luftë po shkonte", "Luft'e lirisë na thërret", "Malli i nënës", "O ju të rinj edhe të reja", "Mjaft në robëri", "Shoqes" etj). Lufta kundër pushtuesve të huaj që e rëndë, plot vështirësi dhe sakrifica. Spiunët dhe mercenarët e shitur tek fashistët ndiqnin këmba - këmbës luftëtarët e lirisë; shumë të rinj u burgosën ose u vranë; të tjerë ranë në përpjekje me armiqtë në qytete dhe në male. Duke u nisur nga raste a ndodhi konkrete, poetët iu drejtuan figurës së komunistit, të partizanit dhe njeriut të popullit, që dhanë jetën në emër të idesë së çlirimit të atdheut. (Bihiku, 1979 : 69)

Bashkëluftëtarët betohen se do të marrin hak pa mëshirë mbi armiqtë dhe do ta çojnë në vend amanetin e dëshmorëve. Ndër këto këngë, më të përmendura ishin: "Kanga e tre heronjve të Shkodrës" e K. Jakovës, "Kënga e Asim Zenelit" e Q. Buxhelit, "Dëshmorëve të kombit" e A. Varfit, "Dalëngadalë po vjen behari", "Nëna", "Ku e kam vajzën, ku e kam djalin", "Shokut Qemal Stafa", "Kënga e Mine Pezës", etj. Në "Kangën e tre herojve të Shkodrës" u pasqyrua fryma heroike e Luftës Nacionalçlirimtare, trimëria dhe burrëria, që komunistët treguan në luftë kundër fashistëve. Këngën e vet, K. Jakova e thuri, duke marrë mjetet teknike prej gurrës popullore. "Kanga e tre herojve të Shkodrës" ka huajtur shumë prej poetikës së rapsodive. Sikurse në këngët epike legjendare edhe në të elementet e përshkrimit dhe të rrëfimit janë reduktuar në minimum. Veprimi zhvillohet shkurt, dialogu zë vendin kryesor në këngë dhe shërben si mjet për t'u njohur me personazhet. Heronjtë na shfaqen nëpërmjet fjalëve që ata mbajnë, kur marrin vesh se ishin të rrethuar dhe e kuptuan se kishte ardhur çasti më i rëndësishëm i jetës së tyre. Me pamjen e tyre të patrembur dhe konceptin burror të jetës, tre heronjtë na kujtojnë kreshnikët e këngëve legjendare popullore. Komunistët s'e bëjnë veten para vdekjes, që ka hedhur hijen e saj mbi shtëpinë, ku janë rrethuar: "Ç'ka po thot' Kadija: - Flak le t'kallet shpija, /Ta marr vesh Shqipnija se na i dalim zot./Ç'ka po

thot'Perlati: - Burra, bahi gati, se ka ardh sahati,/t 'hujit me i dhanë barot".
(Bihiku, 1979: 70)

Me zgjerimin e luftës së armatosur kundër fashistëve dhe formimin e brigadave e të divizioneve të para dolën hymnet dhe marshet partizane:”Hymni i Ushtrisë Nacionalçlirimtare” i A.Varfit, “Marshi i Divizionit I S”, të Sh. Musarajt, “Marshi i Brigadës I S”, i Mehmet Shehut,etj.) Marshet dhe himnet partizane janë të mbushura me vrullin luftarak që karakterizonte ato vite mendjen, ndjenjat dhe optimizmin e popullit, me sigurinë në çlirimin e afërt të atdheut. Në përputhje me këtë janë intonacionet energjike, leksiku me frymë patetike-heroike dhe ritmi i tyre plot vrull dhe forcë.

Literatura:

Bihiku, K., *Probleme letrare*, Tiranë,1979.

Bulo, J., *Tradita dhe risi letrare*, Tiranë. 1981

Jorgaqi, N., *Antologji e poezisë lirike shqipe midis dy Luftërave*, Uegen, Tiranë, 2009.

Musaraj Sh.; *Epopeja e Ballit Kombëtar*, Tiranë, 1948.

Shuteriqi, Dh., *Marin Biçikemi dhe shkrime të tjera*,Tiranë,1987.

Vozga. R., *Thellësitë e fjalës*,Tiranë, 1983.

Zisi, R., *Letërsia bashkëkohore shqiptare:Poezia*,Tiranë 2008

Xhiku, A., *Letërsia shqiptare si polifoni*,Tiranë, 2004.

Historia e letërsisë shqipe, (Materialet e konferencës shkencore 30-31 Tetor, 2009), Prishtinë, 2010.

Historia e letërsisë shqipe, Tiranë, 1983

Letërsia si e tillë, Tiranë, 1996.

**KOHA DHE KUJTESA NË LETËRSINË E DRITËRO AGOLLIT
“KOMISARI MEMO MBI NGREHINAT E LUFTËS SË DYTË
BOTËRORE”**

Prof. as. dr. Eris RUSI

*Departamenti i Gjuhës dhe i Letërsisë
Universiteti “Fan S. Noli”*

Abstrakt

Ky punim synon të eksplorojë temën e kohës dhe kujtesës në letërsinë e Dritëro Agollit, duke u përqendruar veçanërisht në romanin "Komisari Memo". Përmes këtij studimi, synohet të theksohet rëndësia e veprës së Agollit në letërsinë shqiptare dhe ndikimi i saj në ndërgjegjësimin historik të lexuesve. Gjithashtu, do të shqyrtohet se si elementi i kohës dhe kujtesës kontribuon në ndërtimin e narrativës dhe karaktereve, duke ofruar një pasqyrë të hollësishme të përvojave të popullit shqiptar gjatë një periudhe të trazuar historike si ajo e Luftës së Dytë Botërore. Brenda kësaj kornize, romani “Komisari Memo” do të trajtohet si një vepër ku energjia dhe forca intelektuale shpalosen nga autori i cili përdor strukturën narrative të kohës lineare dhe jo-lineare për të përcjellë me stil marrëdhënien e individit me rrethanat historike me të cilat duhet të përballet në jetë. Letërsia ndihmon të krijohet një urë komunikimi midis së sotmes dhe të djeshmes historike, e trajtimi i ngjarjeve me rëndësi në jetën e një kombi bëhet i prekshëm dhe merr jetë falë ndërvëprimit të personazheve që përcjellin njëherësh ndjesitë dhe qëndrimin e autorit.

Fjalë çelës: *koha lineare, kujtesa, rrethana historike, analizë teksti, realizëm.*

Hyrje

Letërsia ka qenë gjithmonë pasqyrë e shpirtit të një kombi, një mjet thelbësor

për të ushqyer kujtesën kolektive dhe për të forcuar identitetin kombëtar. Ajo funksionon si një urë lidhëse mes të kaluarës dhe së ardhmes, duke ruajtur historitë, përvojat dhe emocionet që formësojnë shpirtin e një populli. Letërsia, në çdo kohë dhe vend, është më shumë se një akt krijimi; ajo është një pasqyrë e shpirtit, mendjes dhe emocioneve të një kombi. Përmes fjalës së shkruar, një shkrimtar sjell në jetë jo vetëm historinë dhe realitetin e një kohe, por gjithashtu idetë, ndjesitë dhe aspiratat që tejkalojnë kohën. Në këtë mënyrë, letërsia bëhet një urë e fuqishme që lidh të kaluarën me të tashmen dhe të ardhmen, duke e bërë të prekshme jo vetëm anën intelektuale dhe shpirtërore të një shoqërie, por edhe atë njerëzore dhe universale. Në letërsinë shqiptare, Dritëro Agolli përfaqëson një nga zërat më të fuqishëm dhe më origjinalë mes autorëve të shek. XX. Natyra e tij e ngrohtë, e dashur dhe humane e ka bërë lexuesin të ndihet i lidhur ngushtë me veprën e tij. Agolli nuk ishte thjesht një shkrimtar që dokumentonte ngjarje apo përshkruante ndodhi; ai ishte një krijues që dhuronte jetë përmes fjalës. Përmes humorit, dashurisë dhe shtresëzimit njerëzor, veprat e tij kanë arritur të prekin zemrat e lexuesve, duke i bërë ata të qeshin, të qajnë dhe të reflektojnë. Por edhe sikur personaliteti i tij të ishte ndryshe, madje i ashpër apo indiferent, letërsia e tij do të mbetej po aq e madhe.

Agolli shquhej për aftësinë për të përmbledhur emocionet dhe përvojat njerëzore në një stil që ishte i thjeshtë, por i thellë. Ai u përpoq gjithnjë të tregonte se njeriu nuk jeton vetëm për të mbijetuar, por për të ëndërruar, për të krijuar dhe për të lënë një gjurmë që koha nuk mund ta zhdukë. Letërsia e tij, siç e shprehte shpesh vetë Agolli, ishte një mundësi për njerëzit që të lidhen me njëri-tjetrin përmes fjalës dhe emocionit. Kjo është arsyeja pse krijimtaria e tij ka një natyrë magnetike dhe universale, duke e bërë të prekshme jo vetëm për lexuesit shqiptarë, por edhe për ata evropianë dhe më gjerë. Nën këtë këndvështrim, letërsia ka qenë një hapësirë ku të gjitha ndjenjat gjejnë vend: gëzimi dhe trishtimi, dashuria dhe mërzia, humori dhe reflektimi. Ai i dha jetë veprës së tij letrare, duke i dhënë asaj një shpirt dhe një zë që vazhdon të rezonojë edhe pas vdekjes së tij. *“Dritëroi nuk jeton, por në veprat e tij gëzohet, jetohet, ka vend për mërzë e trishtim,”* është një pohim që përmbledh plotësisht natyrën e pavdekshme të krijimtarisë së tij.

Agolli vetë e konsideronte letërsinë si një domosdoshmëri të jetës, duke e krahasuar me ajrin, ujin dhe bukën. Në një thënie që përshkon gjithë filozofinë

e tij krijuese, ai shprehej: *“Letërsia, si çdo art tjetër, duhet t`u flasë zemrave dhe të bëhet e nevojshme si ajri, uji dhe buka.”* Kjo e bën krijimtarinë e tij jo thjesht një koleksion librash apo veprash, por një trashëgimi të gjallë që vazhdon të frymëzojë dhe të ushqejë shpirtin e lexuesve.

1. Profili krijues i Dritëro Agollit

Krijimtaria e Dritëro Agollit zë një vend të rëndësishëm në letërsinë shqiptare, duke qenë një pasqyrë e ndjenjave dhe përvojave të një kombi në shndërrim të vazhdueshëm. Përmasat dhe ndikimi i saj kalojnë përtej kufijve kombëtarë, duke i dhënë Agollit një vend të veçantë në kulturën dhe letërsinë evropiane. Ky autor jo vetëm që pasqyroi realitetin shqiptar, por arriti të përshkruante universalen, atë që prek dhe bashkon gjithë njerëzimin: luftën për dinjitet, dashurinë për vendin, dhe ndjeshmërinë ndaj dramave njerëzore.

Studiues dhe kritikë letrarë, si brenda ashtu edhe jashtë vendit, e kanë vlerësuar Agollin si një nga zërat më të fuqishëm dhe më të shumanshëm të letërsisë shqiptare. Ai është përmendur shpesh si një autor që kalon kufijtë e kohës dhe hapësirës, duke sjellë një letërsi që nuk është vetëm kombëtare, por edhe universale. Në shumë aspekte, krijimtaria e tij reflekton ndërthurjen e përvojave personale dhe kombëtare me temat e mëdha të humanizmit. Si shkrimtar, Agolli nuk kufizohej në rrëfimin e ndodhive apo përshkrimin e realitetit; në thelb, ai krijonte një botë ku ndjenjat dhe vlerat humane ndriçonin mbi gjithçka tjetër.

Agolli ishte i vetëdijshëm për rolin e tij si shkrimtar në ndërtimin e një ure mes Shqipërisë dhe botës. Letërsia e tij e pasqyron këtë përpjekje për të tejkaluar kufijtë dhe për të bërë të njohur atë që është unike për Shqipërinë, duke e lidhur atë me përvojat e përbashkëta njerëzore. Temat e trajtuara nga Agolli si: lufta për drejtësi, solidariteti dhe kërkimi për kuptimin e jetës, e bëjnë krijimtarinë e tij të prekshme për lexuesit e çdo kombësie. Ai nuk fliste vetëm për shqiptarët; ai fliste për njerëzit, për jetën dhe për aspiratat e tyre. Kjo përmasë universale e krijimtarisë së tij është ajo që i ka dhënë një vend të veçantë në kulturën evropiane. Agolli nuk ishte një shkrimtar lokalist; ai ishte një zë që rezononte përtej kufijve gjeografikë dhe politikë, duke sjellë në letërsinë botërore një pasuri tematike dhe një perspektivë të re, ndaj trashëgimia e tij letrare është një testament i gjallë i fuqisë së fjalës për të lidhur njerëzit dhe për të pasuruar jetën

e tyre.

2. Letërsia dhe kujtesa

Në kontekstin e letërsisë shqipe, binomi letërsi-kujtesë merr një rëndësi të veçantë gjatë gjysmës së dytë të shekullit XX, një periudhë e shënuar nga konflikte të mëdha historike dhe ndryshime të thella sociale dhe politike. Në këtë kohë, letërsia bëhet një mjet i fuqishëm për të dokumentuar dhe reflektuar përvojat e popullit shqiptar, duke përfshirë luftën për liri dhe çlirimin nga pushtuesit nazifashistë. Dritëro Agolli, një nga figurat më të rëndësishme të kulturës dhe letërsisë sonë, luan një rol kyç në këtë proces. I lindur më 13 tetor 1931 në fshatin Menkulas të Devollit, Agolli rritet në një mjedis të pasur kulturor dhe historik që do të ndikojë thellësisht në krijimtarinë e tij letrare. Përvoja gjatë Luftës së Dytë Botërore dhe përjetimet e mëvonshme nën regjimin komunist formësojnë perspektivën e tij të veçantë, duke e bërë atë një zë të rëndësishëm në letërsinë shqiptare. Agolli është i njohur për aftësinë e tij për të kombinuar realitetin historik me një stil letrar të pasur dhe të larmishëm, duke krijuar vepra që janë një reflektim i kohës dhe kujtesës kolektive të popullit shqiptar. "Komisari Memo" shënon fillimin e krijimtarisë letrare të tij në fundin e viteve '60, një vepër e ndërlidhur ngushtë me përvojat e tij personale si pjesëmarrës në Luftën Antifashiste dhe si gazetar. Frymëzimi për romanin buronte nga udhëtimet e tij në fshatra dhe qytete shqiptare, ku grumbulloi histori dhe detaje të pasura për jetën dhe luftën. Fillimisht, Agolli mendoi ta titullonte romanin "Ngritja", duke pasur si simbol bustin e bronzit të komisarit dhe ngritjen e tij në historinë pasluftës. Më vonë, e ndryshoi këtë titull në "I teti në bronz", përpara se të zgjidhte në fund titullin "Komisari Memo". Nga ky roman u botua fillimisht një pjesë në gazetën "Drita", që krijoi perceptim të mirë tek lexuesit dhe letrarët e kohës. Teksti, ndonëse i takonte rrymës realiste dhe përputhej me orientimin zyrtar të letërsisë së angazhuar, prapëseprapë përcillte ndjesi të reja, të përshkraura me nota lirizmi dhe humori që ishin karakteristike për stilin e Agollit. Studiuësja Klara Kodra, shprehet në lidhje me këtë aspekt:

"...Tematika dhe problematika, pra, ishin të njohura, ekzistonte një "hero pozitiv", një nga dy protagonistët, komisar Memo, madje ekzistonte një ndikim nga "Çapajevi" i letërsisë ruse sovjetike. Megjithatë, meqenëse siç thotë me të drejtë realisti i madh Flobër "forma e jashtme", 'manteli' i

realizmit socialist ishte mbushur me “shqepje”, përmes të cilave depërtonte forma e brendshme realiste.” (Kodra, 2016: f.3). Subjekti i romanit fokusohet në dy plane: e tashmja ku busti rrugëton bashkë me të afërmit e protagonistit të vrrarë në luftë, dhe e shkuara, ku rrëfihen në introspektivë ngjarjet kulmuese në jetën e komisarit Memo. Ky gërshetim, bën që rrëfimi të ndiqet me frymën pezull në të dy planet, duke mundësuar hapësira të ndryshme interpretimi për lexuesit. Vlen të theksohet që procesi krijues për shkrimin e librit, kalon nga kontakti i drejtpërdrejtë me atë që është dëshmia gojore e njerëzve që kishin përjetuar pasojat e luftës. Këto dëshmi filtrohet dhe më tej konkretizohen mbi një shtrat të idealizuar të figurës qendrore të romanit, Memo Kovaçit, i cili mishëron karakteristikat e njeriut të drejtë, pasionant, atdhetar, duke ruajtur edhe atë profil të kërkuar nga ideologjia e kohës. Ndoshta ky aspekt bën që kritika pas viteve '90 ta konsiderojë këtë vepër si: *“...model i romanit të realizmit socialist, me përmbajtje të shëndoshë politike, me vlera edukative. Komisari Memo Kovaçi, ashtu si mund të lexohet sot, përfaqëson figurën e komunistit, i parë me të gjitha atributet që i ka veshur vetes i riu komunist: pa qenë gjykatës, shqipton dënime konkrete për kundërshtarët të tij politikë; pa qenë përmbarues në kuptimin e parë të fjalës, sekuestron mallin e gjënë e dikujt tjetër; pa qenë veprimtar shoqatash bamirëse e ndan falas te të tjerët mallin që nuk ishte i tij.”* (Graçi, 2016: f.37).

Kjo qasje, nuk është larg të vërtetës, nisur nga kërkesat e kohës kur u shkrua vepra, frymës së përcjellë në tekst dhe tipizimit të personazheve. Megjithatë, Agolli eksploron temat e kohës dhe kujtesës me një ndjeshmëri të veçantë, duke paraqitur përpjekjet e shqiptarëve për liri dhe çlirimin nga pushtuesit nazifashistë në një mënyrë që nuk është vetëm historike, por edhe thellësisht njerëzore. Letërsia është mënyra jonë për të ruajtur kujtesën kolektive dhe për të reflektuar mbi të kaluarën për të kuptuar më mirë të ardhmen, ndaj kontributi letrar i Agollit me këtë roman thekson rolin e letërsisë në formësimin e ndërgjegjësimit historik dhe kulturor të një kombi. Ai ndërthur kohën lineare me elemente jo-lineare për të reflektuar mënyrën se si kujtesa personale dhe kolektive ndërthuren në ndërtimin e identitetit kombëtar. Përmes dialogut të gjallë dhe përshkrimeve të detajuara, Agolli krijon personazhe të gjalla dhe të besueshme që reflektojnë sfidat dhe triumfet e popullit shqiptar gjatë një periudhe të trazuar historike. Kjo qasje jo vetëm që thekson kompleksitetin e

kohës, por gjithashtu pasqyron ndikimin e thellë të kujtesës në formësimin e përvojave dhe marrëdhënieve ndërpersonale.

Në kujtimet e saj, bashkëshortja e shkrimtarit, Sadije Agolli hedh dritë mbi fazat e shkrimit dhe botimit të romanit "Komisari Memo", duke ofruar një perspektivë të afërt dhe intime mbi procesin krijues të bashkëshortit të saj. Ajo kujton një detaj të rëndësishëm nga bashkëpunimi i Dritëroit me mikun dhe kolegun e tij, Jakov Xoxa, i cili ka qenë recenzent dhe redaktor i këtij romani. Kujtimet e Sadijes zbulojnë një episod thelbësor të diskutimit mbi strukturën narrative të veprës. Në një intervistë për gazetën "Telegraf", (14.09.2019) Sadije Agolli përmend këshillën që Jakov Xoxa i dha Dritëroit: ai sugjeroi të shmangej ndarja e ngjarjes në kapituj të bazuar në kujtimet e personazheve të tjerë dhe të lejohej narracioni të rridhte organikisht. Sipas Xoxës, ishte e rëndësishme që Memon, personazhi kryesor, të përjetonte fatin e tij në mënyrë lineare dhe që historia e tij të ruante autenticitetin dhe dinamizmin. *"Lëre Memon të vritet si komisar në betejë,"* i sugjeroi Xoxa për fatin e protagonistit të romanit, duke theksuar që forca narrative qëndronte në natyrën e paprerë të ngjarjeve dhe në jetën e personazheve si protagonistë të drejtpërdrejtë të historisë. Këto kujtime hedhin dritë mbi bashkëpunimin intelektual dhe profesional mes Agollit dhe Jakov Xoxës, dy prej figurave më të shquara të letërsisë shqiptare. Kjo qasje, reflekton një perceptim të hollë mbi strukturën dhe rrjedhshmërinë narrative, një element i rëndësishëm në letërsinë e çdo kohe. Personazhet duhet të jetojnë dhe të zhvillohen në mënyrë të pavarur brenda strukturës së veprës, duke ruajtur integritetin dhe koherencën e tyre si figura letrare, e për rrjedhojë edhe narrativa e rrëfimit është një rrjedhë organike, ku personazhet janë bartës të ngjarjeve, dhe jo thjesht mjete për të përçuar një ide. Agolli e kuptonte se fuqia e një veprë letrare qëndron në aftësinë e saj për të ndërtuar një botë ku lexuesi mund të përfshihet plotësisht, pa u ndërprerë nga teknika të imponuara që mund të zvogëlojnë ndikimin emocional dhe estetik. Përmes këtyre filtrave, romani "Komisari Memo" mbetet një dëshmi e balancës së suksesshme midis narracionit historik dhe realizmit emocional, duke kontribuar në ndërgjegjësimin kulturor dhe letrar të Shqipërisë.

3. Rindërtimi letrar i së shkuarës

Ndoshta asnjë shkrimtar tjetër nuk ka qenë i lidhur kaq fort me tokën dhe

identitetin tonë kombëtar sa Dritëro Agolli. Devolli nuk ishte vetëm vendlindja e tij, por edhe burimi i frymëzimit të tij më të thellë, nga ku shpërthente një pasuri e madhe shpirtërore e njerëzore që e përshkonte gjithë letërsinë e tij. Megjithatë, përtej kësaj lidhjeje të fuqishme me tokën dhe vendin, Dritëroi është shndërruar në një simbol të letërsisë shqiptare, sepse ka ditur të mishërojë shpirtin dhe ndjesitë e përbashkëta të çdo shqiptari. Me një thjeshtësi të rrallë dhe një ndjeshmëri të thellë, ai ka depërtuar në thelbin e përjetimeve universale, duke u bërë një nga shkrimtarët më të dashur dhe të rëndësishëm të letërsisë sonë kombëtare. Misioni i tij si shkrimtar ka qenë shprehja e botës shpirtërore të njeriut përmes përdorimit të gjuhës.

Romani "Komisari Memo" sjell një rrëfim të fuqishëm mbi periudhën e Luftës së Dytë Botërore, duke pasqyruar jo vetëm përballjen e popullit shqiptar me pushtuesit nazistë, por edhe një tjetër front të heshtur e të brendshëm – atë të përçarjes vëllavrasëse ndërmjet partizanëve dhe ballistëve. Skenat e konfliktit janë të gjalla, dhe lexuesi përfshihet në atmosferën e betejave, përplasjeve dhe sakrificave që përcjellin fuqishëm jo vetëm pamjet e jashtme të luftës, por edhe botën e brendshme, të pasur shpirtërore të protagonistit dhe personazheve të tjera kryesore. Letërsia, në këtë kontekst, bëhet dëshmitare e epokave, duke ruajtur përjetimet e njerëzve për të ardhmen. Ajo arrin të bëjë më shumë sesa librat e historisë, pasi ajo mban gjallë anën emocionale të një konflikti që në dokumentet historike duket i ftohtë dhe i largët.

Ndërsa historia rrëfen faktet, letërsia ndriçon të vërtetat emocionale, njerëzore, duke i dhënë lexuesit mundësinë të ndiejë jo vetëm ideologjinë e epokës, por edhe pasionin, këmbënguljen dhe vetmohimin e atyre të rinjve që, në moshën më të bukur të jetës, rrëmbyen armët për të luftuar pushtuesit e huaj. Romani "Komisari Memo" sjell një pasqyrë të rëndësishme të momenteve kyçe historike për kombin shqiptar, duke u ndalur njëkohësisht te problematika e identitetit kombëtar. Kjo çështje e ndërlikuar dhe shpeshherë e vështirë për t'u adresuar, duket se na rikujton idenë se nacionalizmi luan një rol të veçantë në shoqërinë moderne, një perspektivë që Lukas e formulon si: "*Nacionalizmi është e vetmja fe e kohës sonë*" (Lukas, 2002:23). Në këtë prizëm, Dritëro Agolli, përmes krijimtarisë së tij narrative, arrin të ndërtojë karaktere të fuqishme dhe mjedise që reflektojnë qartë gjurmët e kohës dhe ngjarjeve historike. Studiuesi Shaban Sinani e përshkruan këtë veti të veçantë të Agollit, duke theksuar: "*Dritëro*

Agolli, me prozën e tij, ka krijuar karaktere dhe mjedise që bartin gjurmën e historisë” (Sinani, 2011:271). Në këtë mënyrë, romani bëhet jo vetëm një rrëfim i thellë letrar, por edhe një udhërrëfyes për të kuptuar sfidat dhe përvojat që kanë formësuar vetëdijen kombëtare. Mbi këtë kontekst, mund të themi që letërsia ndihmon të ripërpunohet e shkuara. Shkrimtari këmbëngul që të shndërrojë kujtimet e së djeshmes, në diçka të gjallë që bëhet e prekshme dhe ka ndikim të drejtpërdrejtë tek jeta e njerëzve në bashkëkohësi. Në këtë mënyrë, vetë përvoja individuale e personazheve, shndërrohet në kujtesën kolektive të lexuesit, i cili ngjan sikur i ka jetuar dhe i ka rrekur nga afër ngjarjet e rrëfyera në libër. Bëhet fjalë për një iluzion, për një kapërcim të mureve të kohës dhe hapësirës dhe kurdoherë që letërsia merret me narracionin e lumit të kohës, atëherë ngjan më tinëzare, më e ashpër, e hidhur, ironike, halucinante: akti i kujtesës është një akt i nevojshëm në shoqërinë tonë.

Ligjërimin e romanit ”Komisari Memo”, e formojnë një varg ngjarjesh të cilat na vijnë njëra pas tjetrës si një zinxhir kujtimesh që u zgjon bashkëlufëtareve të afërt të komisarit udhëtimi i bustit për në fshat. Shfrytëzimi nga ana e autorit i digresionit në formën e kujtimeve i ka dhënë rrëfimit një karakter më intim dhe më emocional, kjo ka bërë që ideja e aktualitetit të trashëgimit shpirtëror të epokës së luftës të tingëllojë në mënyrë më të natyrshme. Në roman problemi i vlerave morale gjatë luftës nuk shihet në plane filozofike, por traditat heroike të kësaj kohe pasqyrohen drejtpërdrejtë si diçka e gjallë e mishëruar në karaktere e situata konkrete. “*Autori pohon idenë se këto tradita janë të pavdekshme, se ato veprojnë në jetën tonë si një forcë aktive dhe jo vetëm një kujtim i së kaluarës*” (Bulo 1982:223). Është një roman, i cili, pavarësisht kohës se kur u shkrua dhe rrymës letrare që ndoqi, të mbetet në mendje. Personazhet vijnë të skalitura, bëhen të prekshme dhe krijojnë një lidhje të fortë me lexuesit që ka mundësi t’i përfytyrojë, t’i ndiejë e t’i ndjekë hap pas hapi në gërshetimin e ngjarjeve.

Nga ana ideomatike, ky roman vë në peshore edhe atdhedashurinë me ndjenjën intime të dashurisë, ku mbizotëron e para, sepse në kohë lufte atdheu është familja jonë, gjithçka që kemi. E kjo frymë që përcillet në libër, nuk vjen nën petkun e demagogjisë, as nuk tingëllon si e sforcuar apo e nxitur nga ideologjia e kohës, përkundrazi përcjell botëkuptimin real të autorit, qëndrimin autentik të tij. Skena përmbyllëse e librit vjen me një lirizim që të prek, të pikëllon, por

edhe të bën të vlerësosh forcën krijuese të autorit:

“ Nga maja e kodrës tjetër doli hëna dhe ra mbi supin e bustit. Njerëzit zbrisnin nga rrugicat e fshatit dhe venin e vështronin Memon. Ata ishin shumë, burra, gra, djem e vajza të reja, pleq të kërrusur të mbështetur në shkopinj, fëmijë...

- Është Memoja, - thoshin ata.

Atëherë plaku tha:

- Le të qëndrojë Memoja, këtu!

Dhe qëndroi busti i bronzit në gurin e madh...” (Agolli, 1981: 302)

Ky pasazh përmblylës përfaqëson kulmin emocional dhe simbolik të veprës, duke sintetizuar temat kryesore të romanit: atdhedashurinë, sakrificën dhe përjetësimin e kujtesës. Në këtë pjesë, Dritëro Agolli e përfundon rrëfimin me një skenë që është njëkohësisht lirike dhe prekëse, duke i dhënë lexuesit një moment reflektimi të thellë mbi vlerat njerëzore dhe rëndësinë e ruajtjes së tyre në kujtesën kolektive. Busti i Memos, i ngritur mbi një gur të madh, nuk është vetëm një monument fizik, por një simbol i pavdekësisë dhe qëndrueshmërisë së vlerave që ai përfaqëson. Përshkrimi i hënës që bie mbi bust dhe prania e popullit që mblidhet rreth tij krijojnë një atmosferë të qetë dhe reflektuese, duke e kthyer këtë skenë në një kulm emocional që prek zemrën e lexuesit. Përmes këtij imazhi, Agolli nënvizon rëndësinë e unitetit dhe mirënjohjes kolektive që populli shqiptar ndjen për ata që sakrifikuan për lirinë e tij. Fjalët e plakut, *“Le të qëndrojë Memoja, këtu!”*, janë kulmi emocional i skenës dhe një shprehje e fortë e përjetësisë së kujtesës kolektive. Në këtë moment, busti nuk është më thjesht një objekt bronzi; ai përfaqëson frymën dhe sakrificën e Memos, një përkujtim i gjallë i një heroi që bëri gjithçka për atdheun. Populli që mblidhet rreth bustit përfaqëson të gjitha gjeneratat dhe shtresat shoqërore, duke dëshmuar unitetin dhe rëndësinë e kujtesës kolektive. Figura e Memos bëhet simbol i asaj që është më e mira në natyrën njerëzore: përkushtimi, sakrifika dhe dashuria për diçka më të madhe se vetja.

Përfundime

Duke u mbështetur në ngjarjet e Luftës së Dytë Botërore, Dritëro Agolli arrin të sjellë në dritë kujtimet e një kohe të vështirë, duke i kthyer ato në diçka të gjallë, që ndikon dhe formëson jetën e protagonistëve të sotëm. Kujtesa e asaj periudhe

nuk mbetet thjesht një kapitull historik, por ajo gjallërohet, prek dhe përjetësohet. Ligjërimi i Agollit përmban një galeri njerëzish e karakteresh, që e bëjnë më të lehtë këtë përballje të vështirë për letërsinë e re shqipe në tërësinë e saj. Te romani "Komisari Memo", njeriu është epiqendra dhe forca lëvizëse e rrëfimit, duke mishëruar jo vetëm emocionet dhe përvojat individuale, por edhe shpirtin e një kohe të mbushur me sfida dhe transformime. Kjo vepër e Dritëro Agollit vë në qendër fuqinë e karakterit njerëzor si themelin e përballjes me kundërshtitë dhe kompleksitetin e botës, duke e bërë atë elementin më të fuqishëm dhe më të vërtetë të saj. Ky roman na fton të kalojmë muret e kohës dhe të përjetojmë eksperiencën e tronditëse të luftës dhe të kujtesës. Kjo lidhje mes të kaluarës dhe së tashmes është thelbi i veprës së Agollit, i cili me mjeshtërinë e tij artistike krijon një lidhje të qëndrueshme mes lexuesit dhe historisë kombëtare. Me romanin "Komisari Memo", ai pohoi qëndrimin e tij për të kaluarën dhe të tashmen, duke ndriçuar lidhjen e pashkëputur mes tyre. Koha në këtë vepër shpalolet në dy nivele: **e kaluara**, që përfaqëson ngjarjet e luftës dhe sakrificat e personazheve; **e tashmja**, që pasqyron përpjekjet e popullit për të mos harruar dhe për të nderuar këto sakrifica. Përmes përdorimit të kujtesës, autori krijon një dialog të vazhdueshëm mes këtyre dy planeve, duke i kthyer ngjarjet e së kaluarës në një burim frymëzimi dhe mësimi për të ardhmen. Kujtesa nuk është thjesht një dëshmi e ftohtë, por një përvojë e gjallë dhe emocionale, e cila ndikon thellësisht në formësimin e identitetit kombëtar dhe kulturor.

Dritëro Agolli përdor mjeshtërisht gjuhën për të krijuar një ndërlidhje organike mes të kaluarës dhe së tashmes. Përmes personazheve të tij, ai na kujton se heronjtë dhe vlerat e tyre nuk mbeten të ngrira në histori; ato jetojnë në kujtesën dhe zemrat e njerëzve që vazhdojnë t'i nderojnë dhe t'i respektojnë. Ky është një mesazh i fuqishëm që thekson se popujt mbijetojnë dhe përparojnë vetëm nëse ruajnë lidhjen e tyre me të kaluarën dhe mësimet që ajo ofron. Ndaj romani "Komisari Memo" është dëshmi se e kaluara mbijeton përmes kujtesës, e lidhur përjetësisht me shpirtin e së tashmes. Madje, më shumë se kaq, e kaluara dhe heronjtë e saj janë të pavdekshëm, sepse ata të tillë rrojnë në kujtesën e popullit. E përfshirë në kornizën e letërsisë, historia nuk mbetet një kujtim i largët, që sfumohet pashmangshmërisht nga rrjedha e viteve; ajo është dëshmi, përjetim i fuqishëm që përçon në çdo kohë ndjenjat, vlerat dhe sakrificat e atyre që dhanë

gjithçka për lirinë dhe identitetin tonë kombëtar.

Bibliografi:

1. Agolli, Dritëro. (1981). *Komisari Memo*. Tiranë: Shtëpia Botuese Naim Frashëri.
2. Sinani, Shaban. (2011). “Dritëro Agolli dhe fuqia e kujtesës në letërsi.” Studime Shqiptare 3: 267–271.
3. Aliu, Ali. (1990). *Ese letrare*, Tiranë: Naim Frashëri,.
4. Bullo, J. (1982). *Romani shqiptar i realizmit socialist për Luftën Nacionalçlirimtare*, Tiranë: Naim Frashëri.
5. Akademia e Shkencave, (1996) “*Letërsia si e tillë*”, Akte të konferencës shkencore, f. 84-85, Tiranë.
6. Aliu, Ali. (1990). “*Kërkime*”, Tiranë: “Shtypshkronja 8 Nëntori”,
7. Kycyku, Bashkim. “*Poezia bashkëkohore nga klasikja tek modernia*”, “*Koha jonë*”, 12.08. 2008
8. Agolli, Dritëro. (1987). *Vepra letrare I*, Tiranë: Shtëpia Botuese "Naim Frashëri".
9. Kodra, Klara. (2012). “*Bota poetike e Dritëro Agolli*”. Studime Filologjike 01-02 : 59-72.
10. Lukas, John. (2002) . “*Nationalism as the Modern Religion*”. Historical Review Journal.

Aktet e Seminarit Shkencor organizuar në kuadër të 80-vjetorit të çlirimit të Shqipërisë

CIP Katalogimi në botim BK Tiranë

Universiteti Fan S. Noli

Aktet e Seminarit Shkencor: 80-vjetori i çlirimit : shqiptarët dhe koalicioni antifashist: [përmbledhje materialesh] / përgat.

Universiteti Fan S. Noli; red. Lonora Hysolli. - Tiranë:

Vassi, 2025.

... f. ; ... cm.

Përmbledhje materialesh përgatitur

nga Universiteti "Fan S. Noli",

me mbështetjen e Këshillit të Qarkut të Korçës).

ISBN 9789928471345

1.Historia 2.Lufta Nacionalçlirimtare,

1939-1944 3.Konferenca 4.Shqipëri

94(496.5) .088 (062)

